


8SH-31

M 70

GURI MIÇINOTI

brigada e shtatë



ROMAN

891.983-31

M 70

GURI MIÇINOTI

S

BRIGADA E SHITATË

(ROMAN)

~~50797~~

8475

LIBRARIJA E SHITETIT
PRIZREN

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Djaloshi i porsaardhur qëndronte në mes nesh kokulur. Ishte i zbetë, i lodhur dhe i llangosur me baltë. Kishte veshur një palë çizme të mëdha për këmbën e tij dhe një xhakëtë të gjatë.

— Është gjimnazist, — talli Faiku djaloshin me sa zë që kishte.

Ne, që ishim ulur mbi torfën e ngrohtë të zinxhirëve të traktorëve, ja shkrepëm gazit me të madhe. Ishim ndarë në grupe: njëri grup kishte ndënjur mbi zinxhirët dhe shullëhej në diell, ndërsa grupi tjetër ishte ulur shesh mbi bar. Dielli ishte i nxehtë dhe na ngrohte. Torfa ku isha ulur ishte e ngrohtë dhe e butë si kolltuk. Preheshim, qeshnim dhe e ndjenim veten të gëzuar. Talleshim me djaloshin e ri, që ishte larguar nga shkolla.

Simoja, brigadieri ynë, na e kishte plasur djalin aty dhe ishte zhdukur. Kërkonte përgjegjës të sektorit.

Djaloshi e ndjente veten pisk, por kishte vendosur t'u bënte ballë shakave tona.

Skënderi i gjatë, një traktorist i heshtur, u tregua i ashpër dhe nuk ja vari ndihmësit të tij. Ai kishte vendosur ta linte një herë ndihmësin e ri në mes të romuzeve. Dhe ndihmësi u detyrua t'i nënshtrohej kësaj shakaje ceremoniale, që zakonisht fillonte pa menduar dhe përfundonte atëherë kur ishin shqepur së qeshuri. Shakaja ishte thjesht produkti i shpirtit tonë, gjithë optimizëm. Ata që nuk e pëlqenin shakanë tonë, bëheshin edhe më qesharakë midis nesh, se tamam atëherë gazi merrte horë.

Ne ishim traktoristët e brigadës së shtatë, që do të shpyllëzonim kënetën, dhe gjimnazisti i porsaardhur e kishte vështirë ta kuptonte detyrën tonë.

— Paske gabuar adresën «Çapajev». Doçkat e holla të një gjimnazisti nuk janë për levat e traktorit, — u ndie të hynte në vallen e shakasë edhe Veraqi.

Njeri i çuditshëm ky Veraqi. Ishte shoku im i ngushtë dhe pothuaj në një moshë me mua. Kishte zakon të pështynte me forcë dhe larg. Pinte shumë duhan dhe dhëmbët kishin filluar t'i nxiheshin.

Kaq tha Veraqi dhe buçiti e qeshura. Faiku në të tilla raste bëhej si i çmendur. U lëshua në mes të grupit tek ishte djaloshi dhe filloi të këndonte duke bërë disa lëvizje të habitshme të imituara nga skenat e filmit «Traktoristët».

Do të kishte vazhduar të këndonte dhe të vallëzonte Faiku, sikur të mos kishte buçitur zëri i Skënderit të shkurtër. Në brigadë kishim dy Skënderë. Një të shkurtër dhe një të gjatë. Skënderi i shkurtër kishte një kokë të madhe dhe ishte i trashë si fuçi. Skënderi i gjatë, i dobët e i thatë si cirua, kishte një zë të trashë që të trembte. Skënderi i shkurtër e rrumbullak, zërin e kishte të hollë dhe, kur flisnin të dy Skënderët, ne të gjithë qeshnim me lot.

Pothuajse të gjithë në brigadë kishin nofka. Mua ma kishin ngjitur nofkën «Takulan». Po kur qëllonte që unë, «Takulani», të fundosesha në ndonjë pus gjithë ujë, në mes të kënetës, të gjithë, pa përjashtim, suleshin dhe bënin çmos derisa ta nxirrnin traktorin tim. Në shaka të gjithë qeshnim, po dhe në punë të gjithë dërsnim. . . Ky ishte parimi i brigadës sonë dhe ne nuk e shkëlmin.

Një herë, Simoja, brigadieri ynë, na kishte sqaruar duke na thënë se të sharat dhe fjalët e ndyra janë mbe-turinë e së kaluarës.

Por, sido që të thoshte Simoja, ne nuk mund ta kuptonim njeriun e ndershëm, në qoftë se nuk dinte të shante ose të vinte nofka.

E qeshura, që kishte buçitur, nuk ja kishte prishur gjakun djaloshit, të cilit kishte filluar t'i zbehej të ku-

qurit e faqeve. Ai e kaloi me sukses dhe këtë provë të vështirë.

Sofokliu, që e kishte traktorin të prishur, që para tri ditësh dhe deri në atë çast nuk i ishte ndier zëri, i doli krah djaloshit, e mori nën mbrojtje.

Njeri më vete ky Sofokliu! Gjithmonë, kur i prishej traktori, na ndiqte kudo për të na këshilluar. Në fillim e dëgjuam me respekt, por më vonë na u bë i mërzitshëm, se ju mbaruan rezervat dhe na tregonte gjithmonë të njëjtën histori. Atëherë ai filloi të rrijë serioz dhe ta heqë veten si Sofokliu i Greqisë së vjetër.

— Gjithmonë ti do të dalësh shpëtimtar, — u tall Veraqi me Sofokliun duke i nxjerrë gjuhën.

— Nuk ka lezet, Veraq, — ju përgjegj i qetë «filozofi», — kjo ishte nofka që i kishim ngjitur Sofokliut, — dhe vijoi: — Si e kemi zënë ne me shakatë, rrezik që djaloshit t'i bjerë të fikët.

Me këto që tha, ai na bëri padashur të qeshnim edhe më shumë.

Më në fund, e qeshura reshti dhe vendosëm të ndiznim nga një cingare. U ndien ca si bubullima. Para nesh kaloi një qerre që tërhoqej nga një çift buajsh. Në qerre kishin ngarkuar fletë llamarine, ajo e bënte gjithë atë zhurmë. Fshatari, që e drejtonte qerren, ishte ulur mbi llamarinë dhe nuk e prishte gjakun. Të dukej sikur ai po flinte atje mbi llamarinë, po sakaq i goditi buajt me hosten dhe i mallëkoi. Ata lëvizën gjithë përtim përpara dhe nga buzët filluan t'u kullonin jargët.

Veraqi i vështroi buajt duke picërruar sytë nga zhurma e llamarinave. Buajt kaluan ngadalë para nesh. Fshatari vringëlloi hostenin në drejtimin tonë.

— Ty, Sofokli, ta tregoi hostenin, — e shpoi Veraqi.

Për çudi Sofokliu i këputi një të sharë të rëndë që ne nuk e prisnim. Veraqi, i nxehur, atje tek ishte ulur filloi të pështynte sipas zakonit të vet dhe mori zjarr; u hodh me vërtik, ashtu siç kishte hipur në zinxhir dhe ju drejtua me inat Sofokliut.

Sofokliu kishte zënë për dore djaloshin e porsaardhur dhe po matej të largohej nga grupi, kur i doli për-

para Veraqi. Heshtëm dhe po vështronim me frikë. Çfarë do të ndodhte? Mos vallë do të kriste grushti? Kur të gjithë ishim shumë të shqetësuar, ndodhi dhe mrekullia:

— Ta thashë me shaka, Veraq, se mos e more me gjithë mend.

Kështu foli i famshmi filozof, dhe gjithshka mbaroi shumë mirë. Veraqi u qetësua dhe qeshi me dashamirësi. Vetëm atëherë kuptuam që Sofokliu nuk ishte aq i trashë sa hiqej.

Drejt nesh po vinte me të katra Vasili. Ai kishte vrapuar përmes gropave me baltë dhe ishte bërë si mos më keq.

— Ç'ka ndodhur, Vasil? — e pyeti Veraqi.

— Vëllezër! — klithi Vasili duke qëndruar dhe, si u mbush me frymë, shtoi, — në furrë na ka ardhur një perri.

— Kush ka ardhur? — pyeti prapë Veraqi duke u ngritur më këmbë e duke vështruar gjithë interes Vasilin që kishte dërsitur.

— Një kukull, Veraq. Për nder, bukuri të tillë nuk kam parë ndonjëherë.

— Ku është, o? — pyeti me nxitim Veraqi.

— Shet bukë në furrë.

— Mos u tall, Vasil!

— Më plaçin sytë, në të gënjej, Veraq.


Kaq desh tjetri dhe u nis për nga furra.

— Ku shkon kështu, Veraq? — e pyeti me zë të mallëngjyer e si me të lutur Vasili.

— Do të shkoj të marr bukë, — tha ai, si të ishte i bindur që me atë përgjegje po ja guduliste keq zemrën Vasilit.

Ky donte ta shoqëronte Veraqin, por nuk luajti dot nga vendi. Drejt nesh po vinte brigadieri.

Zjarri llamburiste në vatër. Drutë prej dushku ishin djegur të gjitha dhe kishin mbetur ashtu të kuqe e të



paprishura, si ata peshqit e vegjël prej sheqeri, që blejnë e lëpijnë fëmijët. Afshi i nxehtë na ngrohte gjoksin dhe këmbët. Ngroheshim nga përpara, ndërsa kurrizin të ftohët e kishim, se dera mbetej hapur dhe asnjëri nuk kujtohej ta mbyllte.

Ishim mbledhur të gjithë rreth zjarrit, ndonjëri që shtrirë në minderët anës vatrës. Sofokliu qëndronte më këmbë prapa kurrizit të brigadierit në një mënyrë të tillë, si të donte t'i kërkonte të falur atij që ishte lodhur e ftohur prej kaq ditësh në traktorin e tij. Nga jashtë u ndien të lehurat e qenve, që e kalonin natën në mes të atij të ftohti që të priste veshët.

Djaloshi i porsaardhur, i frikësuar nga errësira e dhomës dhe nga bataniet e bëra gjithë baltë, ishte ulur në një qoshe dhe nuk nxirrte zë.

— Mbylleni atë derë, se na plevitosi! — u ankua me gjysmë zëri Skënderi i shkurtër.

Dera u mbyll duke kërcitur dhe brigadieri filloi të fshijë duart e ndotura.


Faiku kishte zakon të rënkonte, dhe Sofokliu të kollitej pa u gëdhirë mirë dita.

Dikur kjo shtëpi kishte qenë e bukur dhe e re. Dhoma jonë ishte një hyrje e veçantë e gjithë apartamentit që kishim marrë në fillim. Bile, një grup mjekësh kontrollorë të Qendrës Sanitare na dhanë, si për inkurajim, edhe flamurin e pastërtisë. Më kujtohet ai flamur. Ishte krejt i bardhë dhe kishte një kryq të vogël të kuq; nën të shkruhej: «Në këtë shtëpi ka pastërti».

Shtëpitë ishin të gjitha të reja dhe ngjanin si dy vija të bardha hequr kënetës së zezë, për ta ndarë e për ta bërë si bulevardet e mëdha, që ndahen nga vijat e bardha ku kalojnë këmbësorët. Por e gjithë kjo bukuri i takonte së kaluarës; tani pothuajse të gjitha ndërtesat ishin prishur e plakur para kohe.

— Plevicë e katandisët gjithë këtë shtëpi, — na hoqi vërejtjen me keqardhje brigadieri, të cilit i vinte keq për shtëpinë, që kishte filluar të prishej.

Të gjithë heshtëm, sepse e kuptuam që ishim fajtorë. Veraqi filloi të kollitej gjoja si i sëmurë, duke da-



shur të tregonte kështu se ai nuk kishte gisht në prishjen e shtëpisë.

Tek vështroja zjarrin që digjej prush në vatër, rashë në mendime, duke kujtuar shkarkimin e tornove, kur ishte hapur ndërmarrja jonë e re. Kështu ishte dhe ajo ditë.

3

Skënderi i gjatë nuk kishte fjetur. Ai trazonte zjarrin me copën e gjatë të balestrës së këputur. Ishte copë e balestrave të prapme të një veture. Ajo bënte punën e mashës, dhe të gjithë e quanin «Masha e gjatë».

Shokët ishin shtrirë, disa i kishte mbërthyer gjumi. Zjarri po fikej. Vështroja copat e mëdha të drurëve të dushkut, që e kishin humbur tani atë ngjyrën e kuqe dhe ishin zvogëluar shumë.

Me të vërtetë që në dhomën tonë ishte rrëmujë. Nuk merrej vesh se kush banonte, dhe nuk na kishte hije një jetë e tillë. Simoja me të drejtë na kritikoi, ne duhej të merrnim masa.

Djaloshi i porsaardhur rrinte ulur në qoshe me syrin pishë. Nuk e zinte gjumi. Ndoshta nga emocioni: ishte dita e parë që kishte dalë në punë. I bëra shënjë të vinte dhe të ulej afër zjarrit. Mund që kishte dhe të ftohët, po mbase i vinte turp të thoshte. U afrua. Ishte i dobët dhe i turpshëm. Kush vallë e kishte detyruar të linte shkollën? Apo nuk kishte dashur ta ndiqte vetë? Në qoftë se ishte kështu, kishte bërë gabim të madh. Por ne nuk e dinim si qëndronte e vërteta, kështu që s'duhej të mendonim keq për djaloshin.

— Si të quajnë? — e pyeta.

— Tomi, — m'u përgjegj i trembur.

Ra qetësi. U ndie një herë gërhitja e Skënderit të shkurtër, i cili e kishte këtë zakon të keq kur flinte.

— Tomi! — pësëriti mbas pak Skënderi i gjatë dhe, si të donte ta fyente qysh në fillim ndihmësin e tij, shtoi: — Emër prej qeni të kanë venë.

Nga jashtë u dëgjuan të shtëna armësh. Skënderi i gjatë pushoi.

— Përsëri armë! — tha ai me habi. — Luftojnë me diversantët.

Djaloshi ngriti kokën dhe psherëtiu. Ndoshta i erdhi keq që kishte lënë shkollën, ndoshta ndjente frikë që ishte futur në mes të kënetës, ku luftohej edhe me diversantët.

Tomi vështroi për një çast hijen e tij të gjatë, që lëvizti në tavan dhe psherëtiu thellë.

Tavani i ty mosur ishte nxirë si mos më keq. Ju kujtua shkolla. Klasa e tij ishte dy herë më e gjerë se ajo dhomë e ndotur. Klasa kishte një mori dritaresh dhe ishte mbushur gjithë dritë, ndërsa këtu tavani i dhomës nxinte, si të ishte lyer me karabojë. Nuk e kishte menduar kurrë jetën kështu. Por fati e kishte shpënë në mes të kënetës, në mes të atyre njerëzve të çuditshëm. Shkuleshin së qeshuri kot së koti dhe çaplenin gojën për një palë çizme që kishte veshur ai. Ishte vrarë nga shpirti dhe po i kujtonte të gjitha shakatë e romuzet, që kishin hedhur në drejtim të tij.

Ju kujtua nëna. Ajo ishte treguar gjithmonë e dashur me të dhe nuk i kishte folur kaq keq për emrin që kishte. Përkundrazi, nëna ja kishte lëvduar emrin dhe e kishte porositur të mos dëgjonte ç'i thonin shokët, pasi ata ja kishin zili ndaj ja shanin. Nëna mendonte se emri «Tomi» nuk kishte asgjë të keqe, bile ai ishte një nga emrat më të bukur.

Mendimet e djaloshit i prishi zëri i ashpër i Sofokliut, që sulmoi brigadierin:

— Simoja na qorton për dhomën, që e kemi bërë si stallë. Ka të drejtë, stallë e kemi bërë. Po edhe ai ka fajet e tij ama; Nuk kujtohet të na sjellë gazetata. Kemi tri javë që s'i kemi parë dhe nuk e dimë se ç'bëhet në botë.

Simoja e dëgjoi i qetë vërejtjen e Sofokliut. Mori një cingare nga paketa e Vasilit, i cili ishte shtrirë për-bri tij dhe filloi të merrej me të; në fillim e shkundi, pastaj e ngjeshi duhanin duke e përpjekur cingaren nga

njëra anë mbi thuan e gishtit të madh të dorës së majtë. Mori me mashë një thëngjill të kuq dhe e ndezi.

Nga shtëllunga e tymit që nxori Simoja, Sofokliun e zuri kolla. Ai kishte një kollë të çuditshme, aq të fortë, saqë i buçiste gjoksi kur e zinte. Ajo ishte bërë e bezdisshme për ne, sepse na nxirrte gjumin që herët në mëngjez. Sofokliu nuk e priti përgjegjen e brigadierit. Ai filloi të fliste me vete:

— Ky oxhak nuk bën fare, është zënë, të gjithë tymin e fut brenda. Kushedi sa kohë ka pa fshirë.

— Oxhakun e kemi shumë të mirë! — ju kthye Sofokliut Veraqi, si të donte ta kishte para syve. — I ka vajtur hiri deri në majë të kokës, po i zë frymën dhe prapë nuk është kollitur një herë i shkreti, qoftë dhe për të lajmëruar se po mbytet. Ndërsa ti na lebetite me këtë kollë të tmerrshme që ke. Nuk fole një herë me vend, po gjithmonë fajin oxhakat ja hedh. Mendo për kollën tënde dhe për ne të varfërit që na zgjon që herët në mëngjez me atë «çangën» tënde të mërzitshme.

— Kollën e kam nga duhani, — tha Sofokliu.

— Lëre duhanin, Sofokli! — tha brigadieri që, siç dukej, nuk e kishte shkëputur vëmendjen nga Sofokliu, i cili e kritikoi për gazetën.

— Lëre, një fjalë goje është, shoku brigadier, po unë jam lidhur ngushtë me duhanin, s'ndahem dot prej tij.

Do të kishte vazhduar gjatë biseda e brigadierit me Sofokliun, po dikush e ndërpreu nga qoshja:

— Mjaft me duhanin dhe kollën e Sofokliut, më mirë shoku brigadier, na trego se ç'bëhet andej nga qyteti.

Brigadieri, dashur padashur, filloi të tregonte për qytetin:

— Qyteti... si të them, në vend është, nuk ka lojtur as edhe një centimetër. Vetëm se mua atje më bënë për ujë të ftohtë. Në drejtori më pritën me këmbët e para, dhe tërë atë dajak nga qejfi juaj e kam ngrënë.

— Përse të hoqën dajak?

— Traktorët, — u përgjegj si pa qejf Simoja.

— Traktorët! Po ata shokët e drejtorisë të mos ha-

rrojnë se ne zhytemi nëpër puse me gjithë traktorët aq herë, sa kafe u bëhen atyre në ditë. E si të mos priset traktori pastaj? Neve na bie bretku për vete! Kanë të drejtë ata, pse të mos flasin. Më kapardisen atyre kafe-neve, ose më shtrihen në shtëpi me këmbët pranë zjarrit dhe, ashtu të ngopur deri në grykë siç janë, s'u mbetet tjetër veçse të kritikojnë të tjerët. Po të isha në vendin e tyre do të isha pak më i sjellshëm se ata.

Nga jashtë u ndie një kërcëllimë e frikshme. Veraqi për një çast heshti, pastaj pyeti:

— Ç'bëhet kështu?

— Era me siguri do të ketë rrëzuar ndonjë çati, — thashë unë.

— Nuk është era, — më kundërshtoi Sofokliu, — është motori i dritave që kërcet kështu. I është bërë ves, si mua kolla.

— Përse nuk e hedhin atë djallo motor. Ne u qorruam në dhomë me këtë drej dritë, dhe ata të NSHN na lëndohen duke thënë: «Në fermë kemi shpënë një motor dritash».

Veraqi kishte filluar të merrte zjarr. Kërkonte të hidhej në plehëra dhe motori i dritave. E vërteta ashtu ishte: Motori që i vogël dhe nuk i ushqente mirë të gjitha llambat. Megjithatë, punën e bënte dhe, që ta hidhje ishte budallallëk. Po kështu e kishte Veraqi. Kur merrte zjarr, të gjithë i hapnin rrugë, sepse kishte rrezik që të të flakte tej. Vasili, që ishte i heshtur dhe i zhytur në mendime, tha:

— Skënderit të shkurtër, sa herë që kthehet nga gruaja, i hapet goja! E çuditshme, ë?

— Sa fëmijë t'u bënë, Skënder? — e pyeta unë.

— Shtatë. Të tetin e kemi gati. Kam grua unë, jo llafe — ja bëri ai si me shaka.

Kishte të drejtë Skënderi. Gruan e kishte të mirë, punëtore, të urtë dhe pjellore. Sa herë që dilte ndonjë punë për në qytet, Skënderi do të ishte i pari për të shkuar, se e priste gruaja e dashur.

Ishim mërzitur së prituri dhe nuk na zinte gjumi pa grënë patatet. Ato ishin mbuluar me hi e prush.

Faiku ishte mjeshtër për të pjekur patate; atë kishim caktuar me këtë punë. Por sot na mërzhiti. Ndoshta po i vononte që të mos e merrte vesh brigadieri.

Vështroja vatrën. Ajo më ngjante me një kapulicë zhavorri. Kaq e madhe ishte. Në fillim isha bashkuar me mendimin e Sofokliut, që thoshte se i qe zënë fryma oxhakut nga të pafshirët. Po kur e mora vesh se si ishte e vërteta, hoqa dorë nga ai mendim dhe u pajtova me mendimin e shokëve.

— Ç'djall fshihni kështu nëpër hi? — pyeti me habi brigadieri që po trazonte në vatër.

— Patatet u poqën! — thirri më në fund Faiku, dhe të gjithë u afruam te vatra që po zbulohesh. Në mes kishin vendosur një panxhar të madh dhe, rreth e rrotull tij, patate. Panxhari ishte pjekur dhe kishte lëshuar lëng. Ai ishte fishkur dhe përvëlonte.

Të gjithë këtë zbulim e bëri Faiku, i cili ja rrëmbeu nga duart brigadierit fijen e balestrës.

— Ku djallin i merrni të gjitha këto? — na pyeti papandehur brigadieri.

Heshtëm të gjithë. Si gjithmonë, në të tilla raste, kishim caktuar Vasilin që të na «nxiirte nga situata».

— Faiku... se nga i rregullon, shoku Simo, — u përgjegj shpejt e shpejt ai.

Simoja nuk foli më, dhe Vasili i dha pataten më të madhe. Ai e mori dhe neve na u shkri gjaku. Prisnim në ankth vazhdimin e bisedës së Vasilit me brigadierin. Po, si dukej, ajo kishte mbetur me aq.

— Qënkam të shijshme, — tha më në fund Simoja, duke kërkuar edhe një tjetër.

I dhamë edhe një.

Më vonë të gjithë u shtrimë për të fjetur. Zjarri ishte duke u shuar dhe, tek matesha të mbuloja kokën me batanien e vjetër, (e kisha që në vogëli këtë ves, po të mos e mbuloja kokën me batanie, nuk më zinte gjumi) ndjeva që m'u afrua zvarrë Vasili.

— Sy të bukur ka shejtanka, — më tha ai duke pshe-
rëtitirë.

— Kush kështu? — e pyeta i habitur.

— Ti nuk qenke këtu, kushedi ku të fluturon mendja. Nuk folëm një orë të tërë për atë që shet bukë?

— Ah!.. Nesër do ta shohim se çfarë kuklle është ajo. Vasili u largua. Mbulova kokën me batanie dhe, mbas pak, më zuri gjumi.

4

Ishte ende natë, kur na zgjoi kolla e fortë e Sofokliut.

— Të çafshin ujqit! — e mallëkoi Veraqi Sofokliun me zë të ngjirur e duke e spërkatur padashur me pështymë, që e kishte zgjuar aq herët.

Sofokliu, që nuk e mori vesh se nga i erdhën ato cirka uji që i ranë në faqe, ja nguli sytë tavanit, me shpresë se mos zbulonte vendin ku pikonte.

Në vatër ishte ndezur zjarri. Drutë kërcisnin. Flaka e përskuqte të gjithë dhomën.

U zgjuan të gjithë dhe filluan të shtriqin gjymtyrët.

Veraqi filloi të kollitej, duke imituar kështu Sofokliun, i cili na kishte zgjuar që pa gëdhirë.

Zbardhi drita dhe këndeizat e ngjirur e pushuan këngën.

Hapëm dritaren. Në dhomë hyri ajri i freskët i mëngjezit, që na mbushi mushkëritë.

Ishin lëshuar pulat. Dëgjonim kakarisjen e tyre dhe na kënaqej shpirti.

Ndjeja një gëzim të pashpjegueshëm. Gjithshka më dukej e bukur dhe e këndshme atë ditë. Ndoshta ajo gjendje shpirtërore më ishte krijuar sepse pikërisht atë ditë më kthehej ndihmësi nga leja. Ndihmësin e kisha djalë të urtë dhe punëtor. E quanin Kosta. Vetëm Veraqi nuk e duronte dot ndihmësin tim. Po mua aq më bënte.

Skënderi i gjatë atë mëngjez nuk ishte në qejf. Ishte i menduar dhe i vrënjtur. Ai kishte një të metë, që i punonte mendja te pazari dhe te bonot e reciprokut. Ishte bërë asi i pazarit dhe i kontrabandës së reciprokut.

Kosta ja kishte vënë një herë në dukje këtë të metë

Skënderit dhe puna do të kishte përfunduar keq, po të mos i kishim ndarë ne. Ndoshta Skënderi e ka mendjen nga pazari, prandaj rri i vrënjtur.

U ngrita nga shtrati dhe u vasha. Eca me kujdes midis shokëve që flinin. U habita! Dhoma ishte pastruar dhe këpucët ishin vënë në rresht. Jo vetëm kaq. Hiri ishte pastruar nga vatra dhe zjarri digjej bubulak.

U çua nga shtrati edhe Veraqi. U vesh dhe u ndal i çuditur para meje, kur pa gjithë atë rregull që ishte vënë.

Sofokliut nuk i bëri përshtypje gjithë ky ndryshim që kishte ndodhur në dhomën tonë. Ai u ul në këndin e vatrës dhe filloi të kollitej.

— Na e prishën dhomën, Sofokli, — e shpoi atë që në mëngjez Veraqi.

— Atje e kam mendjen unë, o Veraq, te dhoma dhe te ndryshimet. Mua po më merr shpirtin kjo kolla, nuk më hyn asgjë në sy.

Veraqi u largua nga Sofokliu dhe erdhi pranë nesh. Ai shprehu besimin se gjithë këtë ndryshim në dhomë e kishte bërë vetë brigadieri, që kishte aq ditë që ishte në qytet dhe ishte kthyer prej andej me plane të mëdha në kokë.

Ne nuk e besonim një gjë të tillë dhe na dukej sikur po e rëndonim kot dhe pa faj Simon. Dhe ashtu doli. E vërteta ishte ndryshe. Gjithë atë ndryshim në dhomë nuk e kishte bërë brigadieri, por Tomi, ndihmësi i ri i Skënderit të gjatë, që e kishte filluar punën shumë mirë. Ishte ngritur herët dhe, kur ne ishim ende në gjumë, ai i kishte bërë vetë të gjitha ato punë. Kjo ishte një gjë e papritur për ne dhe të gjithë filluan ta marrin me sy të mirë këtë djalosh thatim, të turpshëm, me gishtrinë të gjatë e të hollë, që sulmohej gjithmonë nga shakatë tona të paturpshme, të cilat i kishte pritur kokulur.

Në fillim ai kishte mundur të vinte rregull në këpucët. I kishte vënë të gjitha me radhë prapa derës. Pastaj kishte pastruar vatrën. Hirin e kishte nxjerrë me një letër katrama, që rrinte në mes të dhomës dhe që ne s'e dinim as se kush e kishte vënë atje dhe as përse

e kishte vënë. Pas kësaj, ai kishte fshirë dhomën dhe kishte mbushur ujë. Si kishte mbaruar të gjitha punët, ishte futur në dhomë i heshtur. Sytë i kishte të qeshur dhe duart të skuqura nga thëllimi. Mëngjezi ishte i ftohtë.

Vjeshta kishte kohë që kishte zbritur edhe nga kënetat. Vetëm se ajo në fillim kishte qenë e bukur, kurse mbas pak kohe ishte bërë e trishtueshme dhe e ftohtë. Kështu që dhe tani që dimri ishte në prak.

Do të ishte me fat Skënderi, në qoftë se ky djalë do ta mbante këtë revan. Dhe Skënderi i gjatë gjithmonë ishte me fat. Në brigadë kishim kohë që e thërrisnim «Skënderi i lindur me këmishë», dhe këtë nofkë të gjatë ja kishte ngjitur Veraqi.

Shkonte në dyqanin e reciprokut Skënderi dhe gjeante biçikleta «Mifa». Kur venim ne, ishin bërë na, sqfurf. Skënderi filloi t'i ndërronte shpesh biçikletat, dhe jo më kot Veraqi na paralajmëroi se kjo sjellje e Skënderit mbante erë matrapazllëk. Dhe ashtu ishte në të vërtetë. Skënderi e kishte rregulluar punën me shitësin e dyqanit dhe i shiste biçikletat kontrabandë më shtrenjtë nga ç'kush-tonin. Kjo gjë na kishte inatosur të gjithë dhe kishim filluar ta vështronim me sy tjetër Skënderin. Po atij s'i bëhej vonë. Tomi kishte larë fytyrën me sapun dhe që skuqur. Era e sapunit u përhap në dhomë dhe na u ngjall edhe neve dëshira që të laheshim me ujë të ftohtë. Nga sumbullat e ujit, që i kishin mbetur në vetulla, më shkuan mornica, si të isha duke u larë me të vërtetë. Tomi kishte dalë jashtë dhe po i hidhte ujë nga bidoni Veraqit, që kishte vendosur të lahej.

Sofokliu, që s'po lëvizte nga vatra, tek dëgjoi thirrjet gjithë kënaqësi, që nxirrte Veraqi duke u larë, nuk duroi më dhe bërtiti:

— Na u prish bukuria e dhomës. Kaq e pati rregulli dhe pastërtia në brigadën tonë.

U shkula së qeshuri me fjalët e Sofokliut.

Pastaj Veraqi, që ishte jashtë, u kthye i larë në dhomë dhe vendosi ta merrte jashtë Sofokliun që të lahej. Po ai s'dëgjoi që s'dëgjoi dhe nuk lëvizi nga vatra.

— U pispillosët, kapedanë! Në rregull! Turp të kini! Mos u thoni të tjerëve që jemi traktoristë, se na e turpëruat zanatin. — Kështu na pritri Sofokliu të gjithë, kur u dhamë në dhomë të larë e të pastruar. Kjo pritje ishte e padrejtë prandaj e rrëmbyem nga supet Sofokliun, që u tall me ne dhe kishte vendosur të mos lahej që «të mos turpëronte zanatin e traktoristëve». Megjithë kundërshtimet e tij, ne e lamë që e lamë. Kjo ishte një e larë plot me romuze dhe qeshëm me lot. Ditë të tillë nuk kishim parë kurrë dhe nuk e kishim filluar ndonjëherë punën me kaq të qeshura. Me siguri që gjithë dita do të na shkonte e gëzuar, sepse ashtu e kishim filluar. Ishim spërkatur e qullur, por ama Sofokliun e kishim bërë nuskë. Belaja më e madhe na kishte gjetur me një kusi prej bakri. Ajo ishte e vogël dhe aq e vjetër, sa të gjithë e kishin quajtur me një gojë «Kusia e Ali Pashë Tepelenës». Ishte e vjetër dhe e pakallajisur. Sofokliut i kishim thënë njëmijë herë që të mos na e ziente qumështin në atë djall kusi. Ai, në vend që të na dëgjonte dhe të bënte siç i thonim ne, vazhdonte «avazin e Mukës». Ne të gjithë nuk hanim, po Sofokliut s'i bëhej vonë; ulej këmbëkryq dhe i gjente fundin kuisë.

Ja kishim treguar me mijëra herë rrezikun që kishte kusia e pakallajisur dhe i kishim thënë se ajo do të bëhej shkak që të helmohej e gjithë brigada. Po ku merrte vesh Sofokliu! Më në fund, fshehurazi, kur shkoi brigadieri në qytet, ja dhamë dhe kusinë e vjetër. Ajo ishte kallajisur dhe tani shkëlqente. Sofokliu u habit kur e pa kusinë në atë gjendje. Në fillim nuk donte të besonte në asnjë mënyrë se ajo ishte kusia e tij. Më vonë e njohu dhe na vështroi me habi e tërë inat për gënjeshtren që i trilluam. Ne i kishim thënë që kusinë na e kishin vjedhur.

Vasili nuk ishte midis nesh. Ai kishte fluturuar për te furra e bukës. I kisha dhënë fjalën të shkoja së bashku me të. Po në mëngjez e harrova fare premtimin dhe i dhashë triskën, kur ma kërkoi.

Ai kishte filluar të mblidhte vetë të gjitha triskat e bukës së brigadës dhe ne nuk e habitëm për këtë gjë.

Problemin se kush do ta merrte bukën në furrë tani e kishim zgjidhur. Vasili kishte dalë vullnetar për këtë punë dhe nuk besoja se mund t'ja zinte njeri vendin.

Vendosëm të shkonim dhe ta vështronim Vasilin me vajzën për të cilën na kishte folur. Nxituam të shkonim shpejt, por na vonoi Veraqi. Ai kishte vendosur të vishte këmishën e re dhe ne e pritëm. Këmishën e kishte të mbështjellë në torbë. Torba ishte prej leshi dhe kishte si rrip një ushkur të kuq. Këmisha ishte mbushur gjithë thërrime buke dhe ne e kuptuam që Veraqi në torbën e teshave mbante dhe bukën. Ai e veshi këmishën e zhubrosur dhe na vonoi më shumë, kur u mundua të zhdukte zhubrat që kishte jaka.

U nisëm. Përpara na printe Veraqi i pispillosur. Rruga ishte gjithë gropa me ujë dhe ai kalonte me kujdes anës tyre.

Mbërritëm. Në furrë kishte shumë njerëz. Të gjithë ishin pleq dhe fëmijë të familjeve të punëtorëve të fermës. Pleqtë me bollka dhe çorape leshi kishin ndezur llullat, dhe fëmijët fshiheshin mbas kurrizit të tyre që të mos i kapte thëllimi.

Vasilin mezi e dalluam. Ai kishte ndënjur te qoshja e sportelit dhe nuk lëvizte nga vendi. Siç duket, ja kishte qepur sytë vajzës dhe e kishte humbur fare toruan. Mos vallë kishte harruar që e kishim dërguar për të blerë bukë? Sjellja e tij u kishte rënë në sy edhe punëtorëve të fermës. Njëri prej tyre, më guximtari, ja priti shkurt Vasilit që kishte ngrirë e s'po lëvizte nga ajo qoshe:

— Do të marrësh bukën ti o, apo jo? Ke një orë që po rri si lloz dhe nuk bën përpara.

Ne qeshëm. Vasili u skuq dhe i hodhi një vështrim tërë mllef plakut, që i kishte prishur qetësinë dhe kishte guxuar t'i thoshte ato fjalë në mes të njerëzve.

I bëmë shënjë dhe Vasili doli nga rrjeshti. U habit tek na pa dhe erdhi ngadalë drejt nesh si pa zemër.

Veraqi kishte vendosur të tallej me të. E pa një herë në sy dhe, pasi na vështroi ne, si të donte të merrte zemër, i tha:

— Ne e dërgojmë të marrë bukë, ky vjen e mbetet këtu! Ma jep triskën!

Vasili ja dha. Pastaj na i dha edhe neve, dhe vetë shkoi e zuri radhë mbas murit. Të gjithë u vunë në radhë. Para nesh ishte një vajzë fshatare me shami të bardhë lidhur në kokë. Mori bukën dhe e shtrëngoi mbi gjunjët e bëshëm. Nuk folëm. Asnjërit nuk ja mbante të shpërblimit. Ishim të gjithë fshatarët dhe luante huri po të kishte.

Duke pritur radhën, Veraqi nisi të vërshtëllëjë. Ai vërshtëllente bukur. Vasili ja qepi sytë Veraqit dhe e vështrroi me zemërim, që sillej në atë mënyrë kundrejt shtitëses. Atij i qenë skuqur faqet dhe buzët i dridheshin. Veraqi e vështrroi shokun me mospërfillje dhe vazhdoi të vërshtëllente. Vasili, si të kishte zbuluar ndonjë gjë të mistershme, e kërcënoi rëndë Veraqin duke i thënë:

— Të çava më dysh, po i the ndonjë fjalë vajzës!

Të gjithë u habitën nga ky kërcënim. Sherri nuk do të kishte lezet dhe do të na bënte me turp. Por Veraqi mbajti gjakftohtësinë. Ai vendosi ta luante mendsh Vasilin. I nxori gjuhën dhe ja shtypi hundën si një korne burie. Pastaj i tha me gjakftohtësi:

— Kaq e pate, o dashnori i Venedikut! Ta mora zogëzën...

Vasili u zverdh si ta kishte humbur davanë. U largua prej nesh dhe zuri vendin e parë.

Po nuk ndodhi ashtu. Veraqi u soll ftohët me vajzën. I hodhi një vështrim të rreptë dhe i zgjati triskën. Ajo ja preu latën dhe ja ktheu atë me sytë ulur. Veraqi mori bukën dhe u largua nga radha.

Në sportel mbeta vetëm. Ja dhashë triskën shitëses. Ajo më vështrroi shkarazi. Kishte sy të kaltër dhe të bukur, po çehren e kishte të frikësuar dhe të vrarë. Kishte dhe një nishan, po e uli kokën shpejt dhe nuk e vështrua dot mirë.

Mora bukën dhe u largova nga sporteli. Më tutje më prisnin shokët. Kur mbërritja tek ata, ndesha vështrimin e egër të Vasilit. Nuk m'u mbajti të qeshurit.

Më vonë, duke shkuar udhës, i hodha dorën në sup Vasilit dhe i thashë:

— Mos u bën leshko dhe xheloz! Ti e di shumë mirë që jam djalë me moral dhe nuk përzihem në të tilla punë.

Ai ma hoqi dorën nga supi dhe shkoi vetëm. Pastaj dëgjova që po më shante.

5

Kosta, ndihmësi im, nuk erdhi. Kjo më shqetësoi. Ndoshta ishte nisur dhe i kishte ndodhur gjë rrugës. Ndoshta ishte i sëmurë dhe nuk ishte nisur për punë. Mund të ishte dhe kështu. Mendoja ngjarjet më të shëmtuara që mund t'i kishin ndodhur Kostës rrugës. Do të më lehtësohej shpirti shumë, sikur të merrja vesh që ishte i sëmurë dhe për këtë arsye nuk ishte nisur për në brigadë. Më mirë të ishte i sëmurë dhe në shtëpi, se sa të ishte nisur e të mos kishte mbërritur. Ndoshta kjo ishte dhe arsyeja që mëngjezin e hëngra i mërzitur, gjë që u tërhoqi vëmendjen edhe shokëve.

Vasili ishte gjithë inat dhe ziente përbrenda më keq se radiator i traktorit. Na vështronte të gjithë tërë hundë e buzë, duke u bërë qesharak. Po t'i zgjatë shumë inati, në qafë pastë veten, se nuk i ka faj njeri.

Faiku kishte zënë manovelën e gjatë dhe të lartë të traktorit të tij, që nuk i ndizej. Sa njeri i çuditshëm ky Faiku! I shpikte koka gjëra që nuk i shkonin kurrë njeriut në mend. Ziente patate në radiatorin e traktorit! I vetmi ishte për të tilla gjëra. Vasili nuk e shihte dot me sy dhe e kishte inat, sepse ja kishte hedhur një herë kur kishin luajtur domino. Por sot, Vasili, për inat të shokëve që i ishin qepur prapa në furrën e bukës, kishte vendosur të fliste edhe me Faikun. Jo vetëm kaq, por ai e ndihmoi dhe i ra vetë manovelës për të ndezur traktorin. Unë traktorin e kisha ngjitur me atë të Skënderit

të gjatë. Kishte rënë brymë, dhe vaji i motorit qe trashur e qe bërë si graso.

Tomi mezi e lëvizte manovelën. Skënderi i gjatë ishte futur brenda në traktor dhe qe kapardisur si maçoku në thekër. U ndala dhe fillova të nuhas. Nuk mbante erë benzinë. Kisha parandjenjën se nuk do të mbaronte mirë kjo lojë. Vështroja Tomin. Ai ishte bërë qull në djersë. E kuptova lojën. Skënderi kishte vendosur ta lodhte djaloshin e ri, që të zvirdeh nga puna dhe të shkonte. Kjo s'ishte aspak e ndershme. Skënderi ishte mësuar të punonte vetëm dhe nuk donte t'i nxirrte telashe vetes për të mësuar kuadrot. Atëherë nevojiteshin shumë traktoristë, dhe ne duhej t'i mësonim e t'i nxirrnim ata. Po kjo pak i interesonte Skënderit. Mjaft që ai të punonte për vete dhe të merrte rrogën, sa për të mësuar ndihmësin e tij as që donte ta vriste mendjen. Tomi e vërtiste kot manovelën e traktorit. Skënderi i gjatë nuk kishte hedhur çiketo me benzinë në hedhëset e çiketos të montuara në kolektor. Jo vetëm kaq, por Skënderi e kishte hequr dhe fijen e magnetit nga vendi, dhe korenti dilte jashtë. Motori ishte i rëndë. Këtë e kisha provuar dhe vetë. Tomi e pati pisk dhe do të vazhdonte të dërsinte akoma, po të mos e kisha ndaluar unë.


— S'ke turp, Skënder! Kërkon t'i marrësh shpirtin djaloshit! Pse djallin tallesh me të? Vëri fijen magnetit dhe hidhi çiketo me benzinë!

Nuk prita sa të hidhej ai nga motori. Mora fijen, e vura në vendin e saj në magnet dhe, si i hodha çiketo, i thashë Tomit t'i jepte një xhiro manovelës. Nuk bëri as gjysmë xhiro dhe motori u ndez. U ndez shpejt, si një çakmak.

Tomit ju bë qejfi dhe qeshi. Ishte djalë i gjallë.

Nuk isha vetëm unë që kisha ndjekur veprimet e këqia të Skënderit. Atë e kishte vërejtur edhe Veraqi, i cili kishte ardhur aty me t'u ndezur traktori.

Skënderi qe hedhur poshtë nga traktori dhe po hiqej si leshko. Sikur nuk i shkonte në mend që kishte dalë fija e magnetit dhe që nuk i ishte hedhur çiketo me benzinë! Pandehte se mund t'i hanim justifikimet e tij.



Po Veraqi ja preu shkurt:

— Hap sytë, Skënder! Sillu si njeri, siç u ka hije njerëzve të zanatit tonë dhe mos u bëj zemërgur!

Fjalët që kishte thënë Veraqi i përshtateshin shumë mirë karakterit të Skënderit të gjatë dhe ai mbeti si i zënë me faj.

E ndezëm dhe traktorin tim. Ai u ndez pak me vonesë, se kishte zënë ndryshk në manjetë. E hapëm dhe e pastruam. Tomi na ishte ngjitur pas dhe i bënte sytë katër që të mësonte sa më shpejt. U bëmë gati për udhë. Parcelat ishin të shpërndara nëpër kënetë, dhe një copë rrugë për të shkuar deri tek ato do ta bënim së bashku. Rruga nga kalonim ishte një lumë i vërtetë. I pari u nis traktori i Vasilit. Mbas tij u nisa unë, mbas meje u dha Veraqi dhe të tjerët. Zinxhirët çanin ujët, dhe nga korona e dhëmbëzuar i diferencialit dilnin copat e drunjve që kishte zënë zinxhiri dhe ndonjë kërcu i madh.

Qielli ishte i vrënjtur. Tymi i skapamentos ngrihej lart dhe bashkohej me retë e zeza që endeshin në qiell. Tri kilometra në ujë, me gjithë traktorin nuk janë pak. Është një ecje e ngadaltë, që të mërzit dhe të bën të të merren mendtë. Kjo vjen ngaqë e gjithë rruga kalon nëpër ujë. Dhe jo vetëm kaq. Ajo është e keqe, dhe traktorët shkojnë në të me zhurmë e rrapëllima. Aty nga mezi i rrugës Vasili ndahet prej nesh i zemëruar dhe nuk na përshëndet. Po dhe ne nuk e vështrojmë në sy. Ai kthehet majtas dhe futet në parcelën e tij. Pak më vonë më përshëndet me grusht duke qeshur. Ja kthej përshëndetjen dhe i uroj punë të mbarë.

Vazhdojmë të ecim. Në mes të rrugës, nga e majta, është një gropë e madhe. Një natë më parë kishte rënë në të një çift qesh. Fshatarët e bërë tërë baltë ishin gdhirë jashtë gjithë natën, sepse s'kishin mundur t'i nxirrnin dot qetë. Ishin lodhur e mavijosur nga të ftohtët. Qetë ishin fundosur deri në gjoks në llucë dhe nuk dilnin dot. Ishin të trembura dhe kishin ngrirë së ftohti. Nga goja u dilnin shtëllunga avulli. Qimet e buzëve u qenë ashpërsuar nga bryma. Më erdhi keq dhe me qëllim u fola fshatarëve:

— Doni ndihmë?

Fshatarët më vështruan një herë ashtu të ngrysur siç ishin. Kishin të drejtë. Qenë gëdhirë tërë natën në mes të të ftohtit për të shpëtuar mallin e popullit. Më erdhi keq për ta. Edhe sot e kësaj dite më kujtohet se me sa mirënjohje më falënderuan pas ndihmës që u dhashë.

Më tutje, para traktorit, kaloi me shpejtësi një vidër. Kafsha vraponte me të katra dhe nga nxitimi u përplas në një plis. Nga forca e përplasjes vidra u rrokullis dhe mbeti me këmbët përpjetë. Ja vështrova me habi këmbët: ishin të shkurtëra dhe me lopatka, si të rosës. E ndala traktorin dhe u sula me të katra drejt saj. Aq më bënte për çizmet që më ishin mbushur me ujë dhe për këmbët që më digjnin nga të ftohtit. Kisha një dëshirë të zjarrtë: Ta zija kafshën të gjallë. Nuk isha as një metro larg saj, kur ajo u kthye në çast dhe ja shkeli me të katra. Më tutje ishte kanali. Ajo u hodh si plumb në ujë. Pashë rrathët e rrumbullakët që u formuan, në fillim të vegjël, pastaj më të mëdhenj e më të mëdhenj, si inati që më kishte pushtuar. Shava vidrën dhe veten time. Kafsha më kishte lënë me gisht në gojë, dhe më vinte të haja veten me dhëmbë. Isha treguar i ngathët, dhe vidra ma kishte hedhur. Kisha të ftohët, kurse këmbët më digjnin. Nuk i hoqa çizmet. Ishte punë e kotë dhe s'do të kisha ndonjë fitim. Si eca pak nëpër kanal, shtanga në vend. Diçka po më guduliste. Nuk munda të duroj. Jam shumë i ndijsëm dhe mu aty në mes të rrugës ja shkrep gazit me të madhe, si të isha çmendur. U ula duke qeshur dhe nxora me nxitim çizmen e djathtë që ishte mbushur me ujë. Vetëm atëherë u qetësova. Tek zbraza ujët nga çizmja, ngriva në vend. Brenda në çizme kishte hyrë kontrabandë një...bretkosë. Bretkosa ishte e zezë dhe me pikla në kurriz. Kishte sy të frikshëm. I futa një shkelm dhe e hodha në një gropë me ujë. Ajo u tregua mosmirënjohëse, nuk më falënderoi që i fala jetën.

Sa mirë që s'ishte Kosta! Ç'do të kishte thënë ai për gazin tim? Me siguri në gjithë brigadën do të hapej fjala

se isha çmendur. Pak më tutje, lashë rrugën kryesore dhe mora drejt parcelës. Preva levën e traktorit nga e majta dhe zinxhiri u tëzar duke u kthyer në parcelë. Plugun e gjeta te vendi ku e kisha lënë. Shkova me gjithë traktorin përpara dhe mora krahun nga plugu.

Ecja mbrapsh. Mbas pak u ndala. Plugun e kisha lënë shumë larg traktorit dhe duhej afruar më djathtas. Hipa në traktor dhe manovrova. Ju afrova shumë plugut. Kur e vështrova, u habita. Shpezët, që kishin pushuar natën mbi të, e kishin ndyrë me glasa. Shënjë e mirë kjo. Më erdhi të qeshja, por nuk kisha fuqi. Isha lodhur dhe përpiqesha të afroja traktorin pranë plugut. Të gjithë punën e vështroja nga dritarja e vogël e kabinës së traktorit. Plugu tani ishte afër. Shkela me të shpejtë pedalin e friksionit dhe traktori u ndal. Zbrita poshtë. Kisha arritur në pikën e saktë plugun. Më qenë lodhur muskujt e qafës ngaqë kisha vështruar shumë mbrapsh, por isha i gëzuar. Tani më duhej Kosta. Duhej ngritur timoni i plugut dhe duhej takuar me takon e traktorit. Timoni i plugut që i rëndë dhe una isha fare vetëm. E pata të vështirë, shtrëngova fort gjunjët dhe e përlava timonin e plugut me gjithë fuqinë që kisha. M'u tendosën të gjithë muskujt e trupit dhe, me një stërmundim, e vura më në fund timonin e plugut te takoja e traktorit. Tani nuk më mbetej veçse të filloja nga puna. Më kishte hy-pur gjaku në fytyrë dhe e kisha vështirë ta nxirrja spinotin nga takoja, por çdo gjë kishte marrë fund, dhe plugu ishte gati të fillonte nga puna.

Megjithëqë isha i lodhur, ndjeja një farë krenarie. Isha krenar që kisha mundur të kryeja gjithë atë punë të vështirë vetëm. Ndeza një cingare. E thitha fort tymin e duhanit dhe e nxora me vrull nga goja. Ai doli shtëllungë, siç del tymi nga oxhaku i fabrikës. Vështrova fushën pa mbarim, dhe mendova kënetën që e mbulonte atë dikur. Kushedi, thashë me vete, pikërisht në këtë vend tek jam me gjithë traktorin, në një të kaluar të afërt mund të ketë qenë selia e gjithë peshqve barkalecë. Qesha me vete. Isha zhytur në mendime të çuditshme, që s'kishin asnjë lidhje. Nga larg vinte e lehura e një

qeni. Ai dikë kërcënonte dhe ishte bërë si i tërbuar. E lehura e tij ishte e fortë por, derisa zbriste në kënetë, tulatej dhe humbiste. Nga mendimet më shkëputi pickimi i një mushkonje. Ajo më solli në vete. Mushkonja ishte e madhe dhe, megjithëqë ja vëzhita fort fytyrës sime me pëllëmbë, mushkonja fluturoi dhe shpëtoi.

Tek kujton shokët që janë larg, të duket sikur ata janë midis teje dhe sikur ti nuk je i vetëm, sikur ata po të ndihmojnë në punë, në plug, në zinxhir e kudo. Dhe puna të duket më e lehtë, sepse atë e mposht forca jote, që është shumëfishuar nga kujtimi i shokëve. Cingaren e nderur, e kisha mbaruar dhe tani duhej të filloja nga puna. Hipa në traktor dhe i futa marshin e parë. Frikësonin e lëshova me kujdes, sepse e dija që nisja e traktorit me gjithë plugun ishte një mbingarkesë, përderisa të merrte udhë dhe të hapte brazdë të re. Traktori i lidhur me plugun u sforcau. Pastaj bëri një gisht përpara, dy, tre dhe u nis. Mbrapa plugu nisi të çante tokën e verdhë dhe ta kthente në plisa të zez. Ishte torfa që rrokullisej. Këneta po i shërbente tashmë njeriut.

Traktori ecte përpara, pa patur frikë se mund ta ndalte njeri. Mbrapa tij zgjatej vija e zezë e tokës, që çahet nga thika e plugut...

Këneta e madhe dhe pa fund ishte e verdhë si një lëkurë kafshe. Këtë ngjyrë ja kishin dhënë barërat dhe kallamat e thatë. Kallamat dhe bari ishin kalbur, sepse kënetat sapo ishte zbrazur nga ujët. Kur zhytej plugu i madh nën mbulesën e rreme që kishte kënetat, dilte në dritë toka e zezë, torfa e pasur tërë pleh, që ishte krijuar nga drurët e kalbur në shekuj. Toka ishte e butë dhe në shumë vende e lagur. Uji ishte lidhur për jetë e vdekje me torfën, dhe nuk donte ta braktiste shpejt.

Vështroja brazdën që nxinte prapa traktorit dhe krijesha në mendime. Mbrapa plugut u dhanë me të shpejtë dhelprat. Ato ishin tri dhe ndiqnin minjtë që nxirrte plugu nga nëntoka. Minjtë ishin të trullësuar dhe ngjyrë hiri. Dhelprat filluan të grinden me njera-tjetrën.

Më mori etja! Po ku të gjeja ujë? Afër nuk kishte as

që të tërhiqej vetëm traktori. Sido që të ishte puna, një traktor ishte e kotë të shkonte vetëm në vendin e ngjarjes.

M'u kujtuan shokët. Veraqi dhe Vasili nuk punonin larg meje. Duhej të ndiznim zjarrin — sinjal dhe ata në çast do të vinin këtu. Pastaj të tre së bashku mund të bënim diçka për Skënderin e gjatë.

Fillova shpejt të mbledh kallama dhe degë të thyera e të kalbura, që ishin shpërndarë andej-këtej nëpër kënetë. Skënderi më vështronte me habi dhe nuk e kup-tonte përse i mblihdja gjithë ato shkarpa.

— Ç'po bën kështu?

E vështrova vëngër në fytyrë dhe i fola ashpër:

— Mblidh kallama dhe copa drurësh, mos më rri si hu!

Ai u bind dhe filloi të mbledhë. Pastaj i bëmë kopicë, i spërkata me vajguri dhe u vura flakën. Vendin, ku ngritëm kopicën e kishim izoluar, në mënyrë që zjarri të mos përhapej në gjithë kënetën. Për këtë punë mbaja një lopatë që na shërbente shumë. Me të hapnim një kanal të ngushtë dhe zjarri mbetej i izoluar.

Tymi i zi u dha lart, ndërsa kallamat zunë të kër-cisnin.

— Kot po vonohemi, ata s'kanë për të ardhur.

Skënderi nuk kishte besim te shokët. Ndoshta kjo vinte nga egoja e tij. Nuk kishte ndihmuar njeri dhe, kur qëllonte që ndodhnin të tilla avari, ai tërhiqej dhe nuk përzihej fare në kësi punësh. Nuk i shkonte kurrë në mend se një ditë edhe ai me gjithë traktorin e vet do të binin në pus. Ndoshta kjo ishte dhe arsyeja që ai ishte shumë i shqetësuar. Nuk m'u durua:

— Ashtu thua ti? Shokët do të vijnë, bile më shpejt nga sa mendon ti, — i thashë me ton të prerë, pa e shi-kuar në sy.

Mendonte gabim dhe shqetësohej kot Skënderi. Si duket, mallëkonte veten e tij që ishte treguar i largët me shokët dhe kishte qëndruar i vetëm mbas punës. Tani, që ishte vetë në hall, nuk i besohej që shokët nuk do ta linin vetëm, po do të luftonin të gjithë si një trup i

vetëm për ta nxjerrë traktorin që kishte rënë në pus. Ai vetë, në raste të tilla, ishte tërhequr mënjanë dhe kishte bërë sehir. Kjo ishte e vërtetë, dhe ne, si shokë të brigadës që ishim, ja kishim vënë në dukje kaq herë këtë.

Tani ai s'kishte bërë zë fare, veç kishte mbledhur kallamat në heshtje. Kishte frikë se mos i zemërohesha dhe nuk i shkoja për t'i nxjerrë traktorin.

Tymi i zi, që u ngrit nga kapica me shkarpa, u ngjit në qiell. Skënderi vazhdonte të hidhte aty me të shpejtë kallama dhe copa drurësh.

Nuk kaloi shumë, kur u ndjenë nga larg zhurmat e traktorëve. Ishte Veraqi dhe Vasili. Me të parë tymin që u ngrit, ata lanë punën dhe u sulën për ndihmë.

Skënderi kishte ulur sytë dhe nuk i vështronte shokët, që posa kishin ardhur. Lajmin që kishte sjellë Skënderi, Veraqit dhe Vasilit, ua dhashë unë:

— Traktori i Skënderit është zhytur në pus.

— Është larg? — pyeti me të shpejtë Veraqi.

— Në parcelën e katërt.

— Fiu... — fërshëlleu Vasili.

— Të nisemi shpejt, Vasil, — vendosi aty për aty Veraqi.

Vasili dhe Veraqi u vështruan një copë herë në sy dhe, si qeshën me frikën e Skënderit të gjatë, ua hipën traktorëve dhe u nisën për te traktori i rrëzuar. Pas tyre u nisëm edhe ne.

Skënderi rrinte në anën e majtë të sediles dhe e mbante kokën poshtë, si të kishte bërë ndonjë faj...

Më erdhi për të qeshur me qëndrimin e tij. Nuk m'u durua dhe i thirra:

— Ngreje kokën, qafir!

6

Arritëm. Pusi ishte i madh dhe i thellë. Traktori i Skënderit nuk dukej gjëkund. U vërtitëm një copë herë të habitur rreth grykës së pusit. Nga sipër vështruam traktorin që ishte zhytur në të. Kishte rënë drejt, siç

kishte qenë duke ikur, dhe ishte mbështetur mbi zinxhirët e tij. Dëmtuar nuk ishte po për ta nxjerrë do ta kishim pisk.

Tomit kishte lidhur kokën me shami. E kishte me xhungë dhe të përgjakur. Fajen e kishte të enjtur dhe ishte i trembur, megjithatë, djaloshi nuk e bënte veten dhe mbahej shumë mirë.

Puna ishte e qartë. Traktori i Skënderit kishte rënë shumë keq. S'kishte ndodhur ndonjëherë të binte traktori kështu. Ndoshta Skënderi e kishte kuptuar rrezikun kur kishte rënë, prandaj dhe i kishte varur buzët. Duhej të dërsnim një copë herë të mirë, që ta nxirnim andej traktorin, vetëm se kjo punë duhej të fillonte shpejt.

Më vinte keq për djaloshin e ri. Nuk i kishte ecur fati, Tomit. Nuk kishte mbushur as tri ditë që kishte filluar punën në brigadë dhe ja ç'e kishte gjetur. E vështrova me keqardhje. Ai ishte ulur në bisht dhe buzët i kishte të thara. Koka i ishte enjtur dhe duhej të kishte dhembje të padurueshme.

Goditja do të kishte qenë e fuqishme dhe djaloshi duhej të kishte fluturuar si ndonjë top futbollit nga kabina. Traktori e kishte flakur jashtë dhe ai kishte shpëtuar. Ndryshe do ta kishte marrë me vete dhe do ta kishte çuar në fund të pusit.

— Je vrarë shumë? — e pyeta me dashamirësi.

— Jo... Pak, — dhe djaloshi, megjithëqë i plagosur, u ngrit më këmbë.

Veraqi s'kishte shok për të nxjerrë traktorët nga pusët. Ai mori një poplë të madhe prej torfe dhe e hodhi në pus. Tingulli që nxori popla ishte i trashë. Vasili psherëtiu, se nuk ju besua të dilte lehtë traktori i Skënderit prej andej. Vasili madje ishte bërë pishman që kishim ardhur deri këtu. E gjithë rruga, sipas mendimit të tij, ishte bërë kot së koti. Veraqi e vështronte vëngër dhe, bënte ç'bënte, pështynte sipas zakonisht të tij. Po Vasili e teproi me mosbesimin e tij dhe, si e humbi krejt durimin, tha:

— Është e kotë! Traktori nuk del që këtej, sikur dhe zemrën tonë ta shkullim nga vendi, ai nuk del që nuk

del dhe pikë! Ka rënë keq dhe s'ka njeri që mund ta nxjerrë.

Pastaj, si të donte të vërtetonte profecinë e tij, rrëmbeu një poplë torfe dhe e hodhi në pus, ashtu siç kishte bërë më parë edhe Veraqi. Nga pusi u ndie një «plluq, plluq» dhe asgjë më shumë.

Veraqi heshtte. Edhe unë nuk e hapja gojën. Skënderi ishte zverdhur e bërë dyllë. Nuk fliste dhe dridhej nga inati.

Gjashtë metra thellësi! — tha si i çuditur Vasili. — Gjashtë metra!.. Nuk janë pak! Thellësi e madhe!

—Tët..! — Ja priti Vasilit Veraqi. Ku i gjete gjashtë metrat? S'ka më shumë se tri metra.

Skënderi vështroi nga ana e Veraqit. Ky vallë të ishte ai Veraqi që e kishte sharë e bërë leckë një javë përpara dhe që zihej me shokët kot së koti! Ndofta këto kishte në mendje ato çaste, prandaj e shikonte me kaq habi e mirëdashje Veraqin.

Por kryesorja tani për të ishte traktori. Kurrë nuk e kishte ndjerë veten kaq të shqetësuar. Nuk ishte shaka të humbiste një traktor të shtetit.

— Duhet të dërgojmë një njeri në fermë të lajmërojë brigadierin dhe të marrë kavon e gjatë, — tha më në fund Veraqi.

Skënderi erdhi në vete dhe u habit me kërkesën që bëri Veraqi. Nuk i pëlqeu kjo kërkesë.

— Pa brigadierin nuk del traktori, Veraq? — pyeti ai si me lutje.

— Jo, — ja priti shkurt Veraqi.

Skënderi u dorëzua. Përpara se të dërgonin njeri, Skënderi e pyeti edhe një herë Veraqin:

— Po të vijë Simoja, do të dalë?

Veraqi e vështroi thellë në sy Skënderin dhe u bind se tjetri ishte trembur. Pastaj Skënderit ju kujtua sherri që kishte bërë me Veraqin, dhe nuk i shkante kurrë në mend që ai do të sillej kaq mirë me të. Po Veraqi ja kujtoi grindjen:

— Po të ishte për ty, Skënder, traktori do të mbetej

...do të lënë në pus, sikur qameti të bëhet.
Kjo e kishte shtënë në mendime. Traktori i përbashkët. Kjo
ishte e vërtetë, dhe ai nuk e kishte kuptuar kurrë një gjë të tillë. Ndoshta e kishte marrë si një shaka këtë të vërtetë të madhe. Kushedi, dhe kështu mund të ishte. Tani ai nuk mund të mendonte asgjë. Vetëm mendonte të nxirrte traktorin.

Skënderi na kishte gënjyer. Ai nuk ja kishte lënë vërtet drejtimin e traktorit djaloshit, siç na kishte thënë neve, po kishte rënë në kanal, pastaj nga kanali traktori ishte zhytur në pus. Pra, Skënderi i gjatë na kishte gënjyer në mes të ditës. U tërbova. Më vinte të pëlçisja nga inati dhe të merrja traktorin e të nissha nga kisha ardhur.

Vasili u zverdh, kur dëgjoi Tomin të thoshte:

— Nuk ma kishte lënë mua traktorin. Unë i thashë: «Usta Skënder, është një gropë e madhe përpara». Ai qeshi dhe nuk e vështroi fare gropën që i tregova unë. Pastaj ndodhi ajo që vështroi, përmbysja.

Vasili mori zjarr dhe u hodh në traktorin e tij. Kërkoj të shkëputej prej nesh dhe të shkonte të fillonte punën në parcelën tek punonte. Ishte nevikosur e zemëruar nga gënjeshtria e Skënderit. Por, tek po i fuste marshin traktorit për t'u nisur, unë e ndala:

— Luajte mendsh! Shtrëngoi mirë vidat këtu! i thashë duke vënë gishtin në tëmthin tim. Ku kërkon të shkosh, apo do të na turpërosh?

Vasili ishte skuqur e ishte bërë flakë në fytyrë. Ai më shtyu me forcë dhe më tha si i tërbuar:

— Kush ka luajtur nga mendtë, unë, apo ai? Po tallet me të gjithë ne, dhe ne rrijmë e bëjmë sehir, sikur duam t'i themi: «Tallu, Skëndo, tallu, vetëm mos ikë nga brigada, aman. Mezi të kemi. Mos na bësh ndonjë të pabërë, se na more më qafë! E kemi përkëdhelur një çikë si shumë këtë djall. Vasili kishte të drejtë. Skënderi kishte kohë që sillej i largët me ne dhe shpeshherë në

pazarin e qytetit nuk na fliste fare me gojë. Kjo sjellje të tërbonte.

Skënderi ishte demaskuar keq. Ai vështroi me inat dhe përbuzje Tomin, që tregoi gjithë të vërtetën dhe i skërmiti dhëmbët atij.

Më në fund, u vendos që të niseshin unë për në fermë me gjithë traktorin. Hipi edhe Tomi në traktorin tim. U nisëm dhe shkuaam shpejt. Brigadieri na dëgjoi kokulur dhe na dha kavon e gjatë. E futëm në kabinën e traktorit dhe u nisëm prapë bashkë me Tomin. Simoja ishte nevrikosur dhe kishte mërmëritur nëpër dhëmbë. Ishte i zënë me punë dhe priste nga çasti në çast të vinte një i dërguar nga ministria. Më këshilloi t'u thoja dhe shoqëve të tregoheshin të matur dhe, si e fërkoji dhe një herë mjekrën mendueshëm, tha:

— Sido që të jetë puna, më vonë do të vij dhe vetë.

Po prapë ju ndërrua mendja. Nxori blokun, diçka shënoi në të, këputi fletën dhe e vendosi mbi derën e dhomës sonë. Pastaj hipi në traktorin tim duke thënë:

— Në djall le të vejë dhe maqina, po të më duan, le të më kërkojnë dhe të më gjejnë, shkojmë te traktori.

U nisëm. Traktori më punonte si sahat. Simos i ndritnin sytë nga një gëzim i fshehtë. Motorin dhe traktorin tim e kishte rregulluar vetë brigadieri, dhe gëzohej që punonte aq mirë. Ishte mjeshtër i rrallë Simoja. Po të zinte gjë me dorë, s'e lëshonte pa e rregulluar.

Koha ishte prishur dhe frynte erë. Retë e zeza kishin filluar të dyndeshin, po ne s'kishim kohë t'i vështronim ato.

Mbërritëm. Skënderi nuk na doli para syve. Veraqi i dha dorën brigadierit, dhe ky ja shtrëngoi me përzemërsi. Vasili nuk zbriti fare nga traktori. E përshëndeti Simon me dy gishtrinjtë së largu. Simoja e vështroi gjatë grykën e gropës. Ai kishte marrë pjesë në shumë raste të tilla. Kishte nxjerrë me dhjetëra traktorë, po gropë si kjo, ku ishte fundosur Skënderi, nuk kishte parë, ndaj rrinte si i habitur. Nuk kuptonte si djallin Skënderi kishte rënë në atë gropë. Nuk ishte e vogël, dhe dukej që larg. Si-

moja kruante kokën i zhytur në mendime. Po kështu bënte dhe Skënderi i shkurtër, që kishte mbërritur me gjithë traktorin. Ai kishte parë tymin, sinjalin që kishim ndezur ne dhe ishte nisur. Skënderi i shkurtër fërkonte çibanët e qafës dhe pëshpëriste:

— Bre !.. Sa keq që ka rënë !.. Sa keq !..

Më vonë, duke u kollitur, erdhi në vendin e ngjarjes edhe Sofokliu me gjithë traktorin e tij. Ai na dha të gjithëve dorën dhe e pyeti Skënderin:

— Pse i ke varur hundët?

Skënderi i gjatë heshti dhe uli kokën deri në gjoks. I ra një çehre e përvuajtur, që ja kalonte dhe asaj të njeriut më fatkeq që mund të ishte në botë. Ishte i shkëlqyer Skënderi për të marrë poza të tilla.

— Lëre, o Sofokli. Më mirë të më kishte rënë rrufeja, se më ra traktori në pus, — kështu u përgjegj Skënderi, dhe Sofokliu u tremb me gjithë mend, thua jse vërtet rrufeja do t'i binte Skënderit të gjatë.

— Mos folë ashtu, t'u thaftë goja! Ra traktori, po ne përse jemi? Ra, ne do ta nxjerrim..

— Ku është Faiku? — pyeti me habi Simoja duke i prerë fjalën Sofokliut.

Të gjithë kthyem kokën rreth e qark, po Faikun nuk na e zuri syri. Me siguri që ai ose do të kishte shkuar diku, ose po vazhdonte të punonte në parcelën e tij, pa e çarë dhe aq kokën për fatin e traktorit të Skënderit të gjatë. Kështu ishte Faiku. Ai vështronte gjithmonë punën e tij dhe nuk përzihej me të tjerët. Ishte një kopje e gjallë e Skënderit, po vetëm që Faiku kishte huqe të tjera. Dhe ne vetë nuk kishim mundur të zbulonim se kush ishte Faiku. Në shumë raste ai na qe dukur djalë shumë i keq, në disa raste djalë i mirë. Po sido që të na qe dukur neve, ai sot duhej të ishte midis nesh. T'i ndante me ne hidhërim e vuajtje.

Vasili zbriti nga traktori dhe m'u afrua me buzë në gaz. Më zuri për supi dhe më pyeti:

— Më trego, mos u ktheve nga furra? Si ishte ajo?

U habita nga pyetja që më bëri. E vështrova gjatë Vasilin në sy. Pandeha se mos bënte shaka, po nuk ishte




Fig. 1. The workers in the tunnel.

ashtu. Vasilit i ndritnin sytë dhe e kishte me gjithë mend. Vendosa të hakmerresha me të. E shtyva dhe u hoqa sikur isha zemëruar:

— Çfarë llozi! Je bërë si një dem i tërbuar. Neve po na digjet mjekra këtu, kurse ti... e ke mendjen tek ajo!

Efekti ishte i menjëhershëm. Vasili më mbërtheu dhe nisi të më lutej:

— Mos thirr!.. Kështu janë shokët?!

Simoja filloi të gërmonte. Të gjithë filluan të gërmonin. Kazmat i kishim marrë në fermë, na i kishte sjellë një karro si slitë. Ndoshta i kishte kërkuar Simoja. Kushedi, dhe kështu mund të ishte; ai kot nuk e kishte shkruar pusullën që kishte vendosur mbi derën e dhomës.

Vasili po gërmonte së bashku me mua dhe më kishte mbërthyer atë vështrimin e tij të egërsuar. Sofokliu na mërziti të gjithë me këshillat e tij të pafund:

— Mos rrëmoni shumë, jo këtej, mos e hidh andej dherin, mos e mblidh dherin andej, Veraq! Kështu është mirë. More, tallesh ti! — dhe qindra të tjera si këto.

Veraqi ja mbërtheu një herë sytë dhe teshtiu fort. Megjithëqë kjo teshtitje ishte paralajmërim serioz për Sofokliun, ky i fundit vazhdoi të fliste ende duke këshilluar.

— Të kishe rënë ti, Sofokli, në këtë pus, do të kishte shpëtuar e gjithë brigada, — ja plasi më në fund para syve Veraqi, i cili e kishte humbur durimin.

Sofokliu nuk u bë merak. Ai nuk ja vari fare të qeshurës sonë dhe vazhdoi me të tijat.

Na zuri nata, që na u duk se erdhi shumë shpejt. Qe natë e ftohtë. Ndezëm dritat e traktorit. Isha lodhur dhe ndjeja mornica në trup. Më thernin kockat, dhe faqet më digjeshin. Nga veriu frynte një erë e ftohtë që të priste si brisk. Natën, në kënetë erdhën nga ferma edhe punëtorët për të na ndihmuar. Ishin burra të mirë. Ktheheshin nga puna dhe, tek na vështruan që po vuanim, u ndalën dhe vendosën të na ndihmonin. Nuk pritën urdhër. Ne pranuan në heshtje ndihmën e tyre. Ata pështynë pëllëmbët dhe i hynë punës me qejf. Gërmonin më shpejt se ne dhe ja kishin marrë dorën bishtit të lopatës dhe

bishtit të kazmës. Ishte mesi i natës, kur kanali që dilte nga pusi u hap. Uji prej pusit kishte dal dhe, nën dritën e hënës dhe të prozhektorëve të traktorëve tanë, pamë skapamenton e traktorit të Skënderit.

Simoja e kontrolloi gjithë kanalin dhe u kënaq nga puna që kishim bërë. Po ç'është e vërteta punën më të madhe e kishin bërë fshatarët e fermës. Tani gjithë puna varej nga fortësia e kavos dhe nga forca që duhej të tregonin traktorët tanë. Simoja e mori kavon dhe na urdhëroi të hipnim nëpër traktorët. Simoja nuk nxitohet. Ai kontrolloi edhe një herë nivelin e pusit dhe nuk u kënaq.

Kur ne të gjithë prisnim urdhërin për tërheqje, zëri i brigadierit bëri të na ngriheshin qimet përpyjet:

— Zbritni nga traktorët!

Të gjithë zbritëm. Brigadieri na mblodhi të gjithë dhe na tha:

— Tërheqja do të bëhet nesër.

Filluam të kundërshtonim. Nuk na besohej që atë urdhër na e kishte dhënë brigadieri, po urdhëri që i qartë dhe Simoja kërkonte që ne ta zbatonim.

U nisëm. Ecnim në njëshkolonë. Fshatarët ecnin para nesh. Dëgjohej kolla e tyre. Ishim të trishtuar. Na vinte inat që nuk kishim mundur ta nxirrnim traktorin. Skënderi i gjatë e kishte humbur fare. Ishim të rraskapitur dhe të qullur. Uji na kishte hyrë në palcë. Filloi të bjerë edhe shi. Rrobot na ishin rënduar e na ishin bërë plumb. Ecnim në heshtje. Këmbët e lagura dhe të qullura na zhyteshin në llucën që porsa ishte formuar.

Kur arritëm në bazë ishim të kapitur. Dhoma ishte e ngrohtë dhe nuk po kuptonim se kush e kishte ndezur zjarrin. Tomi ishte midis nesh. Kosta ishte kthyer nga qyteti dhe i vinte turp të na dilte para syve. Më vonë doli nga qoshja, ku ishte fshehur dhe na hodhi një vështrim gjithë frikë e turp. Nuk ja vara vështrimit të tij dhe u mbështeta në jastëk. Kisha të nxehtë dhe digjeshja nga ethet. Pastaj dremita. Nuk ndjeva asgjë. Isha i dërmuar nga lodhja dhe më zuri gjumi. Natën nisa të përpiqem. U zgjova nga kolla e ashpër e Sofokliut. Nga ana

tjetër, u dëgjua mallëkimi i Veraqit. Gati gjithë natën kishte ndenjtur mbi kokën time Vasili. Ai kishte një pece të lagur, që mbante erë uthull dhe e kishte zënë gjumi me të në duar. U zgjua dhe më buzëqeshi.

— Si je? — më pyeti.

— Mirë, — u përgjegja i mallëngjyer. Më preku kujdesi i tij; kishte sakrifikuar gjumin për të më shërbyer. Veraqi filloi të grindej me Sofokliun. Pastaj ndërhyri Vasili dhe sherri mori fund.

Gjithë natën janë ndier krisma? — pyeti si me habi Simoja, që u çua nga gjumi.

— Sigurimi do të ketë rënë në gjurmë të banditëve, — sqaroi me gjakftohtësi Veraqi, si të ishte edhe ai në forcat e ndjekjes.

Nuk kuptoja se ku e kishte fjalën. Gjatë natës kisha qenë në kllapi dhe nuk kisha dëgjuar asgjë.

— Gjithë natën ka patur të nxehtë, — tha Sofokliu, duke më vështruar me dashuri.

— Pusho, Vasil! Na lërë të flemë! — Vasili u habit që po e akuzonin kot, dhe kërkoi të sqaronte se ai nuk e kishte hapur gojën fare.

Kosta me gjithë Tomin kishin dalë jashtë. Nuk qe gëdhirë akoma. Ishim ngritur shpejt. Nata qe e gjatë, dhe gjumi na dilte herët. Vasili më fërkoji qimet e faqeve të parruara dhe më tha me zë të ulët:

— Kalova andej nga furra, po ishte mbyllur.

Jashtë u ndien këngët e këndezave. Ishte gëdhirë. Të gjithë u çuan nga shtrati dhe filluan të vishen. U çova dhe unë. Trupin e kisha të drobitur dhe të leqendisur nga ethet, po nuk më rrihej në shtrat. Shokët do të shkonin në punë për të nxjerrë traktorin e Skënderit, dhe ishte turp që unë të shkëputesha prej tyre e të dergjesha në shtrat. Pranë meje u afrua brigadieri. Ai ishte i zymtë dhe i kishte sytë të buhavitur nga gjumi.

— Ti rri në shtrat sot! — më urdhëroi ai.

Qesha me urdhërin apo këshillën që më dha dhe shko-va të laja sytë. Vasili më vështroi një herë me inat, që nuk ndenja shtrirë në shtrat dhe me kaq gjithë puna mori fund. Binte shi si me gjyma. Ishte errësirë, dita

ngjante shumë me natën. Kur mbërrijtëm tek traktorët, ishim bërë dordolecë. Uji na ishte futur gjer në palcë. Unë e pata lehtë, se Kosta nuk më la të zeja gjë me dorë. Ai e ndezi vetë traktorin dhe e nisi për te shokët. Ja kishte marrë dorën zanatit dhe nuk kisha frikë nga Kosta. Ishte djalë trim dhe i urtë. Traktorët e tjerë u ndezën me naze, sepse manjetat u kishin marrë lagështirë. I hapëm dhe i pastruam me shamitë tona, që ishin bërë pis.

Punën më të madhe e kishim përpara, dhe brigadieri ishte i shqetësuar. Veraqi doli vullnetar për të lidhur kavon te koka e kanxhës së traktorit, që kishte rënë në pus. Ishte një punë e vështirë, që kërkonte forcë, durim dhe shkathtësi. Veraqi do të zhytej në ujin brisk të ftohtë të pusit dhe, si një palombar, do të mbante rezervat e ajrit në mushkëri dhe do të lidhte kavon me kanxhë. Në kohë normale dhe jo në ujë, po mbi tokë, gjithë ky proces për lidhjen e kavos në kanxhë vazhdonte të paktën dy minuta. Po nën ujë dhe në të ftohët sa do të vazhdonte?

Brigadieri kishte vendosur të zhytej vetë në pus, po ne nuk e lejuam. Ai vuante nga reumatizma, dhe një zhytje e tillë ishte vetëvrasje për të. Të gjithë e njihnim shumë mirë brigadierin. Ishte një shok i mirë dhe një komunist i rrahur me vështirësi. Veraqi ja rrëmbeu kavon nga duart brigadierit dhe, pa pritur urdhër, mori vrull e u zhyt brenda në pus. Nga pusi u përhapën stërkala uji që na lagën. Më vonë, pamë kokën e Veraqit që doli jashtë, gojën e tij që u hap dhe mori frymë thellë, zhytjen e tij të rrufeshme dhe pastaj asgjë... përveç rrathëve të ujit që u përhapën në sipërfaqe, si të ishte hedhur një gur i madh në pus.

U shqetësuam. Pse vallë u vonua kaq shumë Veraqi? Ndërsa zemra po na rrihte shpejt për fatin e shokut tonë, ai doli nga pusi fitimtar. Kavoja ishte lidhur. Të gjithë e përqafluam Veraqin dhe e puthëm. Brigadieri i kishte sytë të përplotur nga emocioni. Veraqit i kërcisnin dhëmbët. E mbështollëm me batanie. Do të kishim bërë shumë mirë sikur të kishim marrë pak konjak. Konjaku në të tilla raste është ilaç, po ne konjak nuk kishim. Ndezëm një

zjarr të madh dhe Veraqi u ul afër tij. Shiu vazhdonte të binte. Veraqin e zhveshëm fare dhe e veshëm me peliçet tona gjysmë të lagura. Pastaj, duke ndenjtur pranë zjarrit, ai e mori veten. Dita ishte hapur, dhe retë sa vinin e shkarkoheshin.

Lidhja e kavos kishte marrë fund. Po kjo nuk do të thoshte aspak se traktori kishte dalë jashtë. Jo. Gjithë punën e vështirë e kishim përpara. Tani fillonin avazet dhe stërmundimet. Duhej të tërhiqnin të gjithë traktorët me radhë dhe me kujdes. Forca e tërheqjes duhej të ishte e barabartë për të gjithë traktorët. Vetëm kështu energjia e gjithë traktorëve shkrihej dhe bëhej një e vetme.

Më kishte kapur një frikë e pashpjeguar, ndoshta kjo vinte nga temperatura që kisha. Një dobësi të tillë nuk e kisha provuar kurrë ndonjëherë, dhe Simoja na tregonte shumë gjëra për frikën, që, sipas mendimit të tij, ishte dobësia më e madhe që kanë njerëzit.

Kisha hipur në traktor. Kosta kishte ngulur këmbë që të rrija i qetë dhe të mos zeja leva me dorë, po unë kisha qejf të merrja pjesë në nxjerrjen e traktorit të Skënderit. Traktorët ishin lidhur të gjithë njëri pas tjetrit me kavo dhe, me një kavo tjetër, më të gjatë se ajo që kishim lidhur traktorët tanë, ishte lidhur traktori i Skënderit që ishte brenda në pus. E mbaja kokën jashtë kabinës, që ta vështroja më mirë dorën e brigadierit kur të jepte sinjalin. Afër meje, në të majtë të sediles, ishte ulur Kosta. Të dy ishim të emocionuar dhe prisnim me padurim sinjalin që do të jepte brigadieri.

Sinjali u dha.

Traktorët bënë të gjithë në një kohë përpara, si të xhindosur. Skapamentot e tyre ulëritën fort, dhe tërë kënetat zuri të dridhej si ndërthe. Por megjithëqë u vërsulën me furi, traktorët nuk mundën të bëjnë asnjë hap përpara.

Tomu u tremb ashtu siç ishte, në mes të traktorëve që bënë të gjithë para tij për të shkukur traktorin nga pusi. Ajri dridhej dhe toka lëvizte nën këmbët e tij, sikur po binte tërmet. Kërcëllitja e skapamentove dridhte

ajrin dhe zinxhirët, që ishin ngjeshur thellë në tokë, gërmonin gjithë inat dhe dukej sikur dheut i ishin ngulur dhëmbët e një kafshe gjigande, që ndeshet me tokën për jetë a për vdekje.

Tomë nuk kishte parë kurrë në jetën e tij një ndeshje të tillë, dhe ishte trembur. Por më vonë e kishte marrë veten. E kishte kuptuar se kjo ishte lufta e teknikës me tokën e kënetës, që donte të përpinte një traktor.

Tomë nuk kishte parë se si dridhej toka dhe se si traktorët e lidhur njëri pas tjetrit tërhiqnin gjithë zhurmë traktorin e rrezuar. Për t'i dhënë zemër njëri-tjetrit, bërtitnin me të madhe dhe u jepnin gaz motorëve. Të gjithë ulërinim. Bërtiste Skënderi i gjatë, që vështronte luftën dhe sakrificën që bënim për traktorin; na vështronte Simoja, që kishte hipur mbi traktorin e Veraqit, i cili tërhiqte i pari. Të gjithë vështronim njëri-tjetrin dhe i jepnim guxim shoqi-shoqit me britma.

Klithma që nxirrja unë ishte e ngjirur dhe e vrazhdë. Nuk kisha zë të mirë, isha ngjirur. Filloi të thërriste e të na jepte zemër edhe Tomë. Traktorët, si të kishin marrë zemër nga zëri i tij, lëvizën përpara një centimetër, pastaj dy, tri, katër, një metër, dy, tri... dhe nga kanali i hapur gjithë natën e kaluar filloi të dilte si një vapor i mbytur e i mbuluar me llum traktori i Skënderit të gjatë. Më shumë nga të gjithë dhe me lot në sy thërriste Skënderi, që ishte bërë si i prishur mendsh nga gëzimi.

Interesant, si kishte dalë traktori! Në fillim kishte dalë skapamentoja, pastaj kofonoja dhe më vonë gjithë traktori! Por gëzimi ynë qe i parakohshëm. Traktori i Skënderit na kishte ngecur në të dalë të grykës së pusit dhe nuk shkonte përpara. U desh ta hapnim edhe një herë më thellë kanalin, që të shkonte puna në rregull.

Skënderi, në fillim, kur pa traktorin që ngeci në grykën e pusit, u bë dyllë i verdhë, atij i ngriu në buzë e qeshura, kurse më vonë i qeshi nuri dhe filloi të bërtiste përsëri.

U munduam deri afër drekës për ta nxjerrë traktorin e Skënderit jashtë rrezikut. Ai duhej të dilte fare

nga vendi ku ishte dhe të pastrohej dalëngadalë në një vend tjetër, më të thatë dhe më të pastër.

Skënderi u tregua i dashur dhe na puthi të gjithë në faqe. Nuk e dinim në kishte bërë kthesë në sjelljet e tij, apo hiqej kështu i dashur sa për sy e faqe. Kur të gjithë ishim të gëzuar për nxjerrjen e traktorit, andej nga horizonti i kënetës u pa një grup kalorësish që po vinin. Në fillim ata dukeshin si pika të vogla në horizont, po më vonë ato pika u qartësuan dhe ne dalluam me habi, në mes të atij grupi, drejtorin tonë që po vinte kaluar. Ai ishte i shqetësuar dhe na bënte shënjë të rregulloheshim dhe të rrinim urtë. Mua më bëri shënjë t'i hiqja duart nga xhepat. Ai kafshonte buzën duke na vështruar të gjithë. Ç'kishte ndodhur me të? Përse kafshonte buzët. Më vonë i morëm vesh të gjitha, me të kishte ardhur ministri për të kontrolluar brigadën tonë.

Ministri kishte hipur mbi një kalë të bardhë. Ishte një burrë rreth dyzet vjeç, i qeshur në fytyrë. Zbriti nga kali dhe na dha dorën, si të njihej prej kohësh me ne. Pastaj na dha dhe cingare. I vështroi me kujdes të gjithë traktorët dhe pëshpëriti me keqardhje:

— Po, keq i paskeni punët.

Brigadieri i doli përpara dhe i tregoi se sa e madhe ishte gropa ku kishte rënë traktori i Skënderit. Ministri i dëgjoi me vëmendje fjalët e Simos dhe pyeti për Skënderin.

Skënderi ishte trembur, zverdhur e bërë si limua, po ministri bisedoi me të duke bërë edhe shakara. E pyeti si i kishte nga shtëpia dhe a ishte i kënaqur nga puna. Skënderi u përgjegj duke u treguar i kënaqur për gjithshka, dhe për këtë Veraqit i erdhi inat.

Pastaj, ministri na mblodhi rreth tij dhe na tha:

— Këneta është vend i vështirë. Ju lumtë, shokë, për punën që keni bërë. Megjithëqë ky është vend i vështirë për t'u punuar, juve ju bie barra që ta shpyllëzoni, ta ktheni në tokë buke, shokë, që të ketë sa më shumë grurë dhe bukë për popullin. Partia dhe populli nuk kanë për t'i harruar mundimet dhe sakrificat që keni bërë e po bëni për hapjen e tokës së re.

Ministri foli shumë mirë dhe ne të gjithëve na u bë qejfi. Sofokliu donte t'i thoshte ministrit për gazetën që nuk na vinin, po nuk e la Veraqi. Sipas këtij, ishte e kotë ta bezdisje ministrin për një gjë kaq të vogël siç ishte puna e gazetave. Ndoshta kjo ishte dhe arsyeja që Sofokliu kishte heshtur dhe nuk kishte folur.

Ministri e pyeti Simon:

— T'ju ndihmojmë dhe ne, shoku brigadier?

Simoja heshti dhe ju skuqën faqet nga turpi. Ku ishte parë që ministri të vinte dhe të ndihmonte brigadën e tij!? Pastaj, Simos ju kujtua Stilloja. Ku djallin ishte fshehur ai? Ta kishte këtu para syve, që të shihte dhe vetë se me kë punonte brigada e shtatë. Traktori i Skënderit ishte bërë gjithë batak dhe lëmyshk. Uji i kishte hyrë edhe në motor. Duke e pastruar, Tomi gjeti edhe një ngjalë në sedilet e traktorit. Të gjithë qeshëm kur pamë ngjalën, qeshi dhe vetë ministri. Kur u largua prej nesh, e kujtuam edhe për shumë kohë atë burrë të mirë, që na e kishte hequr si me magji lodhjen.

Kur mbetëm vetëm, Skënderi ju vërtiti një herë traktorit rreth e rrotull dhe, si e pa që s'kishte njeri, ja futi me shkelm në zinxhir duke e sharë:

—Kodosh!.. për pak më more më qafë!

7

Faikun e takuam më vonë. Duke u kthyer nga parcela, e hasëm në rrugë. Traktori i tij ishte nxehur dhe nga tapa e radiatorit dilte avull. Ai na u hoq si leshko, si një njeri që nuk di se ç'bëhet rrotull tij. Por, sido që të hiqej Faiku, ne s'ishim aq të trashë sa mendonte ai. E morëm vesh edhe punën e papëlqyer që kishte bërë, duke u zënë me rojen e fermës, i cili nuk e kishte lënë të merrte patate në parcelë.

Faiku ishte rruar dhe kishte veshur një këmishë të larë. Këmisha nuk ishte e re, dhe arnat shkonin deri në jakë. Kjo i rrinte shtrembër dhe mezi ja mbulonte arrëzën e qafës. Na vështroi të gjithë me radhë, si të donte të zbulonte mendimin që kishim për të.

— Ku ishte, «i dashur» Faik?

Në fjalën «i dashur» kishte një theks tallës, ironik nga ana e Veraqit.

Faiku u tregua i trashë. Ai nuk e kuptoi se ku i rrihte çekani Veraqit. Buzëqeshi dhe fërkoj mjekrën e rruar.

— Për nder, në ju gënjej, u shfajësua ai dhe vazhdoi të qeshte. — Kisha vjehrrën sëmure. Këtë lajm ma solli një fshatar që kaloi këndeje për në qytet. Vendosa të sulem një herë, sa është gjallë.

E kuptonim që na gënjente, dhe këtë e bënte pa pikë turpi. Nëpër kënetë ende nuk ishte lehtë të kaloje dhe fshatari i tij, që i kishte sjellë lajmin, duhej të kishte kaluar me balonë

— Mos na i shit neve ato! Ke shkuar pa lejë, dhe ke bërë gabim!

Kërcënimin e Veraqit Faiku e mori si një shaka të zakonshme dhe nuk i vuri rëndësi. Po Veraqi nuk i kishte aspak me shaka vërejtjet që po i bënte Faikut. Ai zbriti nga traktori i tij dhe ju afrua traktorit të Faikut. Hipi mbi zinxhir dhe hoqi tapën e radiatorit. Nuk kaloi shumë dhe prej andej Veraqi nxori patatet e ziera, që valonin në radiator.

— Përsëri ke vjedhur patate, — zëri i Veraqit tashmë ishte i ashpër.

Faiku nuk foli, por vetëm buzëqeshi.

Më vonë Faiku i tha:

— Merri, janë shumë të mira!

Prisja se ç'do të bënte Veraqi. Ai e peshoi një herë njërën patate, pastaj e flaku tutje me neveri. E mora vesh se si ishte puna. Faiku e kishte shkelur me të dyja këmbët. Na kishte turpëruar. Na kishin treguar se gjatë Luftës nacionalçlirimtare, në qoftë se dikush vidhte qoftë dhe një patate, dilte në gjyq. Na u prish gjaku më shumë, për këtë ishte fajtor Faiku. Në mbrëmje u kthyem në stacion. Ishim të lodhur. U habitëm kur takuam atje sekretarin e partisë. Ai ishte një burrë i urtë dhe nuk i vinte mendja kurrë në të këqiat. Gjatë luftës kishte qenë partizan i Brigadës I Sulmuese.

U mblodhëm të gjithë. Nuk më shkonte në mendje se mbledhja e brigadës do të bëhej kaq shpejt. Në dhomë ishte qetësi. Nuk ishte shënjë e mirë kjo. Populli thotë se mbas shiut ka kohë të mirë, dhe se mbas qetësisë shpërthen shtërgata. Mirëpo kjo shtërgatë nuk ishte dosido, në mbledhje merrte pjesë dhe sekretari i partisë, dhe kjo nuk ishte një gjë e rastit. Prisnim me padurim se kush do të ngrihej të fliste i pari.

— Me lejë! — kërkoi fjalën Veraqi.

— Urdhëro, Veraqi!

Ngrihet Veraqi dhe ja bën kurrizin Skënderit më të butë se barkun. Jo vetëm kaq, po ta ngatërroi Skënderin dhe me punën e allishverishit që bënte me reciprokun, aq sa Skënderit i shkuan shtatë palë djersë. Nuk fliste, vetëm rrinte në qoshen e sallës si pulë e lagur.

Sofokliu kishte ulur kokën dhe nuk kollitej, ndërsa Faiku ja kishte mbërthyer vështrimin i frikësuar Veraqit, që po vazhdonte të fliste. Skënderi i shkurtër po fërkonte çibanët.

Veraqi ju kthye dhe Faikut e më ta bëri atë për ujë të ftohtë. Pa pikë turpi ja tha para syve fjalën «hajdut». Mua më erdhi rëndë nga kjo fjalë dhe mendova që Faiku do të ngrihej e do ta bënte Veraqin fërtele, që e shau aq rëndë. Po Faiku nuk luajti nga vendi, ndenji pa bërë zë në stolin te qoshja ku ishte ulur. Veraqi mbaroi dhe u ul në vend.

E mori fjalën Skënderi i shkurtër:

— Nuk jemi mirë me jorganët. Kemi të ftohtë natën, dhe nuk kujtohet njeri të na i sjellë.

Të gjithë i dhanë të drejtë Skënderit të shkurtër, që ishte kujtuar më në fund për nevojat tona.

— Po çështja e Skënderit dhe e shokut Faik, si ju duket, shoku Skënder? A ka të drejtë shoku Veraq, që i ngriti këto probleme që kanë lidhje me të dy shokët? — e pyeti sekretari i partisë Skëndon.

— Au! Si ore nuk ka të drejtë Veraqi? Shumë të drejtë ka, dhe nuk i tha dot të gjitha. Faiku nuk ka lënë kungull më këmbë. Na e nxiu faqen në gjithë sektorin. Kaq kisha unë.

Sekretari mbajti shënim kërkesat e Skënderit të shkurtër dhe na dha fjalën se do të interesohej. Faiku ja kishte ngulur sytë gjithë inat Veraqit. Ju kujtua një ngjarje e vjetër dhe kërkoi fjalën:

— Veraqi tha këtu se unë vjedh. Mirë, ta zëmë se unë vjedh patate, kunguj dhe lakra, po pse nuk ngrihet shoku Veraq e të thotë këtu se si ai së bashku me shokun Vasil ndiqnin çupat e sektorit me traktor? Posi, çupat! E gjithë kooperativa u vu në ndjekje të këtyre shokëve. E morën vesh të rinj e pleq historinë, dhe u bë një diskutim që u tund dheu. Këto të thoshte në fillim shoku Veraq, pastaj të vështronte se si i vjedh unë patatet. Të gjithë kemi marrë patate, apo jo?

Kjo që thoshte ishte gënjeshtër. Kush kishte marrë patate? Për kë e kishte fjalën Faiku?

Sofokliu nuk duroi dot. I vinte të pëlçiste nga inati, tek shihte tjetrin që gënjente kaq paturpësisht, dhe tha:

— Gënjen njeriu, shoku Faik, por jo kështu si ju. Ngjarjen, që e fryni ju, shoku Faik, e dimë të gjithë, dhe shoku Veraq është dënuar për këtë veprim të pahijshëm. Po nuk flitet kështu si ju, shoku Faik. Veraqi me të drejtë ju vuri në dukje një sërë të metash që kenë, dhe sidomos vesin e të të vjedhurit. Përse nuk pranoni gabimet tuaja, të bëni autokritikë dhe të zotoheni se nuk do t'i përsëritni në të ardhmen?

— Ju flisni kështu, Sofokli, sepse e keni shok Veraqin...

Ne të gjithë qeshëm me logjikën e varfër të Faikut. Si nuk kishte turp kur mendonte kështu!

— Të gjithë njerëzit e ndershëm dhe të mirë unë i kam shokë, — tha Sofokliu. Jam komunist dhe nuk di të gënjej. Edhe ty do të të kem shok, por jo shok sa për sy e faqe, shok të mirë dhe të ndershëm.

Faiku ja nguli sytë Sofokliut. E shikonte me inat, si të donte ta hante. Sofokliu qeshi një copë herë nga vështrimi i tjetrit, dhe ja vuri në dijeni Faikut dhe këtë të metë, që kishte lidhje me kërcënimin që u bënte shokëve.

Ndeza një cingare. Më ishte çarë hunda dhe e kisha humbur mendjen pas diskutimeve. Vështroja Tomin. Ai ishte miqësuar me Kostën dhe ndiqte i kënaqur vazhdimin e mbledhjes, që ishte ndezur flakë. Mbledhje të tilla të hapura dhe kaqë luftarake vetëm në klasën punëtore bëhen. Tomi kishte shumë gjëra për të mësuar, dhe mbante shënime gjithë zell. Si fillim nuk ishte keq. Tomi, me sa dukej, ishte djalë i urtë, punëtor dhe i zgjuar. Pyeste shumë dhe donte të mësonte shpejt. Nuk i kursehej punës dhe kjo është cilësia më e mirë që duhet të ketë një i ri. Faiku e kishte kthyer fletën. Ai filloi të justifikohet në një rrugë tjetër, që ishte më e turpshme për të gjithë ne. Kujtoi mungesën e ushqimit që kishim nga kooperativat bujqësore për të cilat punonim! Shpesh ushqimi nuk na vinte në rregull, kjo ndodhte për fajin e shokëve të kooperativave. Por ata e kishin kënetën larg dhe ishin në vlagën e punës. Po përse ta zente në gojë këtë gjë Faiku? Nuk ishte ky shkaku që ai merrte patate në parcelën e fermës.

Sekretari mbante shënim dhe nuk pyeste. Të gjithë kishim ulur kokën dhe nuk guxonim t'i vështronim shënimet e tij. Ishim të lodhur dhe të inatosur. Shpifjet e Faikut na kishin tërbuar dhe na e kishin shtuar më shumë mërzitjen. Jashtë ishte ftohët, dhe derën e dhomës e kishim lënë hapur që të dilte tymi i duhanit. Diskutonim me zjarr dhe bëhej potere. Nga muri që ndante dhomën matanë u ndie një e goditur e zgjatur dhe ne heshtëm.

— Me kujdes. Flisni ngadalë, matanë po flenë dhe nuk po i lemë rehat.

Të gjithë heshtëm.

M'u kujtua familja. Nëna.. Kushedi se ç'bënte ajo atë çast. E kishte zakon të më priste gjithmonë afër dritares duke bërë çorap. Kur ishte ftohët, e zente gjumi duke pritur mbi stufë. Më vonë nënën e kishte shqetësuar një mendim i keq. I qe dukur sikur djali i saj luftonte me diversantët. Kisha kohë që nuk kisha zbritur në qytet, dhe nënën me siguri e kishte marrë malli shumë.

Nuk flisnim. I kishim inat fjalët e tepërta dhe dis-

kutimet e gjata. Ato që dinim i shprehnim shkurt dhe pa turp.

Ishte qetësi e thellë.

Sekretari i partisë, i edukuar dhe i rritur në kolektivin tonë, i kishte mësuar shumë mirë huqet tona, prandaj u ngrit më këmbë, u shkoi një herë dorën flokëve që kishin filluar t'i zbardheshin dhe e nisi fjalën ngadalë e shkoqur. Sekretari e dënoi qëndrimin e Skënderit qoftë ndaj traktorit, qoftë ndaj ndihmësit të ri, kritikoi dhe dënoi sjelljen e Faikut, që nuk interesohej për brigadën dhe shokët që ishin atje, po e kishte mendjen tek patatet e tek vjehrra, kritikoi dhe drejtorin që ishte treguar indiferent karshi nesh dhe brigadës, pastaj bëri edhe një autokritikë të shëndoshë.

Ja kishim hedhur vështrimin sekretarit të partisë, që fliste ngadalë, duke shikuar herë pas here pikat që kishte shënuar në blok.

— Me lejë, shoku sekretar: Pse nuk na vjen gazeta, — tha Sofokliu, të cilin nuk do ta zente gjumi natën po të mos fliste për punën e gazetave.

Sekretari u habit. Ai pyeti me interesim për këtë çështje. Më në fund, sekretari i partisë na porositi të jemi vigjilentë, sepse armiku i brendshëm dhe i jashtëm nuk pushon së vepruari. Nuk di se pse atëherë m'u kujtua nëna dhe frika e saj nga diversantët dhe kulakët. U habita kur dëgjova sekretarin e partisë t'i hiqte vërejtjen brigadierit tonë. Ai në dukje ishte djalë i mirë dhe punëtor. Por sekretari ama kishte pasur të drejtë. Brigadieri ishte bashkuar me gabimet e disa shokëve tanë që u kritikuan.

Ramë të flemë. Ajo ishte nata e parë e qetë dhe pa romuze. Vasili më pëshpëriti në vesh:

— Edhe sot nuk e pashë shitësen. Më ka hyrë merak që nuk munda t'ja mësoj shtëpinë. Emrin ja mësova. E quajnë Shkëlqime. Emër i bukur, ë? — Shkëlqime, — përsëriti ai. — Mirë ja kanë gjetur, për nder.

— Natën e mirë, — ja prita ftohët Vasilit, duke i kthyer kurrizin.

— Çfarë njeriu që je! Pastaj më çan veshët duke më thënë «jam shoku yt».

Vasili do të kishte vazhduar ta shfrynte më shumë dufin e tij kundër meje, sikur të mos isha ngritur mbi bërryle dhe ta kisha kujtuar.

— Jam i sëmurë, Vasil.

— Dëngla me bisht. Thuaj më mirë se je ziliqar, dhe pikë. Të kujtohet? Kur ke patur nevojë për të treguar diçka, kam qenë unë ai budallai që të kam dëgjuar deri në fund.

Vasili fliste ngadalë.

— Dëgjo, Vasil! Së pari, mua nuk më pëlqen që ti je lidhur kaq shumë me atë vajzë; së dyti, ke filluar të biesh në sy të njerëzve, kur merr bukën. Shkon e mbërthehesh në atë djall qoshe, ku shet bukë ajo dhe ngrin atje si një copë akull. Pastaj, le ç'emër i bukur është ky emri Shkëlqime që na paska ajo! Për mendimin tim, ky është një emër borgjez dhe mos harro se, çdo gjë që shkëlqen, nuk është ar.

Vasili më tërhoqi për mënge dhe më afroi pranë tij. Fryma që i dilte nga goja më gudulisi te veshi:

— Se çfarë flasin njerëzit, ajo pak më hyn në qese. Pastaj, kush të ka folur për shkëlqime ty, miu i Jorgjisë. Asnjeri. Në fund, as që bëhem merak në të pëlqeka ose jo emri i saj, lloz. Me kë flas dhe unë i humburi për të tilla punë! Me ty, që në vend të zemrës, me siguri do të kesh një pllakë zinxhiri prej traktori.

Me kaq biseda jonë mori fund dhe ne i kthyem kurrrizin njëri-tjetrit.

8

Kosta e Tomi u lidhën shpejt. Në mëngjez, të gjithëve na tërhoqën vëmendjen këto fjalë të shkruara me gërma të mëdha në një copë letër të mbërthyer me gozhdë në mur: «Ndalohet heqja e këpucëve në dhomë. Kundravajtësit do të gjobiten me një të fshirë dhomë». Kjo parullë ishte shkruar shkurt dhe qartë. Mos të hiqen kë-

puçët në dhomë! Po ku djallin duhen hequr ato? Mos vallë në qiell, apo në hënë? Këpuçët janë bërë për t'u hequr dhe higen, kur njeriu hyn në dhomë. Por, megjithëse mendoja kështu, rregulli ishte vënë. Brigadieri i pari dha shëmbullin personal, duke i hequr këpuçët në korridor. Pamë, ç'pamë, i hoqëm edhe ne. Korridori ishte i ftohtë. Sofokliu psherëtiu një herë gjatë dhe i hoqi këpuçët, duke mërmëritur. Meqenëse në korridor ishte ftohët, unë mendova që parulla, së paku, të ishte kufizuar për stinën e verës.

Në dhomë hyri Vasili, i cili qe kthyer nga furra. Ai ishte larë dhe fytyra i shkëlqente. Flokët i kishte krehur me kujdes dhe u kishte dhënë formë me gishta. Ngjante me ata fëmijët që janë pikturuar mbi qeskat e «Tallkut».

— Siç duket, do të bëjmë edhe një mbledhje tjetër për Vasilin! — tha gjithë djallëzi Sofokliu.

— Pse, o Sofokli? — tha Vasili duke ngritur vetullat i habitur.

— Sepse ke filluar tu mbash erë bajgave.

Kjo fjalë e vrazhdë e bëri Vasilin të skuqej, dhe Sofokliu bëri gabim që u tall lkaq rëndë me të. E kishte gabim Sofokliu që mendonte keq për Vasilin. Ai ishte djalë me karakter dhe i ndershëm. E vërteta ishte se me ardhjen e shitëses së re, Vasili kishte filluar të trubullohej. Ne i shihnim në heshtje veprimet e tij. Kushedi, ndoshta Vasili kishte menduar për krijimin e familjes.

Në mëngjez, traktorët i gjetëm të ndezur dhe kjo na kënaqi të gjithë. Sofokliu e kishte mbaruar riparimin e skatullës së majtë të diferencialit dhe ishte nisur për në punë. Kjo ishte arësyeja që ai ishte fjalëpakë dhe nxitonte në të ecur. Kishin filluar të nxirrnin plehun jashtë stallave, dhe ajri mbante erë të këndshme. Na ishte djegur shpirti për një kafe, po kjo ishte krejtësisht e pamundur, sepse klubi kishte një orar të habitshëm, që na linte pa kafe.

Skënderi i gjatë psherëtiu si me dëshpërim e si nervoz. Ai nuk e shau Tomën, që kishte ndezur traktorin vetë, por dhe nuk i tha as mirëmëngjez. U tremba tek

e shihja Skënderin e gjatë gjithë nerva. Prisja që ai t'i hiqte veshët ndihmësit të tij, që kishte guxuar të ndizte traktorin. Po, për habinë time, një gjë e tillë nuk ndodhi.

U nisëm për në punë. Traktorët shkonin në njëshkollonë, me zinxhirë të zhytur në ujë. Më dukej sikur kjo ecje do të ishte e gjatë dhe pa mbarim. Në kënetë kishte rënë mjegulla. Ajo kishte mbuluar gjithshka, bile edhe traktorin e shokut tim, që shkonte përpara. Isha zhytur në mendime. As klithma e një guaku, as dhe fluturimi i një tufe rosash nuk më bënë përshtypje. Më dukej se kisha kryer një faj të rëndë dhe për këtë isha me shpirt të vrarë. Nuk më vinte mirë që në brigadë të ndodhnin këto gjëra të papëlqyera.

Në drekë e lamë punën. U takuam në karroofigjinën që kishim lënë në mes të rrugës. Nga larg karroofigjina dukej si një ishull në mes të ujit. U mblodhëm të gjithë. Mungonte vetëm Faiku, i cili kishte vendosur të mos bashkohej me ne. Vasili e kishte ngrënë gjithë racionin dhe vështronte me keqardhje triskën e bukës, që kishte dy lata mangut. Me harxhimin e latave të triskës së bukës së Vasilit ishte lidhur një kujtim i shtrenjtë: Takimi i tij me vajzën. Ai e kishte bërë zakon dhe vinte në furrë tri herë në ditë dhe, ngaqë nuk dinte se ç'të bënte, kishte filluar të harxhonte latat e bukës. Prej triskës së muajit, dhe mos harroni se jemi në vitin 1951, kishte ngrënë dy ditë avancë.

— Ke filluar të bëhesh llupës dhe të hash si derr! Mendo që muaji ka edhe dhjetë ditë për të dalë, kurse ti i ke zhdukur dy lata para kohe, — këtë qortim Vasilit ja bëri me inat Skënderi i shkurtër, që ishte shumë i interesuar për triskën e tjetrit. Por Vasili e shikoi me inat, dhe Skënderi i shkurtër e pa të udhës të largohej prej tij.

Kush pyeste për tri ditë bukë. Vasili? Jo. Le t'i shkruante ajo një letër dashurie, dhe Vasili rrinte dhe një muaj pa bukë.

Ishim mbledhur të gjithë në karroofigjinën dhe po prisnim të na vinte buka. Bukën na e sillnin nga larg, nga kooperativat e fushës, për të cilat dhe punonim.

Gjella, me sa dukej, nuk do të vinte shpejt. Më kishte marrë etja për ujë. Afër karroofiginës ishte një pus. Pusi ishte i madh dhe rreth e rrotull grykës kishte kallama të kalbur. Uji ishte i gjelbër dhe, në fund të pusit, bretkosat rrinin të qeta. Në verë pusin e gjenim shpejt. Bretkosat dilnin jashtë dhe shullëheshin në diell. Ato këndonin gjithë gëzim, dhe ne pas këngës së tyre e gjenim pusin. Kur afroheshim ne, ato hidheshin të frikësuara në pus, dhe na linin radhën që të pinim ujë.

Llërët na ishin mbushur me puçrra të vogla. Sofokliu, duke u mburrur, na tha:

— Brezat që do të vijnë, do të krenohen me ne traktoristët e brigadës së shtatë, që kemi shpyllëzuar kënetën në kushte të vështira, si partizanët në luftë.

Neve na bëhej qejfi dhe pinim ujin e pusit. Skënderi i gjatë e kishte zakon që të psherëtinte para se të pinte ujë.

Sofokliu kishte të drejtë. Ndoshta brezat e ardhshëm, duke kaluar nëpër rrugët e fermës të shtruara me asfalt, duke kundruar gjithë kënaqësi fushat e bëra si qilim i gjelbër nga dora e punëtorit, nuk do të linin pa kujtuar dhe punën tonë, që e kishim transformuar kështu ish-kënetën.

Mbas tri orësh Sofokliu erdhi me vrap e duke gulçuar drejt traktorit tim. Ai ishte i djersitur dhe mezi merrte frymë. Në mes të kënetës kishte zbuluar një fole ujku. Këlyshët ishin rritur ca. Ulkonja i kishte lënë vetëm në fole, dhe vetë kishte dalë për gjah. Duke ngrënë fjalët, Sofokliu më tregonte:

— Këlyshët janë bojë hiri dhe sytë i kanë të verdhë dhe të egër. Nuk kanë filluar të ecin, dhe gjuhën e kuqe si piperkë e mbajnë jashtë. Janë gjithsej pesë, dy femra dhe të tjerët meshkuj.

Të gjithë e morën vesh që Sofokliu kishte zbuluar një kope me ujë. Na habiti fakti që ai nuk kollitej mbas gjithë atij vrapit që kishte bërë. Nga nxitimi, ishte përplasur nëpër plisat dhe kishte grisur pantallonat në gju-një. Kishte frikë t'i zente vetë, se trembej mos kthehej

ulkonja, që ja kalon edhe luanit kur zemërohet. Pesë ujë nuk është shaka, është një tufë e vërtetë. Atëhere kush vriste një ujë, shpërblehej me tremijë lekë dhe me një dele.

Sofokliu mori Veraqin dhe mua. U nisëm më këmbë. Nuk kishim qejf t'i merrnim traktorët. Veraqi rrugës na tregonte gjithë gëzim:

— Njërin do ta marr të gjallë, do ta rrit, do ta zbus e do ta bëj ndihmëstraktorist.

Unë e vështroja Veraqin dhe mendoja, se nuk do ta kishte vështirë ta bënte atë që na thoshte. Më vështirë do ta kishte ujku të zbuste Veraqin. Qeshëm që të gjithë me dëshirë e çmendur të Veraqit. Isha bërë kureshtar dhe isha shqetësuar. Nuk kisha parë ujë me sy dhe ja, po më jepej rasti. Më kishin treguar, se një herë, një ulkonjë e tërbuar kishte zbritur në mesnatë në qytet pa pikë frike. Ulkonja kishte bërë dëme të mëdha. Atëherë isha i vogël dhe nëna, e frikësuar, më kishte mbyllur me kyç brenda në shtëpi. Nuk di pse m'u kujtua kjo histori në mes të kënetës. Ndoshta nga ai vështrimi i ujëve të vegjël. Në mes të rrugës e kuptuam se kishim bërë gabim që i kishim lënë traktorët. Veraqi, si kokëshkretë që ishte, vraponte përpara, megjithatë nuk largohej prej nesh, sepse nuk e dinte vendin. Ngaqë kishim biseduar, mendjen e kishim humbur së bashku me drejtimin. U ndalëm, Sofokliu filloi të kollitej. Ai u zhyt thellë në mendime. Pastaj filloi të ngatërrojë veriu dhe jugun dhe të gjithë punën e rrugës e mori djalli. Filluam të ecnim ngadalë në grup. Kisha frikë se mos takohesha me ulkonjën. Po të ndodhte kjo, fajin do ta kishim vetë ne. Kisha dëgjuar nga të tjerët, se ulkonja, kur sheh që i rrembejnë këlyshët, bëhet si e tërbuar dhe ja kalon nga forca luanehës. Ndoshta kjo ishte e vërtetë. Nuk më vinte mirë me veten time. Mallëkoja veten që isha treguar aq solidar me mendimin e Sofokliut dhe aq mendjelehtë, që isha bashkuar me mendimet e Veraqit. Po sikur të dilte ulkonja? Më dukej sikur kallamat e **thata të kënetës** thyeshin nga pesha e këpucëve tona me një zhurmë të tmerrshme, si të pritej ndonjë pyll. Pastaj, sikur dëgjoja ulë-

rimën e qindra ujqve, që më ndiqnin mua. Në çast ndjeva sikur isha rrethuar prej tyre dhe sikur më lëpinin me gjuhën e lagur pëllëmbën e dorës, si të donin të provonin cilësinë e mishit tim. Hodha sytë dhe, për çudi, pëllëmba e dorës më ishte puçur me një fletë të lagur kallami. Më erdhi turp që më kishte kapur frika. E mora veten dhe fshiva ballin që ma kishte mbuluar djersa. Tek po ecja ngadalë përmes kallamave, u ndala sakaq në vend. Përpara meje, në mes të kënetës, u ndie një e gërhitur e thellë dhe e rëndë. Ndalua që të gjithë. Vështruam përpara. Në fillim mendua se ishte ulkonja, por u gabuam. E gërhitura, që kisha dëgjuar, ishte prej njeriu dhe jo prej bishe. Ishim katër vetë. Kush vallë e nxori atë gërhitje? Mos e kishte zënë gjumi Sofokliun duke ecur? Çfarë pyetje prej budallai që bëja. Sofokliu kishte ndalur në krahun tim dhe qe habitur më keq se unë. Tek po përpiqeshim të dallonim se ç'kishte tutje kallamave, shtangëm në vend. Tre njerëz të maskuar po flinin në kënetë me armët pranë. Gryka e automatikut të njërit rrezëllinte në diell dhe të vriste sytë, megjithëse ishte maskuar mirë me bar të gjatë. Njerëzit e maskuar i kishte zënë gjumi dhe gërhisnin rëndë. E kishim të qartë. Përpara nesh ishte një bandë diversantësh. Nuk bëmë zë. Vepronim me shënja. Më pushtoi të tërin një urrejtje e thellë. Si ishte ndryshuar ngjarja! U nisëm për të zënë ujq dhe ramë në diversantë. Në ato çaste m'u kujtuan fjalët e sekretarit të partisë. Ai na kishte këshilluar t'i bënim sytë katër sepse, sipas mendimit të tij, armiku vazhdonte të lëvizte. Në fillim nuk u kishim vënë rëndësi këshillave të sekretarit, por duke u ndodhur përpara faktit, para atyre burrave me mjekër dhe të armatosur, ne i dhamë të drejtë sekretarit të partisë dhe nuk na shkante mendja kurrë se do të ndodhte kështu. Nuk duhej t'i linim të na shpëtonin. Ishte marrëzi dhe tradhëti të tërhiqeshim tani, që e kishim përpara dhe kaq afër të gjithë bandën. Veraqi dhe Sofokliu ishin në një mendje me mua. Më kishte pushtuar zemërimi dhe më ishin errësuar sytë nga inati. U avitëm dalëngadalë, shkarazi. Njërin prej tyre, që, me sa dukej, do të kishte qenë roja, e kishte

zënë gjumi më larg nga shokët. Ai flinte si i vdekur mbi automatikun e tij, ndërsa dy të tjerët ishin mbështetur në gjokset e njëri-tjetrit. Të tre diversantët ishin llangosur me baltë. Mوندohesha të dalloja çizmet e tyre të ndotura, që më ngjanin si prej gome. Nuk i kishim më larg se tri hapa. Njëri prej tyre trazoi me pëllëmbën e dorës majën e hundës, që ja kishte pickuar mushkonja. Tek e pamë atë të lëvizte, u bëmë njësh me tokën. Po ai nuk u zgjua. Pritëm dhe disa çaste. Ndoshta këta do të ishin ata kodoshë, që dogjën traktorët e Pilos dhe Andreas. Tani ishim fare pranë. Sofokliu na bëri me shënjë dhe ne u hodhëm mbi ta. Diversantët nuk patën kohë të lëviznin. I kishim mbërthyer mirë dhe nuk u dhamë rast ta merrnin veten. Kosta u hoqi rripat e mesit dhe me to i lidhëm. Ata u habitën dhe mbetën gojëhapur. U dukej se ishin në ëndërr, dhe nuk besonin të ishin zënë e të ishin lidhur nga ne. Njëri prej tyre, një flokëverdhe, i shpëtoi nga duart Sofokliut dhe e goditi me grusht, pastaj nxori thikën nga mylli dhe i ra shokut tonë në sup. Me gjithë plagën që mori Sofokliu thirri:

— Veraq, më shpëtoi!

Diversanti deshi ta vriste fare Sofokliun. Ai mori hov dhe e goditi me thikë me gjithë forcën e krahut, po Sofokliu ju shmang goditjes dhe shpëtoi nga tehu i thikës. Nga plaga, që kishte marrë më parë, i rridhte gjak dhe i qe skuqur gozhupi.

Veraqi u dha në çast më këmbë dhe ja këputi me një grusht të fortë diversantit në nofull. Diversanti u vërtit si fugë dhe, me sy të çapëlyer nga forca e goditjes, u përplas duke ulëritur mbi kallamat e thyer nga pesha e tij. Nga buza e sipërme filloi t'i rridhte gjak. I hipa mbi kurriz, dhe **Kosta ja lidhi duart shpejt e shpejt. I** zumë. Fshimë djersët e ballit dhe psherëtimë të lehtësuar.

Sofokliu filloi të rënkojë. Pastaj ju zu fryma. Nuk ishte i zoti të bënte as edhe një hap përpara. Fytyra ju zverdh dhe ju mbush me bulëza djerse. Gishtrinjtë e dorës filluan t'i ftoheshin dhe ne na kapi frika.

Diversantët i kishim lidhur njërin pas tjetrit dhe ecnin kokulur, të rrethuar prej nesh. U ndalëm të dy me Sofokliun. E lamë grupin të kalonte përpara dhe u ulëm mbi kallamat. Balli i dërsirë i Sofokliut ishte mbushur me mbeturinat e kallamave të thyer. Dukej sikur Sofokliu kishte punuar në një maqinë silazhi, ku, në vend të misrit për t'u copëtuar, futeshin kallama. Ja hapa gozhupin e gjakosur. Sofokliu rënkoi. I dhimbte plaga. Pastaj, me buzët e thara, më tha:

— Shko me ta, më lërë vetëm, nuk kam fuqi të eci më këmbë.

— Luajte mendsh, ku të të lë? Këtu, vetëm? Nuk shkoj.

I kishim pirë të gjitha cingaret, dhe duhanin që na kishte mbetur të treve ja vumë plagës së Sofokliut. Po megjithatë, gjakun nuk mundëm t'ja ndalojmë. Diversanti flokëverdhë e kishte vështruar gjithë egërsi fytyrën e zbetë të Sofokliut. E vështroja me urrejtje atë kriminel, që e kishte katandisur në atë gjendje shokun tim dhe më dridheshin nofullat nga inati. Isha gati t'i hyja me shkelma, por e dija që do të gaboja.

— Vështro, — më tha me gjysmë zëri Sofokliu, që më shkëputi nga mendimet, — më lërë këtu dhe ndiz zjarrin! Me siguri që ka për të ardhur ndonjë shok. Do të mendojnë se jam fundosur në ndonjë pus dhe do të vijnë.

Mendimi i Sofokliut ishte i drejtë. Vendosa të veproja ashtu. Me të shpejtë hapa kanalim në mes të kallamave. Ishte një punë e rëndë dhe e mundshme. Duart filluan të më dhimbnin, por nuk pyesja për to. U vura zjarrin kallamave. Ata morën menjëherë dhe filluan të kërcëllijnë. Gjuhët e flakëve u ngjitën lart. Mbi flakë hodha shumë

torfë dhe u ngrit një tym i zi. Sofokliu ishte i kënaqur nga puna që kisha bërë. Na vështroi të gjithë dhe na dha urdhër:

— Shkoni, mos u bëni merak për mua! Shokët do të vijnë e do të më gjejnë. Nuk do të më lënë këtu.

Ne i shtrënguam dorën dhe qeshëm. U nisëm, nuk ishim larguar ende mirë, dhe mendjen e kishim tek ai. Kosta i hodhi një vështtrim të gjatë vendit tek e lamë dhe e nguliti në tru për të mos e harruar kurrë.

I pari që e pa tymin e zjarrit të ndezur tek kishte mbetur Sofokliu qe Tomi. Tek po grasatonte karetat e traktorit të Skënderit të gjatë sesi ngriti kokën dhe, i habitur, lajmëroi ustain në çast. Skënderi i gjatë hipi mbi zinxhirët e traktorit dhe e treti shikimin lart, andej nga dilte tymi. E kuptoi. Ajo vazhdë tymi ishte sinjal për ndihmë. Skënderi nuk e zgjati, po i dha urdhër të prerë Tomit:

— Hiqe spinotin e plugut! Do të shkojmë atje ku na thërresin.

Skënderi e tërhoqi pak më mbrapa traktorin dhe u ndal. Tomi stakoi më të shpejtë spinotin dhe i tha ustait të tij:

— Ec përpara!


Pastaj, Tomi e vuri spinotin në kabinë dhe u hodh si ketër në traktor.

Skënderi, që kishte ndjekur me interesim veprimet e ndihmësit të tij, ishte i kënaqur nga shpejtësia e djaloshit. Traktori mori me vrull drejtimin nga vinte tymi. Zinxhirët e rëndë thyenin pa mëshirë kallamat dhe poplat e dheut të zi, që sa ishin lëruar. Pak më poshtë traktori kapërceu një kanal.

Tomi vështroi me kujdes dhe imtësi të gjitha manevrat që bënte ustai i tij në kalimin e kanalit dhe fiksoi në mendje të gjitha lëvizjet.

Sipër tyre kaluan gjithë zhurmë një tufë çafkash.

Skënderit kishte filluar t'i pëlqente ndihmësi i ri dhe kishte vendosur t'ja mësonte të gjitha të fshehtat e zanatit. Ishte djalë i gjallë dhe i urtë Tomi. Skënderi kishte patur fat në ndihmësit.



Tomi ishte zhytur në mendime dhe udhëtonin të dy të heshtur. Skënderi, i kredhur edhe ai në mendime, vështronte përpara. Sikur të kishte rënë Veraqi me gjithë traktorin në ndonjë pus? Do të bëhej copë, që t'ja shpërblente të mirën që i kishte bërë.

Ndoshta atje mund të ishte dhe brigadieri, që do të shihte me sytë e vet se Skënderi nuk ishte aq i keq sa kishte dëgjuar prej të tjerëve. Dhe në qoftë se ai që ishte rrëzuar nuk do të ishte Veraqi, po ndonjë shok tjetër, Skënderi kishte vendosur të luftonte me të gjitha forcat për ta ndihmuar shokun, cilido që të ishte ai. I kishte vlejtur shumë kritika e Skënderit, dhe kishte filluar të arësyetonte drejt. Punën do ta kryente njëloj dhe me ndërgjegje. Tomi ishte i qetë dhe kishte hedhur edhe ai vështrimin përpara. Puna nuk i dukej e frikshme, si i qe dukur në fillim, dhe zanati po i pëlqente dhe po i hynte në zemër. Kishte filluar t'i dilte turpi dhe të pyeste këdo. Nuk i vinte turp të pyeste për të mësuar dhe vuri re se të gjithë e ndihmonin. Ishin shokë të mirë, dhe Tomi dita-ditës po zbulonte tek ata virtyte të reja. Tomi ishte i kënaqur që kishte filluar punën, dhe ishte krenar që e kishin caktuar në brigadën e shtatë, e cila kishte nderin të ishte në një nga frontet më të vështira. Ishim akoma larg shënjës, kur Skënderi e ndali papritur traktorin. Ju kujtua ai vend i njohur dhe hetoi me shikim gjithandej.

Skënderi u habit. Ai pa një grumbull këlyshësh që po pinin sisë në barkun e nënës së shtrirë. Si kafsha e madhe, që ishte e shtrirë, ashtu dhe këlyshët që po pinin sisë, nuk u trembën nga zhurma e traktorit. Ai ktheu me të shpejtë traktorin. Ju lëshua grumbullit të kafshëve dhe i dha gaz traktorit deri në fund. Po traktori shkante me shpejtësi të njëlojtë, se e merrte gazin automatikisht. Ai u kishte shkuar shumë afër kafshëve.

Ulkonja e lebetitur u ngrit më këmbë dhe i hodhi poshtë me forcë këlyshët, që ishin varur te sisat e saj.

Skënderit i qeshën sytë. Nuk e ndërroi drejtimin. Traktori çante përpara me shpejtësi. Ja ku shkuan afër, shumë afër. Skënderi mbylli derën e traktorit. Ai vuri re derën tjetër të traktorit, që ishte hapur.

— Mbylle derën, tutkun! — i thirri me zemërim ndihmësit.

Tomë mezi pati kohë të mbyllte derën e kabinës, kur u hodh mbi zinxhirët një shtazë e egërsuar, me dhëmbët jashtë, me sytë të zgurdulluar dhe duke ulëritur fort e me dhembje. Ndoshta kafsha, me atë ulërimë të lebetitshme kërkonte të lajmëronte këlyshët e saj që të largoheshin. Kushedi, mund të ishte dhe ashtu. Por zinxhirët e rëndë të traktorit e vunë atë nën vete dhe çdo gjë mori fund.

— Ulkonjë! — pëshpëriti gjithë habi Tomi.

Më tutje, Skënderi e ndali traktorin. Ulkonja së bashku me këlyshët e saj ishte shndërruar në një pellg gjaku. Skënderi i gjatë i numëroi. Ishin gjashtë këlyshë. Tomit i vinte ndoht t'i shikonte, dhe nuk e ktheu kokën andej. Skënderi ishte i qeshur dhe i gëzuar. Atij nuk i vinte ndoht dhe nuk i kishte bërë përshtypje ulërima e ulkonjës. I mbloodhi shtazët e copëtuara dhe i futi në kasetë.

Vetëm tani Skënderi u nis për te tymi, që kishte filluar të hollohej. Ishte i kënaqur nga gjahu që kishte zënë, i qeshi buza dhe tha me vete:

— Gjashtë, domethënë tetëmbëdhjetë mijë lekë i kam në xhep.

Arrijtën te vendi ku ishte ndezur zjarri për të kërkuar ndihmë. Atje nuk kishte asgjë. Nuk dukeshin as shënjat, se mund të kishte shkuar ndonjë traktor. Tomi hodhi një vështrim të lodhur në kënetë dhe u habit. Në mes të kallamave dalloi trupin e një njeriu. Ai shtangu në vend. Gozhupi i njeriut, që ishte shtrirë, qe mbuluar me gjak.

— Usta, një njeri i plagosur.

Skënderi u habit. Vështroi në drejtimin që i tregoi Tomi dhe dalloi trupin e shtrirë. Njeriu i shtrirë kishte veshje traktoristi. Skënderi, i trembur, u hodh nga traktori dhe e ktheu përmbys njeriun. Mendja ju çakërdis, dhe duart ju drodhën nga emocioni. Nuk po e dallonte ende se kush ishte. Filloi t'i pastrojë fytyrën nga torfa që

e kishte nxirë dhe shtangu në vend! Ishte Sofokliu. E shkundi nga supet.

— Sofokli! O Sofokli! Po hapi sytë, ore... Nuk më njeh? Jam Skënderi... Skënderi i gjatë... Hapi ore sytë!..

Sofokliut i kishte rënë të fikët ngaqë i kishte shkuar gjak, dhe nuk vinte në vete. Ata të dy e shkundën mirë e mirë. Sofokliu mundi t'i çilte më në fund sytë. I vështroi të dy shokët dhe i qeshi fytyra. Kishte qenë i bindur që do të vinin dhe ja, më në fund e pa që s'kishte gabuar. Zgjati krahët, duke dashur të kapet pas duarve të tyre, që të mos ndahej më kurrë, po përsëri i ra të fikët. Skënderi i gjatë bërtiti me sa fuqi që kishte, po ai nuk u përmend. Atëherë Skënderi nuk priti më. E ngritën të dy me Tomin dhe e vendosën me kujdes në sedile. Pastaj u nisën duke ja shkelur deri në fund. Traktori çante me vrull ujin që kishte mbuluar rrugën.

* * *

Traktori i Skëndërit të gjatë na arriti në të hyrë të sektorit. Rreth grupit tonë u mbloodhën dhe fshatarë të fermës. Ata vështronin gjithë urrejtje diversantët e kapur dhe shtrëngonin dhëmbët nga zemërimi. Traktori, që ishte bërë gjithë baltë dhe ngjante si një vidër e madhe, nuk u ndal po eci me rrëmbim përpara. Fshatarët e kishin parë Sofokliun e shtrirë dhe gjithë vëmendjen e kishin përqëndruar atje. Njëri prej tyre pyeti shokun:

— I vrarë ishte?

Tjetri ngriti supet, nuk bëri zë. Nuk dinte se ç'të thoshte.

U shkul e gjithë ferma. Gratë lanë punën, dhe fëmijët, të heshtur, u rrjeshtuan në dy anët e rrugës. Ne të inatosur largonim njerëzit dhe rregullonim në supe armët e zëna. Erdhi një kamion nga të ndjekjes me ushtarë. Një oficer i thinjur na puthi të gjithë, kurse diversantët i vështroi vëngër.

Afër mbrëmjes zbriti tek ne edhe drejtori. Ai u tregua i dashur me ne, na hodhi duart në qafë. U mallëngjyem

nga gjithë kjo dashuri dhe nuk na zinte vendi. Po midis nesh ndjehej një shqetësim i madh për Sofokliun.

Me këtë rast, në fermë kishte ardhur dhe një grup artistik nga qyteti. Na ftuan në shfaqje. Salla ishte e ftohtë dhe e shtruar me çimento. Vasili rrinte pranë meje, sepse këndej dukej më qartë vajza që shiste bukë. Ajo kishte ardhur në shfaqje me një fund të ri e një bluzë të kuqe. Vasilit i ndritnin sytë dhe ishte i gëzuar që edhe vajza e dashur kishte ardhur atje.

10

Në mbrëmje të gjithë i hoqëm këpucët në korridor. Veraqi për pak e harroi rregulloren që kishim vendosur për këpucët dhe do të ishte ndëshkuar të fshinte dhomën. Por e mblodhi veten dhe i hoqi këpucët në vendin e caktuar. Zjarri ishte ndezur në vatër dhe brenda në dhomë ishte ngrohët e pastër. U ulëm të gjithë nëpër minderet dhe ndezëm cingaret. Ajo ishte një natë jo si të tjerat. Të gjithë ndjenim një gëzim në shpirt, por mendjen e kishim te Sofokliu. Si do të ishte vallë ai?

Skënderit të shkurtër i vinte inat me veten, që e kishte humbur toruan mbas parcelës së vet dhe nuk kishte mundur të përleshej dhe ai me diversantët. Ai i kishte marrë vesh lajmet i fundit, dhe kjo e tërboi. Por nuk rrinte i zemëruar. Ai mernte pjesë me gjithë shpirt në gëzimin tonë. Vetëm nuk arrinte të kuptonte një gjë: si e kishim zbuluar bandën. Nuk kishte pyetur njeri, që t'ja tregonte.

— Të gjitha i mora vesh, — tha më në fund ai.

Po këto fjalë i dhanë shkas të qeshurës në dhomë. Papritur Skënderi, i skuqur, vazhdoi:

— Qeshni, qeshni, po unë një gjë nuk marr vesh: Si i zbuluat diversantët?

Skënderi i shkurtër kishte të drejtë. Ja tregova unë të gjitha.

Skënderi i gjatë rrinte i menduar dhe thithte herë pas here cingaren në qoshen e minderit afër vatrës. Ishte

i mërzhitur dhe e nxirrte tymin shtëllunga - shtëllunga. Ishte i shqetësuar për fatin e Sofokliut dhe, me mend, falënderonte shoferin, që e kishte marrë në kabinë Sofokliun e plagosur dhe ja kishte shkelur si furtunë. Shpirt njeriu kishte qenë shoferi! Skënderi i gjatë nuk i kishte treguar njeriu për ulkonjën dhe këlyshët që kishte shtypur. I vinte turp ta zinte në gojë atë histori, pas atyre që kishin ngjarë. Turp! Kishte të drejtë të mendonte ashtu Skënderi. Nuk ishte e hijshme të merrej me gjueti, kur shokët e tij përlësheshin me diversantët për jetë ose vdekje.

Skënderi i gjatë ishte i mërzhitur dhe, sa mbaronte një cingare, ndizte tjetrën. Por, kur dëgjoji historinë që i rrëfeva Skënderit të shkurtër, ai më vështroi me habi.

Skënderit të gjatë nuk ja mernte mendja kurrë që gjuetinë e tij e kishin marrë vesh të tjerët. I vinte turp që ishte marrë me kafshën dhe kishte lënë mënjanë njeriun, Sofokliun e plagosur. Ai mallëkonte veten që ishte zotuar kaq herë të ndreqej dhe prapë gabonte. E kishte humbur pusullën. Ishte i vrarë shpirtërisht dhe më s'ju durua:


— Ke të drejtë, ulkonjën me gjithë këlyshët e vrava unë. I shtypa me traktor.

Ne nuk e dinim këtë, dhe fjalët e tij na habitën. Skënderi uli sytë dhe vazhdoi:

— Lëkurët i kam poshtë në kasetën e traktorit. Merrini, se janë tuajat. — Kjo ra si rrufe në kohë të kthjellët. Skënderi i gjatë i tregonte vetë të gjitha ato që kishte bërë, pa ndonjë qëllim.

Më vonë, biseduam shtruar dhe mendjen e kishim te Sofokliu, që e çuan në qytet. Si do të ishte ai? Vallë, a do të kishte mbërritur gjallë? Nuk dinim asgjë për të, dhe kishim të drejtë të merakoseshim e të shqetësoheshim.

Simoja kishte shkuar të interesohej për shëndetin e Sofokliut. Kosta foli përçart atë natë. U çua dhe tha se ishte gati të ngrinte një estradë në brigadë. Kjo na habiti. Si ishte e mundur që dhe ne të kishim estradë. Jam i mendimit se puna e aktorit nuk është aq e lehtë sa duket.



Por Kosta, siç dukej, nuk e kuptonte këtë; i kishte marrë koka erë dhe kërkonte të formonte grup estrade. Po cili do të luante në këtë grup, të cilin kërkonte të formonte Kosta.

Megjithkëtë mendimi i Kostës për të ngritur një grup estrade ishte mjaft interesant. Kështu do të kishim më shumë mundësi të kritikonim të metat tona. Po kush ishte në një mendje me të? Askush. Kështu që ëndrra e Kostës mbeti ëndërr.

Ndoshta me të tilla mendime do të më kishte kapur gjumi atë natë, sikur afër shtratit tim të mos vinte si gjithmonë Vasili.

— Do t'ju japin dekorata? — më pyeti ai.

— Ku ta di unë.

— E din, po nuk tregon, — u tall me mua Vasili. — Dhe e heq veten shok me mua. Pse nuk më tregon të vërtetën? Thuaj që do të na japin dekorata, dhe pikë. Megjithatë, dekorohuni, dekorohuni, unë për veten time e kam zgjedhur punën. Do të martohem, dhe do të dal më i fituar se ju.

Më bëri nevrrik dhe u ngrita në bërryle:

— Flet si fëmijë!

Vasili dërdëllisi dhe disa çaste dhe më ktheu kurizin.

Vonë më kapi gjumi. Në ëndërr pashë nënën. Në mëngjez më dhimbte koka, dhe goja më mbante erë të rëndë.

Skëndëri i gjatë ishte ngritur më herët. Ai kishte rjepur lëkurët e kafshëve dhe i kishte duart me gjak; megjithëse i kishte larë përsëri, nuk i kishte pastruar mirë. Lëkurët i kishte hedhur në korridor dhe më erdhi mua që në mëngjez e më tha:

— Lëkurët jua lashë jashtë.

Nuk kuptova në fillim se ç'punë kisha unë me lëkurët, dhe pse më lajmëronte Skëndëri i gjatë për një gjë të tillë. Më vonë e kuptova dhe i rashë në të. Ishte dita e parë që po ngriheshim pa Sofokliun. Kishim fjetur shumë, dhe kokën e kishim të rëndë. Ishim ngritur vonë,

kolla e tij nuk na kishte bezdisur. Vetëm të ishte gjallë, pa ja falnim dhe kollën dhe gjithë shakatë që bënte me ne.

Simoja nuk kishte zemër dhe, tek vëshrttoi lëkurët e kafshëve, i erdhi për të vjellë. Ai hyri në dhomë dhe zuri hundët me dorë.

Ishte e shtunë dhe dita ishte e bukur. Na u dha lejë të ngjiteshim në qytet. Na kishte marrë malli për qytetin. Kishim njëzet ditë që nuk kishim shkuar atje. Në mëngjez kishte rënë brymë. Ajo i kishe veshur gjethet e verdha me një cipë si argjend. U bëmë gati dhe u nisëm më këmbë për të dalë në rrugë. Brigadieri ecte i pari. Mbas tij kishim lënë Vasilin, që e ndiqte kokulur. Brigadieri e çante rrugën gjithë qejf, dhe sikur krenohej që në brigadën e tij kishte djem të tillë çapkëna, trima dhe punëtorë.

Kur mbërritëm në rrugën ku kalonin maqinat, kishim dërsirë. Një shofer çapkën e çoi maqinën te një gropë plot me ujë dhe na bëri për faqe të zezë. Të gjithë e mallëkuam dhe e shamë shoferin e pasjellshëm. Shoferi i maqinës së dytë, që u ndal, ishte alamet burri. Ai na mori pa bërë shumë fjalë.

11

Gjithë natën dëgjova bubullima. Shkrepëtimat më lodhën sytë, dhe gjumi më zuri vonë. Shiu kishte vazhduar gjithë natën; kjo ishte dhe arësyeja që e kisha bërë gjumin të lehtë, si shqerrë.

U gëdhi. Nga shtrati vështroja dritaren gjithë bulëza shiu, që shkëlqenin si margaritarë. Nga pullazet e shtëpive ngrihej ngadalë mjegulla, si të ishte shndërruar i gjithë qyteti në një lavanderi të madhe. Më dukej sikur muret e shtëpive të qullura shtrydhnin njëri-tjetrin dhe avulli që ngrihej përpjetë dukej si mjegull. Nëna ishte trembur gjithë natën nga bubullimat dhe shkrepëtimat.

Ajo erdhi ngadalë në shtrat dhe u ul aty. Më vëshroi me buzën në gaz dhe më pyeti gjithë mall:

— Andej nga kënetat bie shi?

— Bie.

— Po rrufe?

— Ë-hë, dhe rrufe.

Ajo më dëgjonte në heshtje dhe me frikë. Qesha me frikën e saj dhe e hoqa veten si të isha inatosur. Po nëna ishte e guximshme, e mori veten shumë shpejt. Ajo më tha:

— Po ti, mos u tremb, të pastë nëna! Thonë se keni zënë diversantë.

— E vërtetë është, nuk të kanë gënjyer, nënë.

— Sa ishin?

— Tre.

— Kokën do të hanë të gjithë. Maskarenjtë!

Nënës i ishte bërë qejfi, që kishim kapur diversantë. Ishte fytyrëqeshur dhe i shkëlqenin sytë. U ngrita nga shtrati dhe vështrova nga dritarja. Jashtë vazhdonte të binte shi i imtë, po qielli kishte filluar të hapej.

Nëna kishte bërë mëngjezin gati dhe era e bukës së pjekur në shtëpi më gudulisi hundët. Dhoma mbante erë ilaç, që nëna e kishte hedhur nëpër sëndyqe për të luftuar molën.

U veshja dhe dola jashtë. Rruga ishte larë nga shiu, dhe gurët e kalldrëmit shkëlqenin. Nga ullukët vazhdonte të rridhte uji me rapëllimë në qoshet e rrugës, tek ishin hapur gropat mbuluar me kapak në formë skare.

Nëpër kanalet e ujit dhe sidomos mbi kapakët e gropave ku mblidhej uji, kishte shumë koçanë misri, letra të bëra qeska, kuti cingaresh bosh dhe tek-tuk ndonjë nallëne të prishur të rrëmbyer nga shiu.

Nëna më përcolli deri jashtë dhe më këshiloi të mos i lagja këmbët. E përshëndeta me dorë, dhe ajo qeshi me gjithë zemër. Në kafenenë «Devolli» nuk kishte asnjë prej shokëve. Unë kisha mbërritur i pari. Atje, si gjithmonë, ishte Stilloja. Stilloja ishte brigadier i brigadës së pestë dhe njihej me gisht nga të gjithë traktoristët. Ishte burrë

i qeshur dhe shok i ngushtë me brigadierin tonë dhe me brigadierin e brigadës së tretë, Gurin.

Stilloja, të gjithë traktoristëve u thërriste «nip» dhe traktoristët i thërrisnin atij «Xhaxhi». Kjo ishte bërë si me një marrëveshje të heshtur dhe të dy palët e ndjenin veten të kënaqur, si ne, si Stilloja. U ula në tryezën e tij dhe «Xhaxhi» porositi një konjak dhe një kafe, që erdhën më shpejt nga ç'e prisja. Nuk kisha ndër mend t'i ktheja. Kjo ishte dëshira e Stillos dhe unë pranova. E piva konjakun. Ishte i hidhur dhe më mblodhi buzët.

Kur mbaruam së piri kafënë, Stilloja më propozoi të dilnim një herë pazarit. Nuk ja prisja qejfin. Në treg, poterja dhe zhurma më mërzitën.

Në mes të rrëmujës së pazarit dallova Skënderin e gjatë. Ai ishte ndalur në mes të një grupi, që e kishte rrethuar me përzemërsi. Nuk më pëlqyen ata njerëz, dhe nuk di pse ndjeva neveri për shokët e Skënderit. Po kur pashë që ky u largua nga ai grup njerëzish, m'u bë qejfi shumë.

Në depon e reciprokut kishte mjaft fshatarë. Atje dorëzohej shpejt e shpejt malli dhe fshatarët largoheshin me shumë para në duar. Ata futeshin në dyqanet e shtetit, ku mbushnin torbat me ushqime. Jo vetëm kaq. Dikush nga ata dilte nga dyqani me gramafon, radio a biçikletë. Bile një fshatar kishte blerë dhe një raft për libra.

Skënderi na pa dhe u nis drejt nesh. Por në mes të rrugës ai ndërroi mendje, na përshëndeti dhe kaloi tutje.

Një fshatar, që kujtoi se i kishin vjedhur kuletën, ulëriti me të madhe. Kuletën e kishin gjetur, dhe fshatari ulëriti kot, se nuk ja kishte marrë njeri, po e kishte humbur. Ngjarja kishte bërë bujë dhe rreth vendit ishin mbledhur njerëz. Një plaku i shpëtoi pula nga duart dhe mezi e kapi. Pula i kishte këmbët të gjakosura, sepse ja kishte prerë spangoja me të cilën ja kishin lidhur. Ishte gjallëri në treg dhe zërat e njerëzve përziheshin me blegërimat e dhenve që i kishin nxjerrë për t'i shitur.

Vështrova grupet e atyre që bërtitnin, duke lëvduar mallin e tyre.

Skënderi na doli përsëri para syve. Një shitës ambu-

lant më zgjati deri afër hundës një mollë të veshur me sheqer. Kjo më pengoi të shikoja, dhe Skënderi m'u zhduk nga sytë. Por ai më dilte papandehur parasysht. Më vonë e pashë prapë. Ai ishte së bashku me një burrë të gjatë dhe shpatullmadh. I panjohuri, që ishte me Skënderin, kishte një xhungë të madhe në hundë. Ai i dha Skënderit një tufë me bono reciproku. Skënderi nuk dukej i kënaqur nga sjellja e tjetrit dhe ja ktheu atij bonot gjithë inat. Pastaj u largua prej tij pa i dhënë dorën. Më vonë, Skënderin nuk e pashë më në pazar.

Stilloja më priste më tutje. Kishte frikë se mos kisha humbur. Mezi munda të dal prej andej. Duke ju afruar Stillos, mallëkova veten që kisha shkuar në pazar dhe nuk ja kisha varur lutjes së një djaloshi, që kërkonte të më shiste vezë të freskëta.

Nga ana e majtë e pazarit u duk një grup blerësish, që ecnin në njëshkolonë me biçikleta të hedhura në sup. Trupat e biçikletave ishin të mbështjella me letër dhe timoni e pedalet të vritnin sytë nga shkëlqimi që lëshonin në rrezet e diellit. Stilloja, që siç dukej do të ishte mësur me të tilla gjëra, më tha:

— Tani fillon pazari i vërtetë. Do të shiten biçikletat që janë blerë me reciprok. Po ku djallin është Skënderi?

E kuptova ku e kishte fjalën Stilloja. Ai e dinte shumë mirë punën e Skënderit të gjatë. Jo vetëm kaq, ai e dinte që Skënderi merrej me treg të zi.

Skënderi nuk dukej, dhe po habitësia dhe unë. Mos vallë i kishte thënë lamtumirë një herë e mirë punës së turpshme që bënte? Po të ishte kështu, Skënderi kishte bërë me të vërtetë një kthesë të madhe. Nuk më besohej që Skënderi të largohej kaq lehtë nga zanati i tij. Ai do të kishte rënë në ndonjë pazar më me leverdi se sa shitja e biçikletave. Sidoqoftë atë nuk po na e zinte syri, dhe kjo nuk ishte pak.

Fshatarët kishin filluar të shtyheshin për të blerë peshk, na morën edhe ne përpara.

Në klub ishin mbledhur të gjithë shokët. Simos i qeshi fytyra, kur më pa të hyja në klub së bashku me Stillon. Veraqi kishte pirë një dopio konjak dhe kishte

filluar të pështynte sipas zakonit të tij. Stilloja u puth buzë më buzë me Simon dhe u ul në krye të tryezës. Në të tilla raste atje e kishte Stilloja vendin e tij. Ai kishte muhabet të ngadalshëm, të lezetshëm dhe një sjellje fisnike në tryezë.

Më vonë, në klub hyri edhe Skënderi. Kjo na habiti të gjithë. Nuk e pritnim të vinte, se ishim të sigurtë që ai nuk do ta braktiste pazarin për vizitën që do t'i bënim në spital Sofokliut. Por ishim gabuar. Skënderi kishte ardhur. Ai ju afrua Simos dhe diç i pëshpëriti në vesh. Pastaj Simoja na tha:

— Skënderi i ka shitur lëkurët e ujqve dhe kërkon që të hollat t'i jepen familjes së Sofokliut.

Ngelëm të habitur. Skënderi kishte rendur me lëkurët e përgjakura dhe i kishte shitur ato për familjen e Sofokliut. Nuk më kishte shkuar në mendje që Skënderi do të merrte një vendim të tillë.

12

Në hyrjen e spitalit, kur kaluam derën e ngushtë thurur me rrjetë teli, ndeshëm në vështrimin e egër dhe aspak miqësor të një infermierje bjonde, që i kishte buzët me të kuq. Tek shikoja shkarazi vështrimin e saj të ftohtë, më dukej sikur kaloja përpara një aparati rontgeni.

Në paradhomën, që ishte në mes të korridorit ku ndodhej dhe mjeku i urgjencës, ne u veshëm me përparëse të bardha dhe ngjanim si një grup mjekësh. Në korridorin e pastër na shpoi hundët era e barnave. Para nesh kaloi një vig me rrota. Në të ishte shtrirë një njeri që nuk e dalluam. E kishin mbuluar me çarçaf të bardhë. Mendova për një çast, se në atë vig mund të kishin shtrirë Sofokliun. Ky mendim më ngriti qimet e kokës përpjetë.

Përballë nesh, në korridor, po vinte duke fërshëllyer lehtë një infermiere e bukur. Ajo kishte një skufe në kokë dhe prej saj i kishte dalë një cullufe e verdhë. Vajza, me të na parë, pushoi së fërshëllyeri dhe uli kokën me turp, si të ishte zënë në faj. Kishte sy të bukur, dhe

prej bluzës së shkurtër i dukeshin kupat e gjunjëve. Vasili ishte para meje. Ai nuk e kishte vënë re fare vajzën dhe ecte duke shtrënguar pakon që kishim sjellë për Sofokliun. Kur ktheva kryet që ta vështroja edhe një herë infermieren, Vasili ishte ndalur dhe unë ja këputa me kokë në shpatull. Ai më hoqi një të sharë të rëndë. Ashtu të hutuar, u futëm në dhomë dhe dolëm me nxitim që andej dhe filluan të na digjnin veshët nga turpi. Kishim hyrë në dhomën e grave. Njëra prej tyre ishte gati duke u zhveshur. Ajo na pa dhe na bërtiti. Mallëkuam Vasilin, që na udhëhiqte.

— Dhe këtu në spital mendjen te femrat e ke, ore tutkun, që na turpërove të gjithë! — e shau me inat Skënderi i shkurtër.

Më në fund, e gjetëm dhomën, ku ishte shtruar Sofokliu. Ajo ishte një sallë e madhe e mbushur me shtretër. Pas nesh, në atë sallë të madhe gjithë shtretër e dritare futën dhe një të sëmurë, që sapo e kishin sjellë nga salla e operacionit. Ishte ai në atë vigun me rrota që kishim takuar në korridor. I sëmuri fliste përçart dhe kërcënonte një njeri të panjohur. Të gjithë të sëmurët ishin ngritur në bërryle në shtretërit e tyre dhe na vështronin me habi. Ndoshta na ngatërronin me ndonjë grup kirurgësh, nga bluzet e bardha që kishim veshur. U ulëm të gjithë rreth shtratit të Sofokliut.

Sofokliu u gëzua shumë kur na pa dhe u bë gati të na hidhej në qafë, po ne e ndalum. Supin e kishte të lidhur me fasha, ku dukej një njollë e kuqe gjaku. Ju bë zemra mal që i kishim vajtur, dhe na tha se nuk kishte mbetur vetëm. E kishte vizituar drejtori dhe shokë të tjerë me përgjegjësi.

Ndenjëm gati një orë me Sofokliun. Pasi biseduam mbarë e prapë dhe u çmallëm me të, më në fund e puthëm, i uruam shërim të shpejtë dhe u larguam.

Jashtë ishte qetësi. Në korridor vraponin dy infermiere të ngjallura me qeskat e oksigjenit në duar. Poshtë, në shkallë, takuam një nënë me flokë të lëshuara dhe me fytyrën dyllë të verdhë. Ajo qante në heshtje dhe i kishte

sytë të skuqur. Nga salla e operacionit doli një doktor me maskë.

— Shpëtoi, — i tha ai nënës me zë të lodhur.

Unë e ndjeva veten të lehtësuar. Ndeza një cingare dhe e thitha fort. Ishte fresk, dhe rrugët e qytetit kishin gjallëri. Çiftet kishin dalë për shëtitje se ishte e dielë.

Skënderi na kujtoi sendet që kishim për të çuar në shtëpinë e Sofokliut dhe vendosëm të ktheheshim andej.

Rruga për te shtëpia e Sofokliut ishte plot me fëmijë çamarokë. Ata luanin gjithë zhurmë me njëri-tjetrin dhe e mbushnin me klithma rrugën.

Një plakë ishte ndalur para grumbullit të druve, që i kishte hedhur mu te parmakët e derës. Ajo na vështrroi me kujdes dhe na pyeti:

— Mos çani dru?

Bëra përpara duke qeshur e duke tundur kokën në shënjë mohimi. Nga qoshja e rrugës u ndie thirrja e fuqishme.

— Dru me pre!

Plaka nxittoi duke trokitur nallënet dhe i doli malësorit përpara...

Rruga ishte prishur në mes, një grup punëtorësh po rregullonin kalldrëmin. Një grup tjetër punëtorësh po pushonin mbi kopicën e zhurit. Njëri prej tyre u shkëput nga kapica dhe na kërkoi zjarr. Veraqi i dha shkrepshen dhe priti sa ta ndizte. Simoja pyeti një plak me llullë, se ku e kishte shtëpinë Sofokliu dhe ai ja tregoi. Ishte një shtëpi e lartë me një oborr të madh. Në mes të oborrit ishte një mën i madh dhe një tullumb. Ploçat e oborrit ishin shkatërruar. Një grua, me flokët e lidhura me më-sallë, po lante një fëmijë në govatë. Fëmija qante se i digjnin sytë nga sapuni. Një grua tjetër, më e kaluar nga moshë, kishte ndezur zjarrin në mes të oborrit, te ploçat e thyera. Mbi flakë ajo kishte vënë një tigan të madh dhe po fërgonte peshq. Era e vajit të djegur ishte përhapur në gjithë mëhallën.

Papritur, në oborr doli e shoqja e Sofokliut, e zbetë dhe e shqetësuar. Na doli me turp përpara dhe na ftoi të hynin brenda. Dhoma ishte e thjeshtë dhe e mbajtur pastër. Nga oborri nuk formuam ndonjë përshtypje të

mirë dhe nuk prisnim të gjenim atë rregull që gjetëm në dhomën ku u ulëm. E shoqja e Sofokliut ishte amvisë e mirë. Na dha raki dhe na kërkoi të falur që nuk ja kishim gjetur në rregull shtëpinë. Kur mori vesh që ishim të gjithë shokët e Sofokliut, mori një pamje të mallëngjyer.

Skënderi i dha të hollat pa ceremoni. Ajo, në fillim, ngurroi t'i merrte, po i foli brigadierit që e njihnte dhe më parë dhe ajo i mori. U habit nga gjithë ato të holla që i dhamë. I futi nën mësallë dhe na falënderoi. U ndamë jashtë në oborr. Na përqafoi të gjithë, si të na kishte vëllezër.

Prigëz ecnim në grup dhe të menduar. Na punonte mendja tek Sofokliu, që ishte shtruar në spital. Interesant me të, nuk kishte njeri të afërm në qytet dhe, megjithatë, nuk mërzhitej dhe as i rëndonte vetmia.

Vjeshta kishte kohë që na kishte lënë shëndetin, dhe nga malet frynte një erë e ftohtë.


Kur dolëm në rrugën kryesore, Tomi na ftoi për një vizitë në shtëpinë e tij. Skënderi i gjatë dhe unë e pranuan ftesën e Tomit dhe shkuam me të në shtëpi. Shtëpia e Tomit ishte afër. Ishte një shtëpi e vogël, e pastër dhe e thjeshtë. Na futi në dhomën e pritjes. U ulëm. Nëna e Tomit, teta Anastasia, siç kishim filluar ta thërrisnim ne, na u lut të kujdeseshim për Tomin, se e kishte djalë të vetëm dhe të rritur me kimet. Ajo na tha se Tomi ishte i dobët nga shëndeti dhe na u lut të mos e vinim në punë të rënda. Na gostiti me raki dhe sheqerka. Na u lutën të rrinim për drekë, po nuk ndenjem.

13

Me siguri që traktorët do ta kishin ndjerë të ftohtit pas tri ditësh që i kishim lënë vetëm.

Kosta, duke vërshëlyer, hipi mbi zinxhir, pastaj mbi kofonot e motorit dhe hoqi copën e qiramidhes, që kishim vënë majë skapamentos për të mos hyrë ujët.

Ishte thëllim, dhe era nuk ndjehej fare. Koha ishte



e vrënjtur, qielli kishte marrë ngjyrën e hirit. Drejt malit të lartë mbuluar nga mjegulla shkante një tufë patash të egra. Ndoshta patat, ngaqë nuk e dallonin më kënetën e tyre të vjetër, nuk gjenin vend për t'u ulur.

Kolla e fortë e Sofokliut nuk ndjehej, dhe mua më dukej sikur e gjithë brigada kishte rënë në vetmi. Vasili ishte nisur për nga furra dhe akoma s'dukej të vinte. Ai erdhi vonë. Copën e bukës e kishte vënë nën sjetull dhe dukej i zemëruar. Pasi më vështroi gjatë në sy, psherëtiu thellë. Lëvizta kokën për ta ngushëlluar dhe vazhdova të hedh çiketo me benzinë në kolektor. Benzina më kishte qullur mëngët e këmishës dhe më kishte marrë llërët. Ndjeja të ftohët dhe m'u ngritën qimet përpjetë. Kosta qeshi kur më pa që po mërdhijja, dhe unë nga inati e flaka tutje kanaçen. Ai zbriti nga motori dhe shkoi e mori kanaçen pa fjalë. Pastaj zgjidhi manovelën dhe u bë gati të ndizte traktorin.

Manovelën e lidhnim me një rrip të prishur prej ventilatori. Vaji kishte ngrirë dhe ishte trashur. Motori kishte vendosur të na lodhte dhe të na e nxirrte nga hundët të gjithë qejfin që kishim bërë në qytet. Kosta kishte dërsirë dhe hoqi me të shpejtë xhakëtën. Sumbullat e djersës ja kishin mbuluar ballin.

Kur u lodh Kosta, e kapa vetë manovelën. Ishte e rëndë si plumb. I dhashë të drejtë Kostës. Më kapi inati dhe e rrotullova me sa fuqi që kisha. Megjithatë, motori nuk u ndez. Vetëm Veraqi e kishte ndezur traktorin e tij. Ua kishte marrë dorën manjetave, dhe traktori i ndizej si çakmak. Me ta ndezur, Veraqi filloi të bënte fresk. Kjo sjellje nuk durohej dhe na tërboi të gjithë. Po ai atë ditë kishte vendosur të na ndihmonte dhe jo të tallej. Si hapi kapakun e manjetës së traktorit, qeshi. Pastaj, diç trazoï atje dhe, pa bërë ende një çerek rrotullimi manovela, traktori u ndez. Atij i qeshi fytyra dhe tha me mburrje.

— Ja kush është usta!

Sesi më acaroi kjo lëvdatë prej mendjemadhi. Megjithatë ishte usta, s'kishe ç'i thoje dhe manjetave ua kishte marrë aq mirë dorën, sa na linte të gjithë në bisht.

Më zuri ngushtë. Ngrita supet dhe nuk i fola. S'kisha ç'ti thoja, ishte usta dhe pikë.

Skënderi i gjatë, që e kishte hequr nga manovela Tomin, pasi kujtonte se ai e kishte fajin që nuk i jepte aq mirë manovelës, ishte bërë pellg në djersë dhe nuk po e ndizte dot traktorin. Nuk kaluan as tre minuta dhe Veraqi e rregulloi edhe traktorin e Skënderit. E ndezi më shpejt se ç'e mendonim.

Skënderi i shkurtër, që ishte nxehur e i qenë bërë faqet flakë të kuqe, ju lut Veraqit që t'ja ndizte pak traktorin. Veraqi e vështroi një herë dhe ja plotësoi dëshirën edhe Skënderit të shkurtër. Kur u ndez traktori, Veraqi i hoqi një vërejtje Skënderit, që e zëmëroi shumë.

— Kështu është, Keno, kur shtrydh çibanët, s'të mbetet më fuqi dhe nuk je i zoti ta ndezësh traktorin.

Skënderi, në fillim, e dëgjoi në heshtje dhe thujse me buzëqeshje vërejtjen që i bëri shoku, sepse nuk e kishte kuptuar djallëzinë, por pastaj, kur e mori vesh se ku rrihte Veraqi me ato fjalë, u ndez dhe ja mblodhi keq atij. Më vonë erdhi në punë i heshtur si një maçok, Faiku. Në sup kishte hedhur një torbë dhe ishte i lodhur. Çizmet i kishte gjithë baltë; kishte ecur përmes kënetës.

Skënderi i gjatë nuk dinte si ta falënderonte Veraqin, që i kishte ndezur traktorin dhe mori vrull që ta puthte atë, por u ndal me të takuar rrugës Faikun.

I lamë traktorët ndezur dhe u futëm në dhomë. Aty qe ndezur zjarri dhe ishte ngrohët. Ngrohtësia na pëlqeu, dhe vendosëm të shlodheshim një copë herë, sa të na thaheshin djersët në trup. Por në dhomë ishte shumë ngrohët, dhe në vend që të na tereshin djersët, dërsimë më shumë. Dolëm jashtë, por brigadieri na futi brenda, nuk na lejoi të hanim bukë jashtë dhe të gjithë ju bindëm urdhërit të tij. Ushqime për mëngjez kishim boll. Parcela tek do të shkonim të punonim atë ditë ishte një parcelë e dobët, dhe brigadieri ishte i shqetësuar. Kishte vendosur të vinte me ne dhe po përtypej ngadalë, i zhytur në mendime.

Simoja kishte vendosur që në këtë parcelë të dobët e të lagtë të punonte e gjithë brigada, që, sido që të

ndodhte puna, të ishim të gjithë së bashku. Nuk e kishte menduar keq dhe të gjithë ja pëlqyem këtë plan.

U nisëm varg njëri pas tjetrit. Rruga ishte gjithë ujë dhe nga zinxhirët e traktorit filluan të hapen dallgët. Me vete kishim marrë dhe plugjet, që bënë gjithë atë potere. Nuk e dinim se çfarë na priste. Hymë në parcelë si pa të keq. Parcela ishte e gjatë, pa fund. Prej saj u ngritën të trembura një tufë mëllenjash, duke rrahur fort krahët. Isha ndalur në rrugë. Traktori punonte në mimo dhe më dhimbte koka. Vështroja Skënderin e gjatë, që kishte hyrë në parcelë dhe pas i shkonte Veraqi. Në parcelë u fut më vonë edhe Vasili. Në traktorin e Skënderit të shkurtër kishte hipur dhe Simoja. U nisa pak më vonë se ata dhe u futa në parcelë. Nuk kishim filluar ende të lëronim, kur ashtu, fare papritur, si të ishte fundosur toka, traktori i Skënderit të shkurtër nisi të zhytej në torfë. Skënderi u hodh me të shpejtë prej traktorit. Nuk mendoj për gjë tjetër, po veç të stakonte plugun dhe të largohej prej parcelës sa më parë. Mirëpo s'pati kohë, mundimi i shkoi kot, se traktori u fundos, si një anije e goditur me silur në mes të oqeanit.

Simoja, që kishte zbritur me kohë nga traktori i Skënderit të shkurtër dhe po rrinte në mes të parcelës, u zverdh nga habia e inati dhe na dha urdhër të prerë:

— Të gjithë traktorët të dalin nga parcela ! . .

Brigadieri kishte klithur fort. Veraqi filloi të qeshte me fatkeqësinë e Skënderit të shkurtër. Ai kishte menduar në fillim, se Skënderi i shkurtër ankohej kot dhe se ishte trembur që traktori kishte shkarë pak nga e majta. Megjithëqë Veraqi ishte treguar më i shpejtë se Skënderi në stakimin e plugut, as ai nuk mundi të shpëtonte.

Kur u kthye që të hipte në traktor, vuri re me pikëllim se traktori ishte i fundosur në dheun e zi. Atëherë të gjithë e morëm vesh, se kishim rënë në grackën që na kishte ngritur kënetat.

Brigadieri u inatos dhe na bëri shënjë të dilnim nga kënetat, po ishte tepër vonë. Ne mundëm të stakojmë plugjet dhe të bëjmë disa hapa përpara, por më tutje ishte e pamundur. Kënetat ishte zemëruar me ne dhe kishte ven-

dosur të hakmerrej. Veraqi, që më kishte sharë në fillim, tani ishte tulatur dhe nuk e ngrinte kokën. Kur vetë ai u fundos me gjithë traktorin në kënetë dhe mua s'mu mbajt të qeshurit, m'u ndërsye me inat:

— Doçi i Anastasisë! Je i zgjuar ti, prandaj më rri në bisht të kolonës. Hyn i fundit në kënetë dhe na shet mendje duke zbardhur dhëmbët!

Kjo ishte një akuzë e padrejtë dhe u nxeha me Veraqin. Vetë brigadieri më kishte urdhëruar të rrija në fund. Megjithëqë kisha të drejtë, nuk e prisha gjakun dhe nuk u grinda me atë. Vendosa të bëhem djalë i urtë dhe të mos u jap shkak shokëve që ta ngrenë çështjen deri në mbledhjen e brigadës. Në raste të tilla është marrëzi të kërkosh sjellje të matur. Pastaj, Veraqi i ishte qepur Skënderit të shkurtër, që kishte lëshuar kujën.

— Mjaft ulërite «xhuxh»! Kush ka vdekur që thërret kështu? Mblidh mendjen dhe mos bëj si frikakakët! U fundosën traktorët, le të fundosen, përse jemi ne, për t'i nxjerrë. Atëherë, pse ulërin?

Skënderi heshti një çast dhe Veraqi, që kishte mbaruar së foluri filloi të pështynte me atë mënyrën e tij.

Pastaj, Skënderi ja priti:

— Si lum ti, Veraq! Vetëm kokën tënde ke ti, pse të mos tërbohesh. Po unë kam fëmijë.

Skënderi, kur kujtonte fëmijët, bëhej qesharak. Përse ja kujtonte ai fëmijët Veraqit? Ai e dinte shumë mirë që Skënderi kishte fëmijë.

Brigadieri shkoi te Vasili, që po grindej me Skënderin e shkurtër, i cili ishte bërë si i tërbuar.

— Pushoni! Po bëheni tamam si fëmijët! dhe na thirri të gjithë të mblidheshim atje. U mblodhëm në heshtje dhe kokulur. Ishim të gjithë të vrrarë në shpirt dhe nuk dinim se çfarë të bënim. Simoja nuk dinte nga të fillonte.

— Më keni inat, ë? — na pyeti ai.

— Jo!.. Pse të të kemi inat? Ti nuk na ke faj, të gjitha fajet i ka toka...

— Jo toka, edhe unë kam faj. U futëm që të gjithë, dhe kjo për fajin tim. Toka është e butë dhe traktorët i kanë zinxhirët të hollë. Megjithëqë e dija që do të fun-

dosnin, dhashë urdhër që të gjithë të ishim këtu. Mendoja që të mirën dhe të keqen ta kalonim së bashku.

— Shumë mirë dhe drejt ke menduar, shoku brigadier.

— Po ju jeni zemëruar?

— Nuk është e vërtetë.

14

Ecnim në heshtje. Ishte natë dhe errësira nuk na linte të vështronim rrugën, që humbiste hendeqeve. Në kënetë kishte mjegull, dhe më dukej sikur ecja nëpër një perde tyli, që çahëj nga trupi i ftohtë. Nuk flisnim. Ajo rrugë na kishte bërë memecë. Ecnim në heshtje dhe të zhytur në mendime. Ishim gjithë inat dhe nuk na bënte zemra për asgjë. Nata ishte e ftohtë dhe kishim bërë shumë mirë që ua kishim hequr ujët radiatorëve. Na vinte keq për traktorët dhe mendonim se si do të gëdhinin atë natë të ftohtë vetëm në mes të kënetës.

Skënderi i shkurtër tha duke psherëtirë:

— Më duket sikur kam lënë fëmijën në mes të kënetës!

Kjo ishte e vërtetë. Të gjithëve na vinte shumë keq për traktorët. Simoja ecte i pari kokulur dhe nuk ndihej.

Kur shquam dritat e fermës në thellësi të errësirës së pafundme si koka shkrepesh të skuqura, Tomi dhe Kosta u ndanë nga ne. Nuk i vura rëndësi largimit të tyre.

Kishim ende rrugë për të bërë, dhe ndjeja lodhje në gjithë gjymtyrët. Më kishin kapur ethet dhe kisha qejf ta ndizja një herë. Po cingare nuk kisha dhe e hoqa mendjen nga duhani. Megjithëqë rruga ishte e drejtë dhe në tokë të butë, ajo të lodhte dhe të raskapiste. Këmba të fundosej. Nuk duhej të ndaheshim nga njëri-tjetri, sepse nuk ishte ndonjë punë e vështirë të humbisje në mes të kënetës dhe të gëdhiheshe natën jashtë.

Veraqi, duke ecur, e kishte futur këmbën në një grapë me ujë. U ndie e shara e tij e rëndë dhe mallëkimi që i dha gropës.

Të lodhur dhe të mërzitur, mendjen e kishim gjithmonë te traktorët që kishim lënë jashtë. Do ta kishim shumë të vështirë për t'i nxjerrë. Megjithëqë faji nuk ishte i joni, na vinte inat me veten, që ishim treguar të ngathët dhe të pazotë për të dalë nga parcela, kur na lajmëroi brigadieri. Psherëtiva thellë dhe ajri më doli me forcë nga mushkëritë e ftohura.

Po Faiku ku qe zhdukur! Na vinte inat me të. Ku djallin të ishte fshehur! Po ta kishim përpara, me tërë atë inat që na kishte kapur, nuk do të ndaheshim mirë me atë. Nuk qe hera e parë që na linte të gjithë dhe i bënte bisht punës në parcelat e vështira. Si na zhdukej ashtu nga sytë! Mu sikur të ishte mace, ikte pa zhurmë me gjithë traktorin dhe punonte vetëm në një parcelë të shëndoshë. Nuk ndihej dhe hiqej si budalla. Por, po ta pickoje duke e kritikuar në ndonjë mbledhje, bëhej si tigër dhe nuk të linte pa të kujtuar gabimet që mund të kishe bërë kushedi prej sa vjetësh, vetëm e vetëm pse kishe guxuar të kritikojë të pakritikueshmin Faik. Kryesorja për atë ishte të të zinte gojën, që të mos kishe mundësi ta kritikojë në të ardhmen. Ishte dinak si dhelpra dhe dinte ta ruante veten e tij nga punët e rënda. Por këtë radhë e kishte mbushur kupën dhe e kishte shumë të vështirë që të na e hidhte. Ne hiqim të zit e ullirit, dhe ai bënte qejf në atë parcelën e tij të fortë. Në mëngjez qe midis nesh dhe pastaj, pa pritur e pa kujtuar, ishte zhdukur me gjithë traktorin, si të ishte fundosur në kënetë.

Përpara meje ishte një gropë. Për këtë më lajmëroi Skënderi i gjatë, që kishte kaluar më parë andej. Më dimet, që më kishin kapur për Faikun, m'u zhdukën, dhe të gjithë vëmendjen e përqëndrova te gropa që kisha përpara. Skënderi kishte ndaluar para saj dhe po matej të merrte forcë që ta kalonte. Teksa ai po merrte hov që të kapërcente gropën, matanë saj kishte qëndruar Veraqi, që i kishte zgjatur dorën për ta kapur. Megjithëqë mori vullkur u hodh, Skënderi mbeti në mes të gropës me ujë. Stërkalat e ujit, që u ngritën përpjetë gjithë forcë, na ndohtën fytyrën dhe rrobot. Matanë gropës u ndie e shara

e Veraqit. Skënderi mjaulliti si mace dhe e kaloi gropën më këmbë, duke e çarë ujët tej e tej.

Mbërritëm në sektor të lodhur dhe të dërsirë. Në vatrën e dhomës sonë ishte ndezur zjarri dhe kjo na kënaqi shumë. Krevatet ishin fshirë dhe shkundur për bukur, ndërsa kova ishte mbushur me ujë. Na dukej se dikush kishte hyrë në dhomë si në përrallat dhe kishte bërë gjithë ato punë. Ç'ishte vallë kjo mrekulli? Më vonë e kuptova, se të gjitha këto punë i kishin bërë Tomi së bashku me Kostën.

Hoqëm çizmet në korridor dhe lamë duart të gjithë me radhë. Dhoma ishte e ngrohtë. Zura vend afër vatrës dhe mendja më shkoi tek helmata italiane, që e përdornim si legen. Ku djallin do ta kishte gjetur Kosta atë rëngallë?

Drutë në vatër digjeshin dhe kërcitnin aq shumë, si të fjaloseshin me njëra-tjetrën. Më dhimbnin shpatullat dhe majën e këmbës së majtë nuk e ndjeja. Çizmet më futnin ujë. Çorapet e grisura më ishin lagur; kur u thanë majaç e tyre, balta u forcua e u bë si qerpiç. Në vatër nuk rrihej më. Të nxehtit u bë i padurueshëm, dhe u largova me të shpejtë prej andej. Vasili, që ishte mbropa meje, më zuri vendin me të shpejtë.

Nga jashtë u ndie sherri që kishte filluar në një shtëpi karshi nesh. Gruaja protestonte, ndërsa zëri i burrit ngrihej deri në qiell. Mbas pak, çdo gjë ra në qetësi, u ndie vetëm e lehura e një qeni që kishte mbetur jashtë, pastaj një e qarë prej fëmije dhe më vonë asgjë.

Në dhomë nuk ndihej asgjë. Asnjë fjalë. Vetëm zjarri që kërciste në vatër dëgjohej dhe kjo na mërziu të gjithë.

— Hapeni gojën, djalli ta hajë, ç'rrijmë kështu, sikur jemi në varr!

Vështruam ngultas Skënderin e gjatë, që i kishte hedhur këto fjalë, por e pamë që Skënderi i lëshoi pa qëllim të keq dhe ne e lamë me aq. Ai deri diku kishte të drejtë. E kishim lëshuar si shumë veten dhe kishim rënë në mendime të thella.

Veraqi, duke u përpjekur të dridhte një cingare du-

han, e kishte derdhur tërë duhanin jashtë letrës, mbi gjunjë.

— Më duket sikur jam në dhomën e provimit, — tha duke psherëtirë Tomi, si të kishte një mall të vjetër për shkollën që kishte lënë.

Vështrova fytyrën e tij të verdhë dhe të lodhur. Më erdhi keq për Tomin. M'u duk një herë se do të kishte bërë mirë sikur të mos merrej me traktorët, dhe të vazhdonte mësimet e larta, mirëpo kisha menduar gabim. Tomi e kishte në gjak punën, dhe kishte bërë shumë mirë që kishte ardhur tek ne.

Vasili, si gjithnjë, m'ua afrua pranë.

— Ç'farë ke, Vasil? — e pyeta.

— Dëgjo! Më trego si shkruhen letrat e dashurisë! — më tha.

— Paskë lojtur mendsh?

— Shët!.. mos thirr. Vetëm ty po të hapem. Më trego se si shkruhen letrat dhe kam për të të dhënë një birrë me gjithë meze. Por jo këtu, kur të shkojmë në qytet.

Më zuri ngushtë. Nuk ishte puna se do të pija një birrë e do të haja një meze, isha gati ta goditja Vasilin me dyfishin e tyre, po vetëm të mos më kërkonte t'i shkruaja atë letër. Nuk kisha shkruar kurrë letra dashurie, dhe kisha një urrejtje të thellë për ata njerëz, që merreshin me të tilla gjëra të kota. Ku ta dija unë se çfarë fjalësh duheshin renditur në të, si duheshin shkruar... M'u kujtua Tomi. Përse të mos e dërgoja Vasilin tek ai. Fundja, ai ishte me shkollë dhe, në gjimnaz, pa tjetër do të kishte shkruar ndonjë letër dashurie.

— Thuaj Tomit! Po të qëndisi një letër dashurie ai, ajo shitësja jote do të priset nga mendtë kur ta lexojë.

— Nuk e dua prej atij, — më kundërshtoi me kokëfortësi Vasili.

Më gjeti belaja me atë djallo letër që kërkonte Vasili nga unë.

— Mirë. Do ta shkruaj, — i dhashë fjalën sa për ta hequr qafe.

Emrin tim mos ja vërë në fund, — m'u lut Vasili.

- Pse mos ja vë?
- Se më vjen turp.

U habita me trillet e Vasilit. Edhe kërkonte letër, edhe i vinte turp të shënonte emrin e tij në fund!

- Mirë. Ashtu qoftë. E lëmë pa emër.

Nuk e dija nëse Vasili do të ishte i zoti ta dallonte stilin e Tomit. Më mirë të mos e kuptonte, se do të shpëtoja nga halli që më kishte zënë. Mendimet m'i prishi zëri i ashpër i Skënderit të gjatë, që qortonte vetëveten.

— Të gjitha fajet, që u fundosën traktorët, i kam vetë. Vetëm unë jam fajtori, shokë. Kam sharë gruan, kur u nisëm nga qyteti dhe me siguri që na kanë zënë mallëkimet e saj.

- Ama fjalë na the, Skënder!

— Skënderit i ka hyrë frika në palcë nga zoti, — u tall me romuze Vasili.

Skënderi u zu ngushtë dhe zgurdulloi sytë. Pse e kishte hapur atë historinë e gruas? Tani hajt e dëgjo këtë këngë nga të gjithë shokët e brigadës!

— Skënderin, shokë, duhet ta shkundim mirë nga mendimet prapanike që ka. Ai vazhdon të besojë zotin, — dha kushtrimin e betejës Veraqi. Megjithatë, Skënderi e pa të udhës të ndërhynte dhe një herë në bisedë dhe të sqaronte që e kishte me shaka gjithë atë histori që kishte treguar.

— Megjithatë, gruaja të shkon në kishë, — e kishte shpuar Vasili.

— Shkon, pse t'ju gënjej, por të gjitha fajet nuk i ka gruaja. Ja ka prishur mendjen e jëma. Është një ajo, që i ka shoqet e rralla.

- Kush kështu?

- Vjehrra!

- Jo, more! — u habita unë.

— Posi! — vazhdoi të fliste Skënderi. — Më shkatërroi së bleri qirinj. Nuk është puna tek të hollat, në të s'ëmës të shkojë kisha dhe të hollat që mbledh ajo, por më shkatërroi fëmijët. Lëre po kush i shikon në kishë, kujton se i dërgoj unë. Ptuuu!

- Mos pështyni në tokë! — e kujtoi Tomi.

— Qenka fanatike vjehrra jote, Skënder? — pyeta unë.

— Shtrigë me brirë thuaj, jo fanatike. Ja ka bërë kokën dhallë gruas. Më vjen turp, kur e shikon gjithë mëhalla gruan time që shkon në kishë me sepetkën në duar.

— Do të keni prift të bukur në kishën tuaj, Skëndo! — i thashë unë duke qeshur.

— Po të ishte prifti i kishës sonë i bukur, jot ëmë do të vinte shpeshherë andej nga ne, dhe do ta kisha njuhur se çfarë bukuroshje është, — mori hak Skënderi, që ishte nxehur. Megjithëqë ma kishte paguar mirë, e hoqa veten si të zemëruar nga fjalët që më kishte thënë dhe, duke u ngritur nga vendi, i thashë:

— Ne bëjmë shaka, ndërsa ti i merr që të gjitha fjalët tona me tërë mend.

Skënderi, i pakënaqur, heshti dhe më vështroi me habi.

— Për nder, që të gjithë jemi grindavecë. Zihemi dhe grindemi për gjëra të kota dhe harrojmë që jashtë, në mes të kënetës, kemi lënë traktorët vetëm. Të mendojmë se si do t'i nxjerrim traktorët e jo të merremi me kisha e profka të tilla, të cilave populli ndonjë ditë do t'u japë fshesën.

Veraqi psherëtiu dhe tha:

— Skënderi, shokë, ka të drejtë. Traktorët duhet të dalin, dhe sa më shpejt bile.

Simoja ishte lodhur dhe qe zhytur në mendime. Flaka e zjarrit i ndriçonte fytyrën, dhe balli i dukej si i përflakur.

Faiku, që ishte fshehur në një qoshe të dhomës, ja priti:

— More Skënder, qënke bërë avokat i madh! Patriot je bërë, kursimtar je bërë dhe çfarë nuk je bërë! Vështro, ore ti, se sa është kilja e elbit në tregun e zi, ajo është punë për ty, pa e di unë se sa të ha merakun për traktorët.

Të gjithë ja qepëm vështrimin fytyrës së ndytë të Faikut. Na kishte mërzhitur dhe e meritonte një dajak të mirë, po në dhomë ishte turp dhe e palejueshme të ndodhte një gjë e tillë. Skënderi nga fjalët e tij ishte skuqur

dhe kishte mbyllur gojën. Ai kishte heshtur që të mbli-
dhte mendimet dhe t'i përgjegjej si duhej Faikut.

— Unë nuk jam më shoku i tyre, Faik, dhe këtë mbaje
mend mirë.

Me kaq u mbyll gjithë biseda dhe i vumë pikë sherrit.

— Të gjithë fajin e kanë zinxhirët, — tha Veraqi, që e
lëshoi këtë mendim si pykë.

Nuk e kuptova se ku i rrihte çekani dhe nuk ja vara
torbën.

— Nuk e kanë fajin zinxhirët, jo. Toka, thuaj, Veraq,
— e kundërshtoi Skënderi i shkurtër.

— Nuk i ka fajet toka, zinxhirët e kanë gjithë fajin
dhe pikë. Janë të ngushtë për peshën e traktorit dhe për
tokën që po punojmë. Duhet të jenë më të gjerë.

— Ç'faj kanë zinxhirët? Ashtu i kanë bërë në fabrikë,
dhe ashtu janë, — e kundërshtoi Vasili.

Heshtëm, po mua nuk më pëlqente një heshtje e
tillë. Brigadieri, që kishte heshtur, lëshoi një psherëtimë
dhe, si të kishte zgjidhur ndonjë problem të vështirë,
belbëzoi:

— Veraqi ka të drejtë, fajin e kanë zinxhirët.

Ndoshta dhe brigadieri ishte gabuar. Më vonë, koha
tregoi se të dy ata kishin të drejtë.

Tek isha shtrirë, po më mbylleshin qepallat nga lodh-
ja. Do të më zinte gjumi dhe isha i bindur se atë natë
gjumin do ta kisha të rëndë nga lodhja. Pikërisht atë-
herë kur isha duke u kotur, në dhomë u ndie një zhurmë
e madhe. Të gjithë i luteshin brigadierit, që kishte ven-
dosur të merrte rrugën e qytetit natën:

— Ku shkon kështu, Simo? Është natë, rruga është
e gjatë. Pastaj, tani në dimër egërsirat janë udhëve.

Po Simoja e kishte vendosur, dhe nuk kishte top që
ta ndalte. Duke kopsitur kopsën e madhe të mushamasë,
që kishte veshur, ai na përsëriti dhe një herë:

— Do të shkoj... dhe pikë. Do të porosit shtesa për
zinxhirët. Duhet të marrim dhe një eskavator. E kemi
keq për të nxjerrë traktorët, dhe për këtë duhet të ma-
rrim masa të shpejta.

Më në fund, mezi e kandisëm që të merrte me vete

dhe një shok. Nuk ishte mirë të nisej vetëm në mes të natës. Skënderi i shkurtër kishte filluar të kruante çibanët dhe të na vështonte të gjithë me sy lutës. E morëm vesh se ku e kishte hallin dhe i dhamë leje që të përcillte Simon. Veraqi i përcolli deri tek ura dhe u kthye mbrapsht. Duke mbyllur derën e dhomës, ai shante veten. Nuk i vinte mirë që i kishte lënë të shkonin vetëm ata të dy, dhe ishte bërë gjithë nerva. Pastaj u ul të zhvishte këpucët.

15

U zgjuam herët në mëngjes. Dita nuk kishte rënë ende, po nga jashtë dëgjohej jehona e këngëve të këndezave. Zjarri ishte nderur. Hodha një vështrim te vendi ku flinte Veraqi. Vendi ishte bosh, dhe Veraqi ishte zhdukur. Vasili dukej i mërzitur. Ai hodhi mushamanë krahëve dhe u nis për te furra e bukës duke u kollitur. Tomi, me duart e skuqura, hyri me rrëmbim në dhomë me kovën e mbushur plot me ujë. Më vonë në dhomë erdhi Veraqi. Ai ishte gjithë qejf dhe i qeshte fytyra. Fërshëllente marshë dhe pështynte pa pushim. Kjo nuk na pëlqeu. E ndjenim se diç do të ndodhte në brigadën tonë.

Veraqi ishte djalë i gjallë dhe e kishte përgjegjen në majë të gjuhës. Një herë ja mblodhi drejtorit, dhe çfarë të mbledhuri. Drejtori ishte një burrë i qetë dhe i mirë; ishte gjynah të grindeshe me atë. Veraqi një herë e kishte pyetur:

— Nga ka lindur njeriu, shoku drejtor?

Drejtori, që ishte njeri i padjallëzuar dhe që nuk e kishte nuhatur si duhej qëllimin e Veraqit, ja kishte pritur qetë:

— Nga majmuni, Veraq.

Atëherë kishte ndodhur hataja. Veraqi ishte hequr sikur qe nxehur nga përgjegja e drejtorit, që e kishte pagëzuar atë enkas si majmun. Drejtori ishte vënë në pozitë të vështirë dhe përpiquej ta sqaronte Veraqin. Po Veraqi e luajti lojën deri në fund dhe drejtori, kur e

mori vesh djallëzinë e tij, u prek shumë. Veraqi i kishte shfryrë drejtorit se atë e kishte lindur Lisava dhe jo majmuni. Më vonë mori vesh drejtori që Lisava ishte nëna e Veraqit, një grua aq e shëndoshë, sa nuk kishte dyshe-me që ta mbante. Historinë, se si e kishte pleksur Veraqi me drejtorin, e morën vesh të gjithë.

Nuk e di pse m'u kujtua ajo histori e lashtë, që kishte ndodhur para dy vjetëve me drejtorin e parë që kishim. Drejtori ishte transferuar, dhe Veraqi nuk ishte më i pari. Ai ishte i gëzuar dhe nuk gëzohej kot. Do të kishte rregulluar ndonjë punë dhe kjo e kishte sjellë më qejf. Çfarë pune kishte rregulluar Veraqi, nuk më shkonte në mend.

Ishte ndriçuar mirë dhoma nga drita e agimit, kur hyri brenda Vasili me bukën nën sjetull. Ai kishte veshur mushamanë dhe dukej i gëzuar, siç dukej, do të kishte biseduar me vajzën. Fytyra i qe skuqur nga thëllimi, dhe në bishtat e syve i shkëlqente një sumbull loti. Nuk tregoi kujdes për bukën, që kishte nën sjetull dhe e flaku atë në minder. Pastaj më vështroi mua dhe unë e ula kokën me turp, sepse nuk e kisha mbajtur premtimin që i kisha dhënë për t'i shkruar letrën.

Veraqi kishte kohë që kishte dalë jashtë, pas Kostës dhe, më vonë, të gjithë ndiem zhurmën e një traktori që ishte ndezur para ndërtesës sonë. U habitëm. Kush e kishte atë traktor? Dola me vrap jashtë dhe dallova Veraqin me gjithë Kostën, që kishin hipur mbi kofonot e traktorit të Sofokliut dhe e kishin ndezur. Veraqi po vendoste kofonon dhe, duke zbritur nga motori, e ambalari një herë fort atë. Rrathët e tymit morën lart, dhe Sofokliu vendosi të mbyllte rubinetin e benzinës për të lëshuar gazin.

— Hej, Veraq! Ç'po bën kështu, ta hajë djalli, — e thirra pothuaj me inat.

Veraqi më vështroi duke qeshur dhe, si pështyu një herë ashtu si i pëlqente, m'u afrua dhe më mbërtheu prej xhakete.

— Një të papritur për Simon që shkoi në qytet! — më tha me zë të ulët duke m'i afruar buzët te veshi.

Më vonë, Veraqi më sqaroi gjithë planin që kishte

kurdisur. Ai kishte vendosur të nxirrte të gjithë traktorët e fundosur. Kjo e papritur edhe më gëzoi edhe më futi në mendime të thella. Po sikur të dështonim? Por, gjersa inisiatori ishte Veraqi dhe, meqë ai ishte i bindur në fitoren, mora zemër.

Për te ndërtesa jonë po drejtohej një grup i madh punëtorësh. Të gjithë ishin djem të rinj dhe të shëndoshë. Ata qeshën porsa panë Veraqin. Disa prej tyre kishin trarë mbi supe, i lëshuan ata poshtë dhe u ulën më bisht në parmak, që të pinin duhan. Një grup tjetër kishte hedhur në krahë një shinë të gjatë prej hekuri. Me sa dukej, të gjithë punëtorët ishin armatosur deri në dhëmbë, dhe kjo na kënaqi të gjithë. Fillimi i punës nuk ishte aq i keq sa e kisha menduar. Më vonë, nga ferma na kishte ardhur dhe një traktor me slitë ngarkuar gjithë lëndë dhe kjo na gëzoi pa masë. Këtë punë të vështirë e kishte organizuar si jo më mirë Veraqi, që nuk e kishte shokun për të tilla raste.

Traktori, që na kishte ardhur nga ferma, ishte krejt i ri dhe të vriste sytë. Humori në të tilla raste është i domosdoshëm. Veraqi, si t'i kishte kuptuar mendimet e mia, filloi të tregonte qyfyre. Grupi i punëtorëve ishte gjallëruar dhe kishte filluar lëvizja. Kjo ishte një gjë shumë e mirë dhe Veraqi më vonë e bëri të shkulej së qeshuri të gjithë grupin, që na kishte ardhur në ndihmë. Më vonë, grupi i punëtorëve ja mori këngës. Kënga ishte e fortë dhe këndohej me gjithë shpirt. Vështroja këngëtarin. Ai ishte një djalosh me shtat të gjatë dhe shpatullat i kishte katër pëllëmbë të gjera. Muskujt e qafës i ishin ndehur dhe damarët i ishin fryrë. Kishte zë të hollë e të fuqishëm, që çante ajrin. Të gjithë kishin hipur në slitë. Dallga e ujit na afrohej deri në majat e këpucëve, çizmeve dhe opingave. Një vidër e trembur çau nga një breg dhe u hodh me vrull në ujë. Punëtorët, kur e panë kafshën të trembur, filluan të bërtasin dhe të fërshëllejnë. Pastaj ja filluan përsëri këngës, që tinglloi më e fuqishme. Më vonë slita u ndal dhe ne menduam se kishim mbërritur te parcela. U ngritëm më këmbë dhe e kuptuam që kishim gabuar. Në mes të rrugës ishte ndalur Faiku me

gjithë traktorin e tij. Traktori ishte i ndezur dhe Faiku ishte ulur i qetë në sedile. E vështrova fytyrën e tij me interesim dhe inat. Ai ishte ulur në sedile dhe shikonte si me mospërfillje. Mbrapa traktorit kishte lidhur plungun dhe po drejtohej i qetë për nga parcela e tij, pa e çarë kokën për traktorët tanë zhytur në kënetë. Parcelën e tij e kishte zgjedhur vetë, dhe kjo na kishte bërë si të tërbuar të gjithë. Hiqej si budalla, por për të tilla punë nuk ja dilte njeri.

Veraqi ishte hedhur gjithë inat nga slita dhe nuk kishte çarë kokën që i ishin mbushur çizmet gjithë ujë. Mbrapa slitës ishte ndalur traktori i Sofokliut. Atë e drejtonte vetë Vasili.

Ju afrova Veraqit, që po e vështronte gjithë zemërim Faikun.

— Të kesh turp! — belbëzoi gati duke u dridhur nga zemërimi Veraqi.

Faiku, si të mos e kishte dëgjuar fjalën e shokut, na vështroi në sy me atë buzëqeshjen e tij prej idioti, si të donte të na e hidhte para syve në mes të ditës. Veraqi u tërbua.

— Ty po të them! — ja kujtoi Veraqi atij. Po Faiku kishte vendosur të mos fliste.

— More, shurdho je ti? Të kesh turp! Si nuk të skuqet faqja nga puna që po bën!

Faiku, si të donte të merrte hak, i shkeli syrin Veraqit gjithë djallëzi. Kjo e katranosi gjithë punën. Veraqi s'e mbajti dot veten dhe e përlau për gryke Faikun. Ishte gati ta hidhte në ujët e kanalit, kur Faiku, i verdhë dyllë, përpëltej në duart e tij duke i kërkuar mëshirë. Veraqi e fali dhe në çast u qetësua. Punëtorët e fermës nuk patën kohë ta merrnin vesh shkakun dhe kjo ishte një gjë shumë e mirë. Faiku u ul në sedile dhe, duke fërkuar qafën që i ishte skuqur, ja pat duke na vështruar të dy në sy:

— Kjo është shoqëria? Tani që ju kini nevojë, vini dhe më kërcënoni. Vetë vini dhe fundoseni dhe nuk lini as njerëzit e ndershëm të punojnë të qetë!

Në një rrethanë tjetër kjo do të na kishte bërë me gaz.

— Do të vish me të mirë ti, apo si e ke hallin? Veraqi kishte vendosur të tregohej i rreptë me të.

Faiku na vështroi me ata sy të vegjël, që xixëllonin gjithë urrejtje. Pastaj, si të ishte bërë shqerrë, tha duke u tallur me ne si një prift katolik:

— Do të vij... si nuk do të vij... Ju kam shokë dhe nuk mund t'ju lë në mes të kënetës!..

Ne u bëmë si të tërbuar nga paturpësia e Faikut, po nuk ishte koha për të marrë hak, dhe i lamë hesapet pa larë me të. Kështu që gjithë puna kaloi mirë, pa sherre dhe zhurmë dhe për këtë isha i kënaqur. Megjithëqë shpirti dhe zemra ma kërkonte të ndeshesha një herë e mirë me Faikun, aty nuk ishte koha dhe vendi.

Na u bënë tre traktorë dhe një slitë e ngarkuar me trarë. Isha i bindur për fitoren dhe e vazhduam rrugën me qejf, megjithëse më ishte prishur gjaku nga Faiku.

Veraqi filloi përsëri nga shakatë dhe nga anekdotat dhe të qeshurit, që kishte reshtur, filloi të ndizej përsëri. Duke qeshur e gjithë qejf, arritëm dhe u futëm në parcelën tek ishin traktorët. Traktori u ndal buzë kanalit dhe ne zbritëm me rrëmbim prej tij. Punëtorët filluan të shkar-kojnë me nxitim trarët. Këtë skenë gjallërie e vështronte nga xhami i kabinës traktoristi i fermës, që kishte ardhur për të na ndihmuar. Ai ishte një djalosh i ri, me sy të vegjël dhe kuqo nga flokët. Ishte i heshtur e krenar dhe nuk na e varte, megjithëqë na kishte kolegë. Gjithë këtë mendjemadhësi mund ta kishte nga traktori i ri.

Ju afrova grupit të punëtorëve, pështyva pëllëmbët dhe fillova të shkarkoja trarë. Traktoristi i fermës më shih-te, sjellja e tij nuk më pëlqeu aspak. Një punëtor i gjatë, që kishte hedhur në sup një tra, duke kaluar para Vasilit e vështroi atë me vëmendje dhe me urrejtje. Punëtori i gjatë u largua, kur mori vesh që po e përgjoja. Ai kaloi me gjithë trarin më tutje dhe unë mendova se ai punëtor i gjatë e i fuqishëm do të ishte ndonjë i afërm i asaj vaj-zës që shiste bukë në furrë. Po të ishte kështu, Vasili

do ta kishte keq punën. Djaloshi ishte i fuqishëm si një ari.

Trarët i shtruam njërin pranë tjetrit mbi tokën e butë të kënetës. Këmbët na zhyteshin thellë në torfë. Opingat e punëtorëve ishin lagur e llangosur me baltë. Kur u vendosën të gjithë trarët, mbi ta hipi traktori i Sofokliut. Vasili, që e ngiste atë, i kishte dhënë më përpara dhe ne filluam të hiqnim trarët e fundit, që kishin mbetur prapa zinxhirit të traktorit. Ata ja shtronim traktorit përpara për të shkuar më tej. E gjithë kjo punë kryhej ngadalë dhe ishte shumë e lodhshme. Nga pesha e rëndë e traktorit, trarët zhyteshin thellë në tokën e butë si sfungjer. Ne duhej t'i futnim duart thellë në baltë deri në bërryle, që të zinin trarët e fundosur dhe t'i ngrinim lart për t'i shkular prej andej. Nuk pyetnim për baltën.

Trarët, që në fillim ishin të lehtë, pasi kishin pirë ujë, ishin rënduar e bërë plumb. Mund të rrezikohesh fare lehtë, po ta ngrije vetëm njërin prej tyre. Të shkiste dhjami dhe të këputeshin kryqet.

U hodhëm. Megjithëqë kishim vendosur që punën ta çonim deri në fund, Vasili shfaqti disa herë shënja mërzitje dhe mallëkoi disa herë. Punëtorët dërsinin, po nuk e jepnin veten. Supet e xhaketave të leshta u ishin ndohtur e bërë gjithë baltë. Këmbët u ishin zhytur në torfën e ftohtë të mbuluar nga bryma. Kishim frikë se mos na mërziteshin punëtorët dhe na largoheshin, duke na lënë me gisht në gojë. Po punëtorët e fermës jo vetëm që nuk ikën, por treguan trimëri më shumë se ne.

Kështu, të menduar e të cflitur, metro mbas metroje arritëm deri te vendi ku ishin traktorët tanë të fundosur. Punëtorët e fermës u habitën, kur i panë traktorët në atë gjendje, të zhytur në mes të baltës.

— Bre..! — u habit njëri prej tyre dhe, si të donte të merrte dhe mendimin e shokut të tij, thirri: — O Metkë! Vështro, ore, se si kanë fundosur, Bre!

— Eo! Derrkat e dërrit, si dosa janë shtrirë!.. — Ja priti tjetri më i habitur se shoku i tij.

Nuk pushuam, sepse s'kishim kohë për pushim. Rrëmbyem lopatat dhe filluam të gërmonim kanalim për të

hequr ujët dhe për të gjetur manovelën e zhytur. Punëtorët nuk na lanë të lodheshim edhe në këtë punë. Ata na ndihmuan me lopatat e tyre dhe, mbas pak, çdo gjë do të ishte gati.

I lodhur siç isha, ndeza një cingare dhe e thitha fort, duke vështruar punëtorët që punonin me vrull. Më tutje nga punëtorët, që kishin filluar të nxirrnin avull nga koka e dërsirë, dallova punëtorin e fuqishëm që i kishte hedhur atë vështrimin mizor Vasilit.

Veraqi ishte zhytur deri në gju në baltë dhe ishte ndohtur në fytyrë si të luante teatër. Në të tillë gjendje ishin katandisur edhe Tomi me Kostën. Faiku s'kishte zbritur nga traktori. Prej andej, ai vështronte me neveri Veraqin, që ishte zhytur gati i tëri në kënetë dhe kishte futur dorën në llucë deri në sup për të gjetur manovelën.

Kosta kishte zënë vendin e Veraqit, dhe vendin e Kostës e kishte zënë Tomi. Të dy po i mëshonin fort lopatës. Ndërsa të gjithë ishim në ankth për të gjetur manovelën, Veraqi bërtiti:

— E gjeta!...

16

Kur hoqëm nga balta e kënetës plugun, që ishte mbushur gjithë kalbësira e torfë, e ndjeva veten të kapitur dhe mezi mbahesha më këmbë. Më pushtoi një dëshirë e marrë për t'u çlodhur. Fuqitë më lanë. Mezi merrja frymë dhe më merreshin mëndtë. U ula mbi një plis, po u ngrita sakaq prej tij. E kuptova që i kisha pantallonat të lagura nga mprapa; ndjeva mornica në trup dhe më erdhi të pështirë. Isha lodhur, kisha vetëm një dëshirë: — të çlodhesha. Ndofta nuk do të bija në sy të shokëve, po nuk e mbajta dot veten dhe u ula mbi plis pa çarë më kokën për asgjë. Veraqi m'u afrua gjithë inat, kur më pa në atë gjendje, dhe duke çkërmitur dhëmbët më dha urdhër:

— Mblidhe veten, «quro»! Hajt, ngreu më këmbë dhe mos më rri ulur si ata mizerjet!

Vështrova rreth e rrotull. Të gjithë ishin të lodhur dhe të raskapitur, po nuk e kishin lëshuar veten si unë. Më vinte inat që isha ulur, kurse Tomi, që ishte nxirë në fytyrë sa nuk njihej, e mbante veten. Më erdhi kaq rëndë, sa t'i hyja vetes me shkelma, por edhe sikur të mundja, nuk isha në gjendje ta bëja as atë, sepse fuqitë më kishin lënë. Veraqi kishte të drejtë. E kisha lëshuar veten si një i mjerë. Përmblodha të gjitha fuqitë dhe u ngrita më këmbë. Përpara kishim edhe shumë punë për të bërë. Vështroja kavot e sarta, që ishin mbështjellë si gjarpëri përpara këmbëve të mia dhe vendosa të kërleshsha me to. Megjithëqë ishte një punë e rëndë dhe e vështirë, vendosa i pari të hidhesha në luftë me ato. Isha gati të bëja atë që më kishte shkuar nëpër mend, kur, para meje dhe më shpejt se unë, u fut në luftë me ato një njeri tjetër. Ishte traktoristi i fermës i nxirë në fytyrë. Ne gabojmë kur mendojmë dhe formojmë mendim për njerëzit vetëm nga një e vështruar dhe nga fytyra që kanë. Njeriun duhet ta njohim në punë, dhe jo në një punë dosido, po në punë të vështirë.

Më vinte inat me veten dhe, po të më jepej mundësia, do ta falenderoja atë njeri të mirë. Motorët e traktorëve që kishin sjellë atje, kishin kohë që amballareshin dhe ishin hipur mbi trarët e shtrirë në kënetën e qullët, e cila nuk mbante asgjë në kurriz, po i përpinte traktorët si lubi. Kavoja ishte lidhur te traktori që ishte zhytur, kurse traktorët që shkonin mbi trarët filluan të tërheqin me kujdes. Trarët e vendosur mbi kurrizin e kënetës kishin filluar të zhyteshin ngadalë në baltë e batak. Pësha e traktorëve vërtet ishte e rëndë, por ne nuk kishim frikë se mos ata, duke shkuar mbi trarë, do të fundoseshin në kënetë. Jo për këtë ishim shumë të sigurtë dhe kishim besim se trarët e shtruar nuk do të lëviznin. I kapur nga ethet e punës, e kisha mposhtur lodhjen dhe isha bashkuar me shokët që po bërtisnin për t'i dhënë zemër njëri-tjetrit. Mbas pak, nga gropa e thellë ku ishte fundosur traktori, filloi të dalë skapamentoja e tij, pastaj pjesa e mbrapme... U shkrimë që të gjithë nga gëzimi. Klithma e përbashkët ishte e fuqishme dhe buçiti në tërë kënetën.

Traktori, që ishte në gropë, kishte dalë jashtë dhe prej skatullave të diferencialit të tij filloi të kullojë ujët e pistë. Traktorët nuk u ndalën. Ata vazhduan ta tërhiqnin traktorin që kishte nxjerrë prapaniken nga pusi dhe të ecnin me forcë përpara, sa më larg zonës së rrezikshme. Megjithëqë traktorët ishin ngarë me shumë kujdes sipër trarëve, disa nga trarët ishin thyer me krisma dhe ne kishim ngrirë në vend. Po gjene trarët mbajtën shumë mirë, dhe ne mbetëm të kënaqur prej tyre.

Në atë rast kishte gjallëri të madhe. Punëtorët shkocin sa nga njëra anë në tjetrën, sipas nevojës. Ishte çasti më i rrezikshëm dhe duhej të tregoheshim më të shpejtë në shtrirjen e trarëve. Trarët e llangosur me baltë ishin bërë të rëndë plumb. Punëtorët ishin të lodhur e tërë baltë, por nuk e bënin veten. Të gjithë e kryenin punën me nxitim dhe pa fjalë. Ky qëndrim i punëtorëve na bëri përshtypje dhe menduam aq mirë për ta, sa nuk kishim menduar kurrë për njeri tjetër. Ja kishim dalë mbanë, dhe traktori i porsanxjerrë nga gropa ku ishte zhytur po ndiqte pas shokët e tij. Në kabinën e qullur të tij u hodh me të shpejtë, si një ketër Veraqi, i llangosur si kurrë ndonjëherë. Ai mbërtheu levat dhe u mbajt prej tyre. Plugun e kishim hequr më parë nga zona e rrezikshme, kështu që traktori nuk e pati të vështirë të shkonte mbrapsh. Më tej, të gjithë traktorët u ndalën në vend dhe prej tyre dolën shokë që filluan të përqafoheshin e të putheshin për fitoren. Më shumë nga të gjithë hidhej e ulërinte Faiku, që nuk i kishte nxirë duart. Tek e pashë atë që puthej me të tjerët, më erdhi të pështirë dhe inat.

Një traktor e kishim nxjerrë. Por përpara nesh ishin traktorët e tjerë, edhe për ta duhej mundim. Nuk duhej të gëzoheshim para kohe, po të tregoheshim të vendosur sa t'i nxirnim të gjithë traktorët. Megjithatë, nxjerrja e traktorit nga gropa ishte një fitore e madhe dhe nuk ishte keq ta ndiznim nga një herë për nder të tij. E ndezëm. Duke thithur duhanin e qullur, vështroja trarët. Ata ishin ka-tandisur si mos më keq, por punën e kishin bërë si jo më mirë. Punëtorët e fermës zbathën opingat dhe filluan

t'i pastronin ato nga lluca. Tek na vështruan ne, qeshën. Qeshëm dhe ne dhe çdo gjë kaloi shumë mirë.

Gjymtyrët më ishin këputur. Më dukej sikur eshtrat e duarve më kishin marrë zjarr dhe më shponin mijëra gjilpëra. Faiku po grindej me Vasilin. Vasilin e kishte mbuluar balta nga koka te këmbët.

Nuk e kisha parë ndonjëherë veten kaq pisk. Më dhimbte gjithë trupi dhe mezi merrja frymë. Tomi kishte nxjerrë çizmet me gjithë çorapet. Çizmet i kishte lënë mënjanë dhe po shtrydhte çorapet. Punëtorët, të lodhur dhe të uritur, vendosën të hanë drekën, që kishte kaluar me kohë. Ata u ulën më bisht dhe hapën torbat. Bukën e kishin mbështjellë në ca shami të mëdha. Vetëm atëherë u kujtova që nuk kisha ngrënë bukë. Tek vështronim punëtorët që thyenin gjithë zhurmë kokën e preshit të bardhë, na lëshonte goja lëng. Nga nxitimi, kishim harruar të merrnim bukën me vete. Dhe kjo po na kushtonte shtrenjtë.

Gjithmonë Veraqit i ngarkohej faji, kur ne mbeteshim pa bukë.

Punëtorët e fermës na panë tek rrinim si ata jetimët që kërkojnë diçka dhe na ftuan me gjithë zemër të shtroheshim në sofrën e tyre. Faiku, si i pacipë që ishte, u ul këmbëkryq pranë tyre. I bëra me shënjë të ngrihej. Ai më nxori gjuhën dhe më talli. Pasi punëtorët na ftuan për herë të dytë, u ulëm edhe ne dhe filluam të hanim bukë. Preshi, që më kishte dhënë një punëtor, më pëlqeu. Ishte i ëmbël në gojë. Presh të tillë vetëm në Devoll rriten. Kapërcyem disa kafshita sa për të thyer urinë, dhe nuk u shtruam si Faiku për t'u nginjur mirë. Gjiza dhe preshi atë ditë ishin një mrekulli që s'e kishim shijuar kurrë ndonjëherë. Nuk u ngopëm. Me atë uri që kishim, ishim gati të hanim edhe një buall të pjekur. Punëtorët i thonin preshit me shaka «fshatar i varfër» dhe ja këputnin gjithë oreks kokën e bardhë. Gjizën e kursenin dhe lypenin kokën e preshit me të si lyhet thela e mishit me mustardë. Qysh atë ditë menysë sonë ju shtuan edhe dy asortimente: preshi dhe gjiza.

Kur mbaruam drekën, e ndjeva veten më mirë. Filluam përsëri nga puna. Dita ishte e shkurtër dhe kishte kohë që ishte thyer. Trarët, megjithë peshën e madhe që kishin mbajtur, kishin qëndruar për bukuri. Po kur po nxirrnim traktorin e tretë, na u thyen dhe tri copa të tjerë trarë. Mendova për një çast se kaq e pati traktori im dhe se gjithë punën do ta hante dreqi, po nuk ndodhi kështu. Trarët, megjithëse të sakatosur, kishin mbajtur, dhe traktori me gjithë plugun kishte dalë jashtë për bukuri. Dita kishte marrë fund dhe nga çasti në çast pritej të binte muzgu.

Kur traktori i katërt ishte gati më të dalë, u këput kavoja dhe Faiku u godit lehtë në pulpë. Klithma e tij u ngrit deri në qiell dhe filloi të mallëkonte Veraqin, që i kishte kthyer nga rruga dhe i kishte futur «në atë djall parcelë, e cila të merrte shpirtin». Faiku bërtiste aq shumë, si ta kishin mbërthyer të gjitha grifshat e botës. Ulërinte si një ujk i plagosur dhe ne, në fillim, u trembëm. Me duart që na dridheshin, i çamë pantallonat dhe vështruam plagën. Ajo ishte e vogël, e zezë dhe kishte filluar të enjtej. Ja lidhëm menjëherë dhe e hoqëm mënjanë, ndërsa ai vazhdonte të ulërinte dhe nuk pushonte së mallëkuari Veraqin. Më vonë e kishte pranuar vetë se gjithë atë shamatë e kishte bërë me qëllim që të hakmerrej kundrejt nesh. Plaga nuk ishte e madhe dhe ishte budallallëk të thërrisje aq shumë për atë vogëlsirë. Na bëri të gjithë nevrikë. E vështronim me përbuzje kur thërriste, dhe na vinte inat që ai ishte traktorist si ne. «Trimat nuk duhet të bërtasin, qoftë dhe kur u presin këmbën», më kishte thënë nëna një herë.

Kur vështroja Faikun, që bërtiste si fëmijë, m'u kujtua nëna. Me siguri që po të ishte dhe nëna e Faikut, do t'i vinte turp për djalin e saj, kur ta shihte të katandisur në atë gjendje. Vërtet që nënat janë të dhimbshme, por mbi të gjitha duan një gjë nga djemtë e tyre: «të jenë trima!»

Mendimet ndiqnin njëri-tjetrin dhe i kishin bërë veshët e mi të buçisnin. Po të ishte Simoja midis nesh,

lodhjen do ta kishim më të lehtë, dhe punën do ta kishim mbaruar më shpejt. Ai ishte i rrahur me vaj e me uthull për punët e kënetës. Megjithatë, edhe pa Simon, punën nuk e kishim bërë keq. Trarët ishin thyer që të gjithë, ndërsa në gropë na kishte mbetur dhe një traktor. Po ngrysej. Vendosëm që, para se të bëhej natë, ta nxirrnim edhe traktorin e fundit, pa le të dilte ku të dilte. Ashtu bëmë. Duke lidhur kavon në kavon e traktorit, që kishte mbetur atje, mënd rashë brenda në gropë. Më kishin lënë fuqitë dhe isha gati të bija brenda, kur një dorë e fuqishme më kapi për supi. Zëri i fortë më solli në vete:

— Mbaju!... Ishte Veraqi.

Të lodhur ishim, por e ndjenim veten të lehtësuar nga shpirti. Të gjithë traktorët i kishim nxjerrë dhe kjo ishte një punë e madhe që kishim bërë. Traktorët ishin zhyer e bërë si mos më keq. Veglat na kishin humbur dhe na kishin rënë nëpër puse. Teneqetë e ujit dhe hinkat, që na shërbenin për të hedhur karburant, ishin shtypur e bërë petë. Veraqit i kishte humbur tapa e radiatorit dhe i vinte inat. Kishte kontrolluar të gjithë traktorët, por tapën nuk e kishte gjetur. Ajo ishte zhdukur pa lënë gjurmë, si ta kishte përpirë dheu.

Atë natë të gjithë na zuri gjumi me këpucë mbathur. Ishim të raskapitur. Zjarr nuk ndezëm në vatër. U shtrimë të gjithë nëpër minderet, u mbuluam me bataniet deri te veshët dhe na kishte mbërthyer sakaq gjumi.

Tomin e kishte zënë gjumi duke buzëqeshur dhe ashtu kishte mbetur, me buzëqeshjen të ngrirë në buzë. Kishte të drejtë Tomi. E kishte drejtuar traktorin vetëm dhe kjo nuk qe pak. Na kishte hyrë të gjithëve në zemër ky djalosh. Kishte mësuar shumë, sillej thjesht me ne dhe na kishte bërë për vete. Gjymtyrët i kishte të dobëta, por ishte punëtor dhe zemërbardhë. Kishim kohë që nuk e tallnim më për duart e tij të holla. Gjatë kohës që kishte ndenjtur midis nesh, kishte treguar aftësi të mëdha. Ai e kuptonte qëndrimin tonë dhe ishte i gëzuar. I bëhej zemra mal, kur e lëvdonim dhe ja çmonim punën. Në fillim patëm frikë se si gjimnazist që ishte, mos i

rritej mendja dhe qëndronte larg nesh. Një sjellje e tillë do ta kishte dëmtuar Tomin dhe nuk do ta kishte lënë të mësonte zanatin; po ai ishte djalë i sjellshëm dhe aspak mendjemadh. Ai dinte të sillej dhe kishte respekt për të mëdhenjtë. Kishte treguar zotësi në lidhjen e kavove, dhe, në qoftë se edhe atë e kishte zënë gjumi me këpucë mbathur, kishte patur të drejtë. Kishte punuar gjithë ditën dhe ishte treguar i aftë, si zanatçi i vërtetë. Tomi i mëshonte trupit me gjithë fuqitë që kishte dhe nuk kursehej si shoku i tij, Faiku.

Në mesnatë, duke fjetur, ndjeva të ftohët dhe u çova nga shtrati. Duke kërcitur dhëmbët, kalova në mes të dhomës, që ishte bërë si frigorifer. Jashtë kishte rënë cikmë dhe hëna shkëlqente. Motori i dritave kishte kohë që kishte heshtur dhe ja kishte marrë gjumit edhe ai.

Nga të ftohtit na doli gjumi shpejt. Tomi së bashku me Kostën dhe Vasilin u morën me zjarrin. Vasili, për ta nderur shpejt zjarrin, mori një kuti me gaz dhe spërkati drutë. Ngaqë ishte i ftohtë, lëngu mezi u nder. Mbasi u nder zjarri, të gjithë u mblodhëm rreth tij. Por flaka nuk mbajti. Sa u dogj gazi dhe flaka ra. Drutë e përzhitura mezi morën.

Vasili, si gjithmonë, jo vetëm që nuk kishte mundur ta ndizte zjarrin për të cilin ishte zotuar, por edhe ishte vonuar si shumë në furrën e bukës. Kur hyri në dhomë, ishte i qeshur dhe e hodhi bukën sipër kokëve tona, si të ishte një copë tjegull. Ju afrua Tomit gjithë gaz, i zuri duart dhe ju lut:

— Tomi, vëllaçko, më bëj një letër!

Tomi e dëgjoi në heshtje dhe i dha fjalën se do t'ja shkruante. Por Vasili u tregua i paduruar dhe e detyroi djaloshin t'ja shkruante letrën në çast.

Tomi u ul në shtrat, mori fletoren në duar dhe e mbështeti në gju. Fletorja ishte me kuti dhe lapsi kopjativ. Tomi i bëri buzët gjithë bojë, sepse e vinte lapsin në gjuhë për ta lagur. Doli një letër e gjatë, që fillonte kështu:

«E dashur shoqe!

Ju mund ta merrni me mend se kush e shkruan këtë letër; por për ideal në e kam me shaka dhe djallëzi! Nuk dua të tallem me ty dhe me asnjëri, sepse nuk jam mësuar të tall njerëzit; për kokën e babait në të gënjej! Mëso se jam njeri i ndershëm dhe i shëndetshëm. Për punë mos ki dert, se punoj më keq se një kalë; këtë le ta dijë dhe babi yt. Kam vënë re, se dhe ti je vajzë e ndershme dhe punon shumë. Për një çast mendova se gjeta yllin që desha dhe rashë në dashuri me ty. Po të shkruaj ashtu siç më vjen, pa u munduar të gjej fjalë të bukura e të mëdha, siç bëjnë borgjezët, të cilët ndryshe shkruajnë e ndryshe mendojnë. Ty nuk do të të vijë ndoht që pantallonat e mia mbajnë erë gaz dhe naftë. Me sapun lahen shpejt. Tre kallëpë sapun dhe puna merr fund...»

Deri këtu munda ta dëgjoj letrën. Letra dukej si qesharake dhe nuk më bindte se do të bënte punë. Vasili ngulte këmbë në të tijën, dhe unë nuk kisha qejf të merresha gjatë me diskutime. Si të mos mjaftonin të gjitha këto budallallëqe, Vasili nguli këmbë që në fund të letrës të shkruheshin dhe këto fjalë: «Thuaj që yjet janë zjarr, thuaj që deti më mbyti mua, por mos më thuaj që s'të dua!» Fundi i letrës ishte një çorbë e vërtetë dhe nuk kuptova asgjë. Mendova se nga një letër e tillë vajza do të mendonte se Vasili ishte fyçkë fare nga koka.

Të gjithë ishim të bindur se një letër e tillë nuk kishte as lezet dhe as vlerë që të dërgohej. Po Vasilit i ishte mbushur koka qyp dhe unë nuk kisha qejf të merresha me të.

Letra nuk ra në duart e vajzës, dhe kjo ishte një fatbardhësi për Vasilin. Ne u tallëm një copë herë me dëshirën e Vasilit dhe ai nuk guxoi të na jepte përgjegje. Për dashurinë kishim mendime të gabuara. Të gjithë ishim të rinj, nuk i kishim kapërcyer të tridhjetat, po mbi këtë pikë mendonim si prapanikë.

Kur Vasili e pat shprehur qartë se e dashuronte vajzën dhe se të dashuroje nuk ishte krim, ne menduam se

atij i kishte plasur cipa dhe se ajo vajzë nuk do të kishte qëndrim të mirë. Dhe kjo kishte shkaqet e saj. Prindërit tanë na e kishin futur në gjak urrejtjen për dashurinë. Dashuria, simbas tyre, shturte vajzat, dhe i bënte djelmoshat pa karakter. Këshillat e prindërve e kishin bërë punën e tyre. Megjithëse të veçuar nga jeta gjithë zhurmë e qytetit, ne përpiqeshim që marrëdhëniet me punëtorët e fermës dhe sidomos me vajzat e reja që punonin atje, t'i kishim të mira dhe të sigërtë. Mos vallë Vasili, me dashurinë që kishte për atë vajzë, i vinte kazmën gjithë dashurisë dhe respektit që kishte për ne shumica e punëtorëve të fermës? Mund të ndodhte dhe kështu. Për Vasilin ishte shumë mirë që Sofokliu ishte shtruar në spital. Ai ishte i tmerrshëm për punë të tilla dhe të priste kokën, kur merrte vesh se kishte zënë dashuri me një vajzë. Njeriu i ndershëm, simbas mendimit të tij, nuk merrej me dashuri. Vasili ishte me fat, sepse Sofokliu ishte shtruar në spital, po mjerë ai, kur të vinte Sofokliu në brigadë.

18

Maqina ishte e SMT-ës. Ajo ishte një «Praga» e vjetër, më keq se një plakë shtrigë. Në spondet e saj të thyera ishte rrezik të uleshe. Ato ishin të ngushta. Ishte ngarkuar me fuçi me gaz dhe me një grumbull me balestra të thyera, që ishin prerë dhe përgatitur enkas për zinxhirët e traktorëve. Shoferi i mërzhitur nuk e kishte bërë rrugën me qejf. Ai vështronte radiatorin e «Praga»-s dhe maskarinon, që ishte ndohtur e bërë gjithë baltë dhe pështyu-tutje me neveri. Nga karrocëria e maqinës kishte zbritur dhe Skënderi i shkurtër, të cilit i ishin mbushur sytë me lot dhe përflakur faqet nga thëllimi. Ai kishte vënë një kapele të vogël në kokë, me një formë të çuditshme dhe na dukej shumë qesharak.

Ndoshta për inatin tonë, ndoshta për qejfin e Skënderit, në atë çast para nesh kaloi një gajdexhi hipur mbi një gomar. Gajden e fryrë e shtrëngonte me të dy duart

në gjoks. Pizgën e mbante në gojën me bulçitë e fryra, dhe tubin e zërit të trashë e kishte hedhur në sup. Mbrapa tij vinte një grup i madh njerëzish, që kishin dhe daire në duar. Grupi ishte i gëzuar dhe po kalonte gjithë zhurmë. Ishin dasmorë dhe qenë bërë më qejf nga gotat që kishin hedhur. Vetëm atëherë u kujtuam se atë ditë ishte e dielë.

Më vonë, pranë nesh kaloi një grup kalorësish, që i kishin lëshuar kuajt me të katra. Grupi ulëriti kur u afrua tek ne dhe u zhdruk mbrapa urës së drunjtë.

Ne i tallëm, por dasmorët nuk na dëgjuan. Siç duket, nuk na e kishin varur, as që ishin merakosur fare për ne. Simoja, që kishte zbritur nga kabina e maqinës rrëngallë, kishte ndeshur me traktorët, që ishin të gjithë në fushën e vogël përpara ndërtesës dhe habitej, nuk u zinte besë syve. Ju afrua me ngadalë grupit të traktorëve dhe i vështroi të gjithë me radhë. Kur u bind se traktorët ishin të gjithë shëndoshë e mirë dhe jashtë kënetës, nuk ju durua dhe na përqafoi të gjithë. Skënderi ishte hutuar. Fërkonte sytë dhe nuk i zinte besë traktorit të tij aty anës grupit. «Kush e nxori atë dhe kush e solli nga kënetat deri këtu?» Skënderi na vështroi të gjithë me radhë, si të donte të zbulonte «fajtorin», që ja kishte nxjerrë traktorin deri atje. Po ne ishim gabuar, kur kishim menduar keq për Skënderin. Ai ishte prekur aq shumë nga gjesti ynë, sa mënt po qante me lot.

— Më lini t'ju puth në faqet «Çapajevë» tha ai, dhe nxori shaminë nga xhepi, si për të fshirë hundët, po e afroi te sytë.

Nuk patëm kohë për të festuar nxjerrjen e traktorëve nga kënetat. Shoferi i «Praga»-s na kujtoi se duhej të shkarkohej maqina. Shoferi ishte i gjatë sa një hosten dhe mezi e nxinte kabina e maqinës. Të gjithë e njihnin dhe e donin, sepse ishte i urtë e i butë si qingj.

Ai na u lut ta shkarkonim pak shpejt, sepse në qytet kishte ndeshje futbollit dhe donte ta shihte me çdo kusht; ishte tifoz i çmendur.

Hapëm spondet dhe filluam t'i hedhim fuçitë nga

karroceria. Poshtë, në tokë, aty ku binin fuçitë, kishim vënë një gomë të madhe që të mos çaheshin fuçitë. Mua më kishin caktuar t'i shpija fuçitë deri në vendin e duhur duke i shtyrë. Vështroja Veraqin se si i hidhte fuçitë, se si përplaseshin ato mbi gomë dhe ndiqja me sy rrokullisjen e tyre, derisa ndaleshin. Në këtë punë të lehtë më ndihmonte dhe Skënderi i gjatë. Fuçitë i shtynim, dhe ato vërtiteshin mbi baltë. Skënderi edhe në këtë punë nuk e hapi gojën. Kushedi se ç'kishte. Toka kishte ngrirë, dhe fuçitë bënin shumë zhurmë.

Duke u vërtitur në tokë, ato kishin marrë me vete copa dheu të ngrirë dhe tërë brymë. Simoja vuri re vazhden e lëngut që derdhej nga fuçia që shtynim dhe thirri:

— Ndal, Skënder!

U ndalëm në vend dhe e ngritëm fuçinë më këmbë. Ajo ishte e rëndë, dhe nga lodhja Skënderit i dolën damarët e qafës jashtë jakës së këmishës. Simoja na u afrua dhe na hoqi vërejtjen:

— Me kujdes, të shkretën, nuk është ujë!

E dëgjuam dhe nuk nxorëm asnjë fjalë. E kishim këtë të mirë. Gjithmonë, kur gabonim, heshtnim, si të kërkonim të falur.

Skënderi gjeti një gur të mprehtë dhe filloi të godasë me të tapën e lirë të fuçisë. Fuçia lëshonte një zhurmë të fortë, sepse ishte plot me gaz. Pastaj e lëshuam me kujdes poshtë dhe filluam ta shtyjmë në mënyrë që të mos derdhej gazi. Kur filluam të hedhim poshtë nga karroceria e maqinës copat e balestrave, u bë një zallahi që u tund dheu. Balestrat, duke u përplasur me njëra-tjetrën, bëjnë aq shumë zhurmë, sa që tërhoqën vëmendjen e fëmijëve të fermës. Ndërkohë, ata u mblodhën të gjithë tek ne dhe u bë një rrëmujë që s'e mori vesh i pari të dytin.

Patëm frikë t'i linim jashtë copat e balestrave, se do të merrnin dhenë nëpër gjithë sektorin nga fëmijët, dhe ec e t'i gjeje pastaj.

Shoferi i gjatë u kënaq nga puna jonë e shpejtë. Simoja e porositi atë t'i thoshte drejtorit të mos e niste eskavatorin, që kishte kërkuar Simoja për brigadën e shtatë, sepse traktorët i kishin nxjerrë vetë traktoristët. I uruam

rrugë të mbarë shofer Mazllëmit dhe ai ja shkeli «Praga»-s shkatërraqe, sa na u duk sikur do t'i thyheshin koskat. E pata zili Mazllëmin që do të vështronte ndeshjen e futbollit, dhe më theri në zemër që nuk shkova me të. Po sikur më qetësoi cazë cingarja që më dha Skënderi i shkurtër. Ishte nga cingaret e mira dhe çuditesha se ku i gjente Skënderi. Duke pirë cingaren, m'u ndez një dëshirë tjetër: doja të shkoja në klub e të ktheja një gotë, po nuk kisha qejf të shkoja vetëm, prandaj prisja sa të hapej shtegu që të ftoja edhe Veraqin. Ngaqë e kisha mendjen te klubi, nuk e kuptova pyetjen që i kishte bërë brigadierit Skënderi i gjatë. Simoja filloi të tregonte për një farë komisioni të kontrollit që kishte ardhur në qytet. Lajmet që na solli brigadieri nuk ishin aspak të mira. Kontrollin e tregonin shumë të ashpër. Skënderi i gjatë pati frikë se mos komisioni zbriste deri në kënetë dhe kontrollonte edhe brigadën tonë. Një gjë e tillë më dukej e pabesueshme, dhe habitesha me Skënderin. Pse bëhej aq fort merak ai për komisionin!? Simoja vazhdonte të tregonte: — Stilloja më tha: «Kryetari është i çuditshëm dhe kokëmadh e mendjemadh. Kërkon që traktorët të jenë të pastër dhe të shkëlqejnë aq shumë, sa të të vriten sytë. Çfarë njeriu! Kërkon kallëz në dëborë ai. Është dhe nevrík. Të ofendon si pa gjë të keq. Ata djemtë e mi do të ishin mbërthyer mirë me atë, po i mbajta unë. Do të kisha avaze po t'i lija. Vështro Simo, hap sytë dhe merr masa para se të vijë, se do të gjesh belanë me të!»

Më dukej se Stilloja e kishte inat kryetarin e komisionit, prandaj fliste ashtu. Stilloja ja këpuste kodra pas bregut dhe nuk mendonte se ne nuk do t'i hanim aq kollaj ato. Fundja komisioni do të kishte aq mend, sa të mos kërkonte qiçra në hell.

Pastaj, biseda u hodh te traktorët e nxjerrë nga kënetat. Për këtë çështje filluan të tregojnë të gjithë pa radhë dhe u bë një rrëmuje e madhe. Nuk merrej vesh se kush fliste, kush gënjente dhe kush tregonte të vërtetën. Vetëm se për punën e punëtorëve të fermës Tomi kishte folur shumë drejt. Kishte treguar të vërtetën, dhe i lumtë për këtë.

Faiku, që s'kishte bërë pothuajse asgjë gjatë gjithë punës për nxjerrjen e traktorëve, kishte filluar dhe po na vriste të trasha. Veraqi ja mbërtheu një herë sytë, po ai nuk kishte ndër mend të pushonte. Faiku na e solli në majë të hundës.

— Thoni si të doni, po të mos isha unë me gjithë traktorin, ju «nanac» se do të delnit prej andej. Dhe kur tha «nanac», ngriti gishtin e madh përpjetë. E dëgjoja si i tërbuar nga inati. Ai gënjente me paturpësi në sy të të gjithëve.

Veraqi ja kishte qepur sytë i zemëruar dhe buza e sipërme i lëviste si t'i kishin ngacmuar nervin. Simoja e vështronte me mosbesim, dhe në sytë e tij të kaltër shprehej habia. Skënderit të gjatë, që kishte heshtur gjatë gjithë kohës, më s'ju durua dot pa folur dhe ja plasi Faikut para syve, duke na habitur të gjithë me sjelljen e tij.

— Po kujt ja luan ti, bre kodosh, këto kinemara me bojëra. Turp të kesh! Pse nuk i thua brigadierit që u mbërtheve me ne, ngaqë s'deshe të vije të punonim bashkë? Pse nuk i tregon brigadierit si na vështroje ne kur cfiliteshim në mes të baltës, dhe ti na bëje sehir nga maja e traktorit? Të kemi tërhequr për hunde se nuk deshe të vije, dhe tani na del si shpëtimtar i brigadës. Turp të kesh! . . . — kishte përfunduar Skënderi i gjatë. Kjo ishte e papritur për ne dhe na çuditi të gjithë. E meritonte. Na u bë zemra mal.

Kështu, papritur dhe padashur, ishte hapur mbledhja e brigadës dhe kishin filluar diskutimet. Faiku ishte hedhur nga vendi si ta kishte pickuar gjarpëri.

— Nuk është nevoja të më japësh mend, ti, shoku Skënder. Ti vështro veten tënde. Hap sytë se mos të të zënë nga cepi i palltos ata të cilëve u ke shitur biçikletat kontrabandë. Unë, sido që të jem, si ti nuk jam. Kontrabandisti më jep mend mua!

Skënderi e mbajti veten dhe ja priti:

— Që nuk jam shoku yt, kjo është e vërtetë. Për atë punën e kontrabandës, që më thua zotrote, unë kam hequr dorë, dhe nuk do bëj kurrë gabime të tilla. Vështro,

se të flasim për të mirë, — e këshilloi dhe një herë Skënderi atë. Po ku merrte vesh koka e Faikut!

Veraqin nuk po e mbante më vendi dhe kërkoi fjalën:

— Ja ku po të them, shoku brigadier, — të gjithë e vështruan me vëmendje Veraqin që vazhdoi të fliste me emocion. — Nuk di se si e mbajta veten dhe nuk u bëra me turp, se për besë, nuk do të ndaheshim mirë me shokun Faik. Nuk e di në kam bërë mirë ose jo që nuk u zura me të.

— Ke bërë shumë mirë, — ju përgjegj aty për aty brigadieri.

— Ky na turpëroi të gjithë përpara punëtorëve të fermës, — vazhdoi Veraqi. — Ata të shkretëtë vinin vullnetarë me ne, ky birçeja nuk donte të vinte me gjithë traktorin, si ta kishte traktorin e tij personal. Erdhi vetëm kur e kërcënuan, dhe bëri shumë mirë që erdhi, por gjatë punës zuri të na hidhte vickëla; na vuri kujen, si t'i kishim prerë këmbën, për një gërvishje të vogël. Ky sikur nuk është traktorist, por... — këtu Veraqi heshti, sepse nuk gjente dot fjalën e krahasimit.

Kur desha të merrja fjalën e të thoja dhe unë nja dy gjëra, brigadieri, që ishte nevrikosur, u ngrit më këmbë dhe ma la huq. Ai foli shkurt dhe shkoqur:

— Punë të bukur na paskeni bërë, besa! Bravo! Tashti i lini fjalët! Nuk dua të dëgjoj asgjë, çështjen do ta shohim në mbledhjen e kolektivit.

U shtrimë të heshtur mbi minder. Ishte herët për të fjetur, dhe zemra nuk na bënte për asgjë. Vasili m'u afrua te veshi dhe më tha:

— Nesër do të dal herët dhe do t'ja them të gjitha.

— Kujt do t'ja thuash të gjitha? Faikut?

— Mos u tall me mua. S'e sheh? Më mori malli për Faikun. Shkëlqimes do t'ja them.

— Ti je frikacak, Vasil, — e shpova unë.

— Frikacaku i..., — ma priti ai duke qeshur dhe u zvarrit nga vendi tek ishte shtrirë. Kur u largua, më dha me marifet një grusht në ije. Goditja s'qe e lehtë dhe më dhembti, ndërsa ai më vështronte së largu me buzën në gaz. I tunda grushtin tim dhe i ktheva kurrizin si për hak-marrje.

Komisioni na erdhi fare papritur. Ishim duke riparuar traktorët dhe e kishim harruar të gjithë historinë që na kishte treguar Simoja, kur ja behu komisioni i kontrollit.

Traktorët ishin të llangosur me baltë dhe qenë bërë për faqe të zeza. Unë po grindesha me Kostën, që ishte krejt i pafajshëm. Isha bërë nevrrik kot së koti dhe po i shfryja Kostës, që nuk ishte aspak shkaktar i zemërimit tim. Ishte shtypur e bërë petë hinka e hedhjes së gazit, kur kishim nxjerrë traktorin, po për këtë Kosta nuk kishte aspak faj. I shfryja dhe e akuzoja si një njeri që nuk interesohet për të ruajtur veglat. Në këto fjalë e sipër ja behu komisioni. I pari zbriti nga maqina një burrë i gjatë me shpatulla të gjera dhe me një republikë në kokë. E vështrova me interesim fytyrën e tij. Me siguri që ai do të ishte kryetari i komisionit, sepse zbriti i pari nga vetura. Kishte veshur një palë këpucë të bukura me garniturë dhe gjithë luspa, që s'i kisha parë ndonjëherë. Vetëm se sytë i kishte të skuqur dhe të egërsuar. Dukej nga sytë që ishte nga ata njerëz, të cilët i thonë sherrit lepe. Njeri i rëndë, nuk begenisi të na fliste. Kjo gjë më zemëroi dhe vendosa të përqëndrohesha në punë, duke mos e çarë fort kokën për atë. Nga maqina zbriti dhe një djalos i paktë së bashku me inxhinierin tonë.

Simoja, që ishte në grupin e Vasilit, i cili kishte hequr i pari zinxhirët për t'i shtuar, ju kishte dalë përpara duke fshirë duart me lecka. Inxhinieri ynë, që ishte një amator i çmendur i muzikës dhe këngës, diçka i kishte thënë në vesh kryetarit të komisionit, i cili i zgjati dorën me mospërfillje Simos. Ky ja zuri dhe, siç duket, ja shtrëngoi shumë. Kjo nuk i pëlqeu kryetarit dhe e vështroi Simon në sy. Simoja nuk ja vari torbën dhe filloi t'i fliste për punën. Me sa dukej, fillimi nuk ishte i mbarë dhe për këtë na vinte keq të gjithëve. E lamë kontrollin në dorën e njeriut që kishte ardhur i caktuar me atë detyrë dhe ju futëm punës që kishim filluar. Me varë të

madhe qëllonim spinotat e zinxhirëve, që nuk dilnin jashtë. Ishte një punë e lodhshme. Spinoti lidhte të dy pjesët e zinxhirit dhe, ngaqë ishte ndryshkur, nuk dilte nga pllakat metalike. Kishte spinota që ishin të lira. Ato, kur qëlloheshin me varë, delnin nga pllakat e zinxhirit dhe nguleshin gjithë forcë në tokën e butë, si të ishin shtiza që flakeshin nga muskuj të fuqishëm herkulianë.

Brigadieri e kishte ulur kokën, shenjë kjo që donte të thoshte se punët nuk po shkonin dhe aq mirë. Veraqi, si ta kishte kuptuar shqetësimin e brigadierit, e la punën dhe, duke fshirë duart, i doli përpara kryetarit të kontrollit. I zgjati dorën të porsaardhurit, dhe ai, i zënë ngushtë, ja dha dorën. Inxhinierit, që shoqëronte komisionin, i qenë skuqur veshët. Ai e njihte shumë mirë Veraqin dhe e dinte si i priste gjuha. Me të parë Veraqin që i shkeli syrin gjithë djallëzi, flokët e inxhinierit, të ashpra si gjëmba iriçi, u ngritën përtpjetë. Si të mos mjaftonte kjo paturpësi, Veraqi e goditi inxhinierin edhe në shpatulla, si ta kishte shok të vjetër. Pastaj nxori cingare «Dajti» dhe ua zgjati atyre. Kryetari e pa veten të zënë ngushtë dhe nxori paketën e tij. Ishte një paketë e bardhë me cingare «Diamant», të mbështjella me krisaf dhe të hekurosura. Kishin edhe pipë, gjë që na bëri të çuditeshim. Veraqi e mori cingaren që i zgjati tjetri dhe e futi në xhep paketën e tij të lirë, që ishte ndohtur e bërë gjithë varvolinë. I kërkoi dhe zjarr dhe kryetari ja ndezi me çakmak. Pastaj, Veraqi, si të ishte mik i ngushtë me atë, filloi nga pyetjet:

— Si keni qenë?

— Mirë! — tha kryetari i çuditur.

— Ashtu. Po nga familja si jeni?

— Mirë! — ja priti ai i mërzhitur nga pyetjet që po i bënte Veraqi. Siç dukej, ai ishte një njeri që i kishte inat përgjegjet, dhe pyetjet duhej t'i bënte vetë ai.

— Keni ardhur këtej nga ana jonë?

— Si e shikoni, — ju kërcënua shefi.

Veraqi e pati pisk me atë njeri të çuditshëm e nурсëz. Duke vështruar atë birçe kontrolli, më shkoi mendja tek ministri, që na kishte vizituar në mes të kënetës.

Ministri ishte treguar i dashur me ne dhe burrë i urtë. Na kishte lënë mbresë në shpirt me sjelljen e tij dhe na kishte marrë malli të takonim një njeri të tillë, që e kishte fjalën ballsam për plagët tona. Ministri na kishte dhënë të gjithëve cingare dhe na kishte pyetur për shëndetin dhe familjet, për vështirësitë, na kishte dhënë kurajë. Kurse ky po na sillej mjaft ftohët. Këto po mendoja duke mbajtur spinotin e zinxhirit. Kosta i mëshonte fort varesë dhe nuk trembej se mos më godiste dorën.

Veraqi u tërhoq prej grupit të tyre dhe nuk u dha as dorën, shënjë kjo që donte të thoshte se lufta me ta sapo kishte filluar.

Shefi i kontrollit, me t'u larguar Veraqi, kishte thirrur pranë tij Simon dhe e kishte pyetur:

— Çfarë njeriu është ky? — dhe kishte bërë me shënjë nga ana e Veraqit.

— Traktorist! — ju përgjegj Simoja i çuditur.

— Traktorist! — përsëriti i habitur shefi i kontrollit me sytë e skuqur nga zemërimi. — Pse, kështu janë traktoristët? Thua më mirë që është komedian, shoku brigadier. Njeri pa sjellje dhe pa disiplinë, — ulëriti ai.

— Është një nga traktoristët më të mirë, — tha me ton të vendosur brigadieri.

Kryetari u kthye nga dy të tjerët dhe tha:

— Në këtë brigadë disiplina është përtokë.

Por pak punë na prishte opinionin që kishte formuar ai për brigadën, kryesorja ishte të rregullonim zinxhirët, t'i shtonim dhe të fillonim nga puna.

Shefi hodhi vështrimin nga traktorët tanë dhe ngriu në vend. Një nerv i lëvizti në faqen e majtë. U bë flakë i kuq dhe ulëriti:

— Shoku brigadier!

Simoja e dëgjoji zërin e tij, dhe ju afrua pa qejf.

— Ç'janë këta? — e pyeti dhe drejtoi dorën nga e djathta.

— Traktorë, — ju përgjegj me gjakftohtësi Simoja.

Prapa tyre ishin afruar dhe dy shoqëruesit e kryetarit. Shoqëruesit kishin filluar të flitnin me njëri-tjetrin, si

të donin të vërtetonin pyetjen që i kishte bërë brigadierit tonë shefi i tyre.

— Traktorë! — ishte tallur njeriu me borsalinë në kokë. Dhe, si të ishte në humor, kishte vazhduar: — Këta janë buaj të zhytur në baltë dhe jo traktorë. Ky është shpërdorim i pasurisë së shtetit, është skandal, është shkatërrim, — ishte nxehur ai.

Na vinte rëndë që na fyente, duke i quajtur traktorët tanë buaj. Brigadieri ishte më i mërzitur se ne dhe kishte vendosur të mos ja vinte re dhe aq të sharat shefit, siç bëjmë zakonisht me ata tipa që grijnë sallatë gjithë ditën.

— Inventarin! Dua të shoh inventarin, — tha kryetari me ngulm, si ta kishte kapur sëmundja e tokës.

Simoja na thirri të gjithë fort:

— Djema, inventarin bëni gati!

E lamë punën që kishim filluar dhe nxorëm të gjitha veglat që kishim në kasetë. Vasili më tha duke folur ashtu shpejt e duke i ngrënë fjalët:

— Më jep një çekan!

— Vetëm një kam.

— Eh, more... dhe i thua vetes shok..!

E vështrova tek largohej duke rendur dhe i këputa një të sharë. Skënderi i shkurtër po vërtitej sa andej-këtej duke na penguar dhe ne. Kërkonte një levë të shkurtër, që i kishte rënë në një pus. Ishim të sigurt, se me inventarin nuk do të dilnim dhe aq mirë. Veglat i kishim humbur nëpër pusët. Kryetari, si të na e dinte pikën e dobët, kishte filluar nga inventari. Vështroja Simon. Ai ishte i qetë dhe më shkeli syrin. Veraqi i kishte nxjerrë të gjitha veglat që kishte dhe kruante kokën i menduar, si të donte të kujtonte vendin dhe ditën që kishte humbur veglat.

U rrjeshtuam me veglat përpara. Isha i fundit në rrjesht dhe vështroja me keqardhje përgun e veglave që më ngrihej para këmbëve. Nuk do të dilja mirë me inventarin dhe kisha një parandjenjë të keqe. Kostën e kisha nga e majta. Edhe ai ishte i shqetësuar si unë.

Komisioni e kishte filluar kontrollin. Ata ecnin kokulur dhe ngadalë, duke vështruar veglat që kishim për-

para këmbëve. Vështroja Skënderin e gjatë, përpara të cilit ishte ndalur komisioni. Skënderi ishte gjithë inat dhe mallëkonte në heshtje Vasilin, që e kishte lënë të parin në rrjeshtin e gjatë.

Qëndrimi i tij e kishte mërzitur dhe kryetarin e komisionit, i cili nuk i kishte folur fare Skënderit, si të ishte trembur nga pamja e egër e tij.

Pas Skënderit, radhën e kishte Veraqi. Kryetari nuk e ngriti kokën për të shikuar Veraqin, se po vështronte me imtësi veglat.

Veraqi nuk e prishi terezinë. Ndezi cingaren dhe po thithte tymin pa çarë kokën.

Kryetari u bë si tërbuar, kur vuri re ato vegla të ndryshkura që ishin përgjysmuar dhe e pyeti Veraqin me urrejtje, si të kishte përpara horrin më të madh:

— Ku i kini çekanët?

Veraqi rrinte i heshtur dhe thithte fort cingaren. Kishte vendosur të mos fliste, në qoftë se tjetri nuk do ta vështronte në fytyrë. Po kryetari ja kuptoi qëllimin dhe e vështroi në sy. Veraqi ja priti si çuditur:

— Mua më pyesni?

— Sigurisht që ju. Ku i kini çekanët? — pyeti sërish kryetari.

— A... çekanët... Si... të... them, , , në kënetë janë, Kryetari u xhindos. Thirri Simon. Brigadieri ju afrua me kartelën e veglave në duar.

— Si duhet t'i ketë veglat ky traktorist, brigadier?

— Komplet!

Kartelat nga qyteti i kishte sjellë inxhinieri që merrrej me to. Nuk e dinim që ato ishin të gjalla dhe që një ditë do të na dilnin para syve. Në kartelë figuronte që Veraqi duhej t'i kishte të gjitha veglat komplet, siç i ka një traktor i ri, të cilit posa i është hequr graso.

Veraqi shtangu dhe i shkeli syrin Simos, por brigadieri nuk kishte mundësi ta ndihmonte. Ai ngriti supet përpjetë dhe heshti.

— Hë! Tregomëni se ku i kini çekanët! — nguli këmbë

kryetari në kërkesën e tij, kur e pa që u zu ngushtë Veraqi.

— Akoma s'e kini kuptuar? Kanë humbur, i dashur... — ja plasi më në fund Veraqi pa pikën e frikës.

— Po ju çfarë jini?

— Traktorist.

— Traktorist! — përsëriti ai me tallje.

— Traktorist... çfarë të jem tjetër, balerinë? — i tha Veraqi duke ja shpague mirë talljen.

— Traktoristët si ti nuk vlejné një grosh! — tha kryetari, duke bërë përpara e duke u ndalur te veglat e Faikut.

Faiku ngriu në qëndrimin gatitu. U bë qesharak dhe buzëqeshte si leshko. Kryetarit i bëri përshtypje qëndrimi i tij, e vështroi me vëmendje dhe i vuri gishtin mbi gjoks duke na thirrur të gjithë:

— Merrni shembull të gjithë prej këtij. Ky është një traktorist shumë i mirë.

Veraqi u skuq nga inati tek e dëgjoji atë të lëvdonte pa të drejtë Faikun, dhe ja priti:

— Ai të marrë shembull prej nesh dhe jo ne prej tij.

Të gjithë mbetëm të kënaqur nga përgjegja që i dha Veraqi kryetarit të komisionit, i cili e ngriti në qiell Faikun.

Nuk pata kohë të mendoja gjatë. Komisioni u ndal para meje. Kryetari vështroi të gjithë grumbullin e veglave që kisha te këmbët dhe sytë i mbetën te hinka e shtypur. U nxeh. M'u kanos dhe më mbushi gjithë pësh-tymë:

— Ti je kriminel, që e ke katandisur deri në këtë shkallë mallin e shtetit. Kështu i mirëmbani hinkat ju? Turp!

Më erdhi shumë keq që m'u drejtua duke më folur në njëjës, kur deri para pak minutave kishte folur në shumës.

Meqë më vuri në pozitë të vështirë, e pashë të udhës ta sqaroja pse ishin bërë hinkat ashtu. Po ku merrte vesh ai! Ishte bërë si i xhindosur, dhe unë nuk e zgjata më.

— Jeni sabotatorë!

E kisha dëgjuar shpeshherë atë fjalë të neveritshme dhe më hipi gjaku në kokë. Me ç'të drejtë më quante ai ashtu?!

— Ej, ti shok, rregulloje pak atë gjuhën. Kujt i thua sabotator ti? Neve? Ne jemi klasa punëtore, dhe jo burokratë. Mate fjalën kur e nxjerr dhe mos e pre të trashë!

Brigadieri i bëri shënjë të heshtte Veraqit, po ku pyeste ai! Ishte bërë si i tërbuar; i kishte ardhur keq për mua.

Veraqi i tha Simos:

—Ti, Simo, mos më kafsho buzën! — ja nxori në shesh nojmën Veraqi.

— Si shumë po na ofendon, i dashur. Në qoftë se ke ardhur të bësh punën, bëje dhe udha e mbarë të qoftë, — i thashë unë duke marrë zemër nga guximi i Veraqit.

Kosta kërkonte të shpjegonte diçka që kishte të bënte me hinkat, por unë e shtyta atë dhe nuk e lashë të fliste.

— Të pushohen që të dy nga puna! — ulëriti kryetari duke shkumëzuar dhe ja mbathi nga maqina e tij.

20

Akoma s'e kisha mbledhur veten. Për një çast mendova nënën. Si do ta priste ajo lajmin e pushimit tim nga puna? Do të shqetësohej, e më vonë do të më falte. Kisha frikë se mos mendonte keq për mua. Do t'i shkonte mendja se kisha vjedhur, ndaj më kishin pushuar nga puna. Ky ishte shkaku që e kisha humbur toruan dhe isha bërë i zymtë. Vesin e vjedhjes nëna e urrente më shumë se gjithshka në botë. Në të tilla mendime isha zhytur, kur m'u kujtua nëna. Por ai nuk kishte të drejtë që na pushonte nga puna. Për këtë gjë do të shkonim në komitetin e partisë. Atje do të na dëgjonin deri në fund dhe do të na jepnin të drejtë. Fundja ai na kishte fyer.

M'u kujtua Veraqi, kur ishte hedhur në pus me gjithë rrobe që të shpëtonte një kasetë me vegla, dhe njeriu me borsalinë në kokë e kishte quajtur sabotator. Kjo nuk honepsej. Nuk i kishim faj kryetarit të komisionit që

nuk na njihte. Le të rrinte disa javë midis nesh dhe të shikonte me sytë e tij se si punonim dhe si e ruanim ne pasurinë e popullit.

Nuk do të na vinte keq sikur ai të na kishte hequr vërejtjen me takt dhe pa na fyer. Do të kishim pranuar në heshtje dhe kokulur, siç e kishim zakon.

— Mos bëri shaka me ne ai? — pyeti Vasili, i cili nuk u zinte besë fjalëve që kishte dëgjuar.

Vështrova Vasilin dhe qesha nën buzë. Më vinte keq që do të ikja nga brigada. Ishin të gjithë shokë të mirë dhe të dashur. Do ta kisha të vështirë pa ta, dhe nuk më bënte zemra të ndahesha prej tyre.

Veraqi pyeti Simon:

— Kur t'i dorëzoj veglat dhe traktorin?

Simoja e vështroi në sy dhe psherëtiu:

— Kush ju tha juve se jeni pushuar nga puna? Unë jam brigadieri juaj dhe unë e kam këtë të drejtë. Simoja kishte të drejtë. Ai ishte brigadieri dhe vetëm ai kishte të drejtë të merrte masa disiplinore.

— E dija që Simoja kishte shpirt guximtari, dhe më vinte plasje që nuk e kishte treguar këtë veti të mrekullueshme edhe përpara komisionit. Po Simoja ishte shumë më i përmbajtur se ne, dhe dilte gjithmonë i fituar.

Duhej të ishim treguar të përmbajtur dhe të mos e lëshonim veten deri atje, sepse ashtu rrezikonim veten dhe pozitat e Simos, që e donte aq fort brigadën. Simos ja kishin hequr kaq herë veshin në drejtori për paudhësitë tona. Faiku ishte ulur në një cep të këndit dhe na vështronte që atje me sytë që i shkëlqenin. Ai ishte i gëzuar që punët kishin arritur deri në atë pikë, sa që ne të largoheshim nga brigada. Tek vështroja fytyrën e tij të qeshur, më vinte t'i hyja me grushta.

Ajo ditë ishte e mërzitshme. Nuk më hahej bukë dhe kisha pirë shumë duhan. Gojën e kisha të hidhur. Nuk më hynte asgjë në sy. Dhoma ishte mbushur gjithë tym duhani dhe nuk flisnim, si të ishim në një shtëpi ku kishte rënë zia.

Nga jashtë thirrën Simon. Brigadieri u ngrit më këmbë dhe doli. Mbas pak, Simoja u kthye dhe na tha:

— Paska mbetur maqina e tyre në baltë.

Faiku ishte hedhur nga vendi dhe kishte shfaqur dëshirën të shkonte t'i nxirrte nga balta. Simoja e vështroi një copë herë sikur do ta përpinte të gjallë, pastaj i dha urdhër të rrinte te këndi e të mos ndihej. Ai na vështroi një herë vëngër mua dhe Veraqin dhe na dha urdhër:

— Të shkoni ju!

Veraqi teshtiu një herë dhe nuk deshi të luante nga vendi.

— Unë të shkoj tek ata!? Kurrë. Nuk shkoj ta nxjerr nga balta burokratin, jo.

As unë nuk pranova të shkoja dhe u bashkova me mendimin e Veraqit. Po brigadieri kishte vendosur që atë punë ta bënim vetëm ne të dy. Mbasi ndeshi në vështirimin tonë të vendosur, ai filloi të na bënte agjitacion dhe të na e hante kokën me të mirë.

— Si nuk më kuptuat një herë, more shokë! Tjetri ka mbetur në mes të baltës dhe kërkon ndihmë, kurse ju kujtoni të kaluarën. Nuk është e njerëzishme kjo sjellje. Pastaj lëvdoheni se ndihmoni njerëzit.

— Ne nuk jemi lavdëruar ndonjëherë.

— Diçka të tillë keni thënë.

Simoja na e dinte pikën e dobët. Ai ishte i zgjuar dhe dinte të qëllonte në shënjë.

— Po të ishte njeri tjetër, do të shkonim, — thamë ne.

— Gabuan ata, nuk na lejohet të gabojmë ne, — na u përgjegj ai.

Simoja kishte të drejtë. Ne duhej t'i ndihmonim, pa varësisht nga grindja që patëm me ata.

— Pse ju lutesh vetëm atyre, — i tha brigadierit Faiku, të cilit i qante zemra të shkonte t'i nxirrte fill vetëm.

Ne çuditësim me këmbënguljen e brigadierit. Përse kërkonte ai të shkonim pikërisht ne? Ndoshta kishte qejf të na ballafaqonte edhe një herë me komisionin. Mund të ishte dhe kjo. Simoja na vështroi dhe një herë në sy gati me lutje dhe ne pranuan më në fund të shkonim.

Rruga ishte mbushur gjithë ujë. Traktorin e ngiste Veraqi. Në mes të kabinës ishte një kavo e butë dhe e hollë. Kapërcyen urën e gjatë të ndërtuar me trarë, trarët kërcitën dhe lëvizën nga vendi nga pesha e traktorit. Maqina kishte shkarë nga ana e majtë e rrugës. Kanali, ku kishte rënë, nuk ishte i thellë. Balta ishte deri në noçën e këmbës, dhe shoferi ishte llangosur i tëri. Ai kishte bërë përpjekje që të dilte vetë, por nuk kishte mundur. Vendin e kishte pastruar dhe kishte hedhur kashtë e byk. Po me gjithë përpjekjet e shoferit, maqina nuk mundi të dilte vetë nga kanali ku ishte gremisur. Kryetari i Komisionit nuk kishte zbritur nga maqina. Ai na vështroi nga brenda maqinës dhe uli sytë me turp. Lidhëm kavon me takon e «Gazit» dhe e tërhoqëm për hunde. Traktori nuk e ndjeu fare peshën e maqinës, e tërhoqi aq lehtë, si të ishte lidhur mbrapa tij një gogël arre. E tërhoqëm maqinën deri te këthesa dhe atje e lamë. Më tutje nuk ndjehej nevoja jonë. Shoferi na falënderoi përzemërsisht dhe u nda prej nesh duke na përqaftuar. Ishte djalë i gjallë, i sjellshëm dhe punëtor. Të tjerët nuk dolën nga maqina.

U kthyem në sektor. Në dhomë ishte ndezur sherri. Faiku kishte një copë herë që po grindej me Vasilin, i cili ishte ngjirur së thirruri.

Kur u bë natë, morëm rrugën e kafenesë, për të pirë nga një gotë konjak. Nuk ishim vetëm. Me ne erdhi edhe Vasili. Tek po kalonim në rrugën e ngushtë midis shtëpive, Vasili u ndal dhe më tërhoqi nga supi duke më thënë me zë të ulët:

— Kjo është shtëpia e saj.

E vështrova Vasilin në fytyrë. Sytë i qeshnin dhe i xixëllonin.

Sa gëzim! Sofokliu u kthye përsëri në gjirin tonë. Me të dalë nga spitali dhe drejt e në punë erdhi. Ishte zgjatur dhe dukej i zbetë. Fytyra i kishte marrë një ngjyrë si ajo e cipës së qepës së Bozhigradit. Sytë i kishte të

hequr dhe të futur thellë në zgavra. Mbante erë ilaç, dhe në kurrizin e dorës i dalloheshin damarët si fije të holla ngjyrë jargavani. Ishte dobësuar, dhe rrobet i vareshin nga supet. Mbahej shumë mirë dhe ishte i qeshur në fytyrë.

Veraqi ju hodh në qafë, e puthi gjithë dashuri dhe s'po i shqitej. Unë e përqafova dhe i rashë shpatullave. Ai qeshi dhe më shtrëngoi duart fort.

U gëzua kur i thamë se traktorin e tij nuk e kishim lënë pa shfrytëzuar dhe se me të kishte punuar Kosta. Të ardhurat që delnin nga kjo punë, Kosta i kishte ndarë përgjysmë me familjen e Sofokliut.

Kosta ishte ndalur para Sofokliut si me turp. Sofokliu e kishte thirrur afër dhe e kishte përqaftuar. Kosta ishte treguar punëtor i mirë dhe e kishte mbajtur mirë traktorin. Sofokliu ishte prekur nga ndihma që i kishim dhënë në shtëpi, dhe e shoqja na kishte ngritur në qiell së lëvduari.

Veraqi dhe brigadieri kishin patur të drejtë. Traktorët fundosnin sepse i kishin zinxhirët të ngushtë. Me shtesat që u kishim vënë nuk kishin fundosur më. Kjo ishte një shpikje e madhe, që kishte leverdi dhe që na i hiqte të gjitha mundimet. Qysh atë ditë Veraqin e quajtëm filosof, por ai na u zemërua dhe nuk i folëm më ashtu.

Të gjitha këto ja treguam Sofokliut, atij i bëhej qejfi dhe qeshte me të madhe. Na kishte marrë malli për të dhe na erdhi mirë që u kthye nga spitali në punë. Ne ishim të lidhur si mishi me thuan me njeri-tjetrin. E kishim kujtuar shpesh dhe kishim ndjerë dhembje për te. Vendosëm ta digjnim një herë me rastin e kthimit të Sofokliut.

Kosta dhe Tomi, që ishin lidhur së bashku e qenë bërë vëllezër, morën shishen dhe u sulën për nga kafeneja që të blenin raki. Ata sollën edhe një kuti të madhe me konserva dhe ajo qe një meze që të lëpije gishtat. Mishi i kutisë ishte i përzier me gjalpë dhe nuk e ngrohëm në zjarr. Ndahej lehtë dhe pejzat e tij më ngjasonin me

fijet e shkrepseve. Vasili nguli këmbë të ngrohej mishi dhe, për fat të keq, gjysma e kutisë u zbras në tigan. Ishte po ai tigan që kishte lënë Sofokliu. Kur pa tiganin, atij ju ngjallën kujtimet dhe i shkëlqyen sytë.

— E keni larë sot tiganin? — na pyeti Sofokliu si dikur.

Të gjithë ja shkrepëm të qeshurit dhe kujtuam të kaluarën, kur tigani lahej vetëm një herë në muaj. Por atë ditë tigani ishte larë dhe shkëlqente si pasqyrë.

Pak më parë se të vinte Sofokliu, ishim të lodhur. Me ardhjen e tij e harruam lodhjen, ndjeheshim shumë të gëzuar dhe të lehtësuar nga shpirti.

Simoja kishte ardhur më qejf, dhe e kishte harruar dhembjen e gishtrinjve të copëtuar në spinotin e traktorit të Skënderit të shkurtër, i cili nuk ishte dukur dhe aq i gëzuar kur e kishte takuar Sofokliun. Ishte grindur me brigadierin, i cili ja kishte prerë shëtitjet e shpeshta dhe vizitat që bënte në qytet. Skënderi i shkurtër ishte prekur, që nuk do ta shihte dot shpesh gruan e tij të dashur dhe rrinte tërë hundë e buzë. Më vonë, kur Skënderi i shkurtër piu nja tri gota raki, u bë më i gjallë dhe ja mori edhe valles. Në shtëpi kishte ardhur dhe një mik i ri, drejtori i fermës. Ai kishte ardhur me kalë drejt e nga parcelat, për të na parë një herë me rastin e kthimit të Sofokliut. Kalin e kishte lënë jashtë dhe rripat e frerit i kishte lidhur në një peronë të trashë, që Veraqi e kishte mbërthyer në mur. Ju lutëm të rrinte për darkë, po ai nuk ndenji se kishte punë. Piu një gotë raki më këmbë, na përshëndeti dhe iku. Ishte burrë shumë i mirë dhe të gjithë punëtorët e donin si babain e tyre.

Ndenji sa ndenji, e, para se të largohej, u puth fort me Sofokliun, si të ishin miq të vjetër.

Më në fund, erdhi dhe shtesa tjetër e rakisë. Shishen e parë e kishim pirë, po nuk na kishte zënë vend. Kosta doli jashtë dhe na solli një tufë presh, që i kishte shkullur nga dheu. Preshtë ishin të bardhë dhe akull të ftohtë. Rakinë e pinim me gllënjka. Kostës i shkëlqenin sytë. Ishte i gëzuar që kishte gjetur presh dhe i priste me miratim të gjitha urimet që i jepnim.

E ngrija grykën e shishes dhe rakia më shkiste në gurmaz si zhivë. Ajo më ngrohte gurmazin dhe gjoksin. Pastaj shishen ja kaloja shokut që kisha pranë dhe këputja me dhëmbë kokën e preshit të shijshëm e të ëmbël.

U ndanë copat e bukës dhe mbi to u vunë edhe copat e mishit të ngrohur. Ngrija një doli për shëndetin e Sofokliut dhe të gjithë e pimë me fund. Më vonë, kur u nxehtë mirë, ja thirrëm këngës dhe darkën e kthyem në një festë të vërtetë.

Punëtorët e fermës, kur dëgjuan këngët tona, u sulën nga kinoklubi me shpresë se mos kishte ardhur ndonjë grup artistik nga qyteti.

Veraqi filloi të bënte numra. E kishte zënë rakia dhe kërkonte t'i jepnim lejë që të recitonte disa poezi. Vasili, dhe ai i katandisur ca më keq se Veraqi, kishte kohë që po na çante veshët me ato këngët e operave.

Pastaj ngritëm doli për brigadën, për brigadierin, për traktorët. Vasili u kujtua për Stillon dhe ngrija doli edhe për atë. Të gjithë e pimë me qejf të madh dollinë për Stillon. Kushedi se ku do të ishte tani ai. Me siguri në brigadën e tij, duke bërë qyfyre dhe duke treguar anekdota. I prapë ishte Stilloja. Nuk i linte traktoristët e tij të mërzhiteshin. Veraqi na mërzhiti me dëshirën e tij për të recituar. I dhamë lejë që të recitonte.

Mezi morëm raki tjetër, sepse klubi po mbyllej. Brigadierit ju zgjidh gjuha dhe filloi të na këndoje këngë të vjetra dashurie. Mbas pak, ai u pendua si duket, u bë serioz dhe e pushoi këngën. Veraqi lëshoi një nga ato shakatë e tij dhe të gjithë ja shkrepën të qeshurit. Nuk e di pse Simoja e preu këngën dhe pse ra ashtu papritur në letargji.

Ajo ishte një darkë gjithë gjallëri dhe nuk ishte koha për të filozofuar. Simoja, që donte të tallej me mendimet e mia, ja thirri përsëri këngës më fort dhe më me zjarr se radhën e parë. Të gjithë e pasuam, dhe kënga u ngrit lart si në kor.

Ky ishte një gëzim i rastit. Zakonisht të tilla darka janë tërë humor. Pastaj, ajo ditë ishte e gëzueshme jo ve-

tëm se ishte kthyer Sofokliu, por edhe sepse puna na kishte shkuar shumë mirë dhe kishim bërë nga dy norma bashkë. Përveç traktorit të Vasilit, që pati defekt në diferencial, gjithshka kishte shkuar si sahat.

Natën ramë të flemë.

22

Lajmi na erdhi papritur. E gjithë brigada duhej të nisej urgjent për në qytet. Ky urdhër na tronditi të gjithë. Përse të shkonim në qytet? Përse na kërkonin? Ndoshta kishte shkuar në drejtori kryetari i komisionit të kontrollit dhe e kishte bërë të madhe.

Simoja nuk i zinte besë urdhërit, dhe psherëtiu gjatë. Ku djallin ishim grindur me atë njeri, që e kishte alarmuar punën. Në qoftë se lajmërimi kishte të bënte me sherrin, që kishim bërë ne me atë, në qytet duhej të shkonim unë dhe Veraqi dhe jo e gjithë brigada! Nuk u gjenim dot përgjegje pyetjeve që bënim me vete dhe vetëm një gjë kishim të qartë: brigada duhej të nisej urgjent për në qytet.

Lamë traktorët në fushën e vogël që kishim përpara shtëpisë, mbasi i vumë në rrjesht. Patëm fat. Atë ditë deri në fermë kishte ardhur me mundime të mëdha një makinë «Skoda» e re me një shofer të ri. Maqina sapo ishte shkarkuar dhe shoferi, një djalosh i bëshëm me beretë në kokë, u tregua shpirt njeriu. Simoja ja tregoi të gjithë punën dhe ai nuk bëri naze. Na mori.

Rrugës, anëve të kanalit ishin mbjellë plepa. Ata ishin të vegjël dhe lëkurën e kishin në ngjyrë të hirit, siç ishte qielli atë ditë.

Të gjithë ishim të mërztitur, përveç Skënderit të shkurtër, të cilit i qeshte fytyra, se do të vente tek e shoqja. Edhe Faikut i qeshnin sytë gjithë kënaqësi, sikur ta dinte sekretin pse na kishin thirrur në qytet. Edhe një shaka e hedhur bukur nga Sofokliu nuk pati sukses. Ishte udhëtim i mërztishëm ai dhe pa fjalë. Një «udhëtim i vdekur», siç shprehej zakonisht Veraqi për të tilla udhëtime.

Simoja kishte hipur përpara me gjithë Skënderin e gjatë. I kishin thënë dhe Sofokliut të hipte përpara, po ai s'kishte pranuar dhe kishte hipur në karrocerinë e ftohtë, megjithëqë nuk kishte shumë kohë që kishte dalë nga spitali.

Plepat dridheshin nga era që kishte filluar të frynte. Së bashku me plepat dridheshin dhe nofullat tona e na kërcitnin dhëmbët. Vasili lëshoi një të sharë, por atë e mori era.

Veraqi nisi të zbulonte mushamanë e palosur që ishte hedhur në karroceri, po kur kujtuam shoferin buçko, që na kishte marrë e hipur në maqinë pa naze, na erdhi turp ta shpalosnim. Pikërisht kur po merreshim me hapjen e mushamasë, maqina u ndal në vend dhe ne e lëshuam mushamanë. Shoferi zgjati kokën nga xhami i tij dhe na thirri:

— Po të keni të ftohët, hapeni mushamanë! E keni në qoshe të karrocërisë.

Nuk dinim se si ta falënderonim. E hapëm mushamanë. Ajo ishte e re dhe mbante erë bërsi të farave të pambukut.

Na dukej sikur na kishte marrë nata në krahët e saj. Nga një vrimë që ishte hapur në mushama u dha një fije drite. Megjithëse të kredhur në errësi, nën mushama ishim ngrohtë.

Po i afroheshim qytetit. Veraqi më pat vështruar një herë para se të mbuloheshim me mushama, si ta kishte marrë vesh se tërë ai udhëtim bëhej vetëm për ne të dy. Sido që të ishte puna, ne tashmë ishim nisur dhe le të dilte ku të dilte.

Maqinën tonë e ndali kontrolli dhe ne e hoqëm mushamanë. Kontrolli ishte një burrë i ngjallur gjithë shëndet, me faqe të kuqe si shegë. Ai na vështroi të gjithë me rradhë dhe nuk i tha gjë shoferit. Mbas pak mbërritëm. E falënderuam të gjithë shoferin dhe ai na përshëndeti duke ngritur grushtin lart si partizanët.

Në ndërtesën e SMT-ës kishte gjallëri. Në të ishin mbledhur të gjithë traktoristët e ndërmarrjes. Në mes

tyre, përpara derës, takuam Stillon. Tek vështroja gjithë ata njerëz që ishin mbledhur atje, nuk më vinte mirë që kisha ardhur me këmbët e mia për t'u demaskuar nga shefi i kontrollit. Ku djallin isha grindur me atë dhe e kisha lënë veten derisa të ziheshim! Po ai i kishte fajet, dhe bëja gabim që mendoja ashtu. Duhej të isha i vendosur në atë që kisha bërë dhe të ngrihesha e ta demaskoja deri në fund për veprimet e tij prej burokrati dhe kapadaiu. Stilloja u takua me ngrohtësi me Simon dhe e mori vesh grindjen tonë. Ju bë qejfi që i kishim treguar vendin atij mendjemadhi dhe burokrati dhe na tha të mos kishim aspak frikë, sepse ai i kishte fajet. Stilloja diçka do të dinte, prandaj tregohej dhe i dashur e i afruar me të gjithë ne. Kjo na lehtësoi dhe ne e morëm veten mirë.

Mbas pak, nga salla doli drejtori së bashku me sekretarin e partisë. Me të na parë ne, erdhën me hapa të shpejta dhe na përqaftuan të gjithë. Kjo sjellje ishte e paparashikuar prej nesh dhe na bëri të shtangeshim të gjithë. Drejtori dhe sekretari i partisë e kishin fytyrën të qeshur, silleshin mirë dhe na binin lehtë shpatullave. Më vonë morëm vesh shkakun e gjithë kësaj mikpritje. Na futën në këndin e kuq të ndërmarrjes, që ishte zbukuruar si jo më mirë. Salla gumëzhinte nga zërat e traktoristëve, që e kishin mbushur plot e përplot.

Në sallë erdhi edhe sekretari i parë i komitetit të partisë të rrethit. Ai ishte një burrë rreth të dyzet e pesave, i qeshur dhe i veshur me rrobe ushtarake. Kishte vënë një kapele me strehë dhe mbante në duar një çantë ushtarake marshimi. Ishte i qeshur dhe të bënte për vete me atë buzëqeshjen e tij të ëmbël dhe të çiltër.

Kur filloi mbledhja, ne ishim ulur në rrjeshtat e para dhe e morëm vesh të gjithë të vërtetën. Po na dekoronin për kapjen e diversantëve. Në gjoks na vunë të gjithëve medalje dhe na puthën. Isha i gëzuar dhe zemra më rrihte aq shpejt, sa sikur do të më fluturonte nga gjoksi. Më vinte mirë që Veraqi kishte medalje të njëllajtë me mua. Kjo tregonte se të dy ishim njëllajtë. Të gjithë dëshironim të ishim njëllajtë, prandaj dhe dukeshim njëllajtë të gjithë.

Sofokliun, mua dhe Veraqin na dekoruan me Urdhërin e Trimërisë të Klasit të Parë. Kjo ishte një gjë e papritur dhe na bëri si të hutuar. Kosta dhe Tomi kishin marrë Medaljen e Trimërisë. Simoja ishte dekoruar me Urdhërin e Punës të Klasit të Parë, dhe kur u ngjit në tribunë për të marrë medaljen, duartrokita duke i përplasar aq shumë duart, sa më dhembën. Ishim të emocionuar dhe e ndjeva veten keq mbas gjithë atyre urimeve që më bënë shokët. Çfarë t'ua thoja atyre, si t'ua shpërbleja gjithë ato urime?

Sofokliu u ngjit në tribunë dhe, duke ngrënë fjalët, mbajti një fjalim prekës, që e bëri sallën të binte në qetësi. Kur mbaroi së foluri Sofokliu, sekretari e puthi dhe i ra në sup. Sofokliu i kishte sytë të mbushur, mezi po i mbante lotët. Dhe bëri shumë mirë që i mbajti lotët, se përndryshe do të na kishte turpëruar të gjithë.

Veraqi kërkoi lejë për të folur. Ai u ngjit në tribunë serbes-serbes dhe foli ngadalë, qartë dhe me kuptim. E tundi fare. Gjithë salla u ngrit më këmbë duke brohoritur për shokun Enver dhe për Partinë e Punës.

Stilloja ishte prekur dhe qante me lot. Ai e kishte mbërthyer Simon për qafe dhe nuk e lëshonte. Neve na erdhi keq për brigadierin, që mezi i mbante lotët, ngaqë shihte dhe Stillon që po qante nga gëzimi.

Ajo ishte dita më e lumtur e jetës sime. Tomit i qenë skuqur veshët dhe ishte mjaft i lumtur. Nga gëzimi e kishim humbur fare. Nuk dinim nga të venim dhe çfarë të bënim. Drejtorja i kishte marrë të gjitha masat dhe kjo na gëzoi së tepërmi. Të gjithë në grup shkuam në pallatin e kulturës. Në hyrje të pallatit ishte një grup njerëzish. Ata ishin mbledhur atje nga tingujt e bandës, që kishte gati dhjetë minuta që binte. Dirigjent i bandës ishte një burrë i moshuar, të cilit i qenë skuqur faqet nga të ftohtët. Ai e ngrinte krahun lart dhe hapte e mbyllte grushtin, si të donte të kapte diçka, duke lëvizur dorën sa andej-këtej.

Në shkallët e pallatit ndaleshin njerëz dhe pyesnin të çuditur:

— Ç'janë këta, delegacion?

— Është SMT-ja. Ka mbrëmjen e fushatës së korrjeve, — ja kishte kthyer kot një djalosh, djalli vetë, me flokë të verdha. E vështrova me vëmendje djaloshin. Ai më nxori gjuhën dhe u zhduk nga grupi.

Te shkallët na priste dhe na drejtoi për në sallën lart vetë drejtori i pallatit. Ishte një burrë i qeshur dhe dinte të sillej me ne. Gjatë gjithë shkallëve kishte një mori pasqyrash, që më vranë sytë me shkëlqimin e tyre. Salla, ku ishte shtruar banketi, ishte e gjatë dhe me parket. Në tavanin e bardhë dhe të gjatë ishin varur abazhurë të mëdhenj në formën e qirinjve. Në mes të sallës ishte shtruar një tryezë e gjatë. Mbi të ishte hedhur një çarçaf i bardhë dhe mbi çarçafin ishin shtruar të gjitha të mirat. Kamerierët na rrinin në kokë dhe ky ishte një nder i madh për ne. Tek rrija në tryezë, në mes të shokëve, e ndjeja veten të lumtur.

Në darkë na erdhi përsëri sekretari i partisë. Ai ishte një burrë i shkëlqyer dhe dinte t'i hidhte bukur romuzet. Pa le sa bukur që e hiqte «devolliçen». Ta vështroje, mbe-teshe i mahnitur. Kishte nxjerrë një shamⁱ nga xhepi dhe na ftoi të gjithë në valle. E hidhte gjithë bukur i këmbën e djathtë dhe bënte një rrotullim të plotë. Të gjitha lëvizjet i bënte me një gjallëri, që të linte gojëhapur. Ngrihej lart e përmbliidhte këmbën e majtë të thyer në gju dhe e lëshonte pastaj në parket, thua se ra e u rrëzua, kur hop hidhej përpjetë i lehtë si pendë. Në fund qeshi dhe e la vallen i bërë qull në djersë, sepse e kishte luajtur me gjithë shpirt e zemër. Piu një gotë birrë dhe na kërkoi ndjesë që po na linte vetëm. Ne ju lutëm, dhe ai nuk na e prishi. Qëndroi dhe ja mori një kënge. Zërin e kishte të hollë dhe të ëmbël. Vargjet e këngës ishin të reja, sapo i kish krijuar. Ja priti Skënderi i shkurtër. Ai e ngrinte qafën dhe i mëshonte zërit me tërë fuqinë. I fryheshin damarët e qafës, si të ngrinte zinxhirët e rëndë të traktorit.

Sekretari i partisë nuk mund të rrinte më gjatë. E përqaftuam, u ndamë gjithë gaz, përplasëm duart kur e përcollëm dhe u kthyem në sallë.

Gëzimi i përgjithshëm sikur u tulli me largimin e

tij, por pastaj mori zjarr përsëri dhe kaloi gjithshka shumë mirë, gjer natën vonë kur u mbyll mbrëmja.

Jashtë, në rrugë, kishte rënë një vesë shi dhe bulevardi i qetë shkëlqente nga dritat. Rruga, gjer atëherë e qetë, zjeu nga zhurma me të dalë ne jashtë. Skënderi i shkurtër vazhdonte këngën, që e kishte filluar që lart dhe nuk dëgjonte me asnjë mënyrë që të pushonte. Ishte njeri i çuditshëm Skënderi i shkurtër. Po të fillonte një këngë, nuk dihej se kur e mbaronte. E kishte këtë mani. Por ishte vonë dhe e pamë që bënim shumë zhurmë për njerëzit që kishin rënë të flinin.

U ndava nga Veraqi pasi i dhashë një cingare. U puthëm, sikur nuk do të shiheshim më dhe morëm secili rrugën për në shtëpi, duke u penguar nëpër gurët e kall-drëmit.

Nëna më çeli portën me habi dhe frikë. Nuk më priste, dhe u shtang kur më pa. Erdhi pas meje me hapa të ngadalshme. Në dhomë ishte ndezur drita. Më vështroi medaljen që kisha në gjoks dhe stepi në vend. Pastaj m'u afrua ngadalë dhe më pa në sy.

— Më dekoruan, nënë, — i thashë dhe i tregova medaljen.

Ajo më hodhi duart në qafë, m'u qep pas trupit dhe supet filluan t'i dridhen...

23

Pranvera erdhi shpejt. Plepat filluan të fëshfërinin me fletët e tyre të vogla ngjyrë vaji, dhe nga lëkura nisi t'u kullojë si rëshirë lëngu i përtëritjes. Bisqet e buta si kadife shpërthenin gjithë gjallëri dhe kudo kishte gjelbërim. Përrenjtë gurgullonin me zhurmë, dhe në qiellin e pastër e të kaltër ngriheshin gjithë gëzim zogjtë çamarrokë.

Në kënetën e thatë erdhën lejlekët. U vërtitën një copë herë rreth e rrotull dhe u larguan, si të ishin bindur që kishin gabuar drejtimin. Si duket, shpendët e gJORË nuk

ishin në gjendje të dallonin fushat, kodrat dhe kënetat e transformuara. Në çdo kthim ato habiteshin dhe e humbisnin toruan nga ndryshimet e mëdha që pësonte vendi ynë.

Vasili ishte i lumtur dhe i kishte rregulluar disi marrëdhënjet me Shkëlqimen e tij. Megjithatë, ai gjithmonë mendjen e kishte te furra dhe tek ajo. Me shkak, pa shkak, Vasili do ta vizitonte furrën.

Tomi ishte ngritur shpejt dhe kishte parë kafshët e ngarkuara të kooperativës që kishin sjellë farën. Skënderi i gjatë ishte i kënaqur nga ndihmësi i tij. Tomi tani ishte djalë i gjallë, punëtor dhe e kishte mësuar zanatin. Nuk ishte më ai djaloshi i turpshëm. Edhe tek ai, si të kishte zbritur pranvera dhe të kishte lëshuar gjallërinë e saj, kishin ndodhur ndryshime të habitshme. Ishte djalë i edukuar dhe na tregonte shpesh ngjarje nga jeta e shkencëtarëve. Dinte aq shumë gjëra nga jeta e popujve, sa ne mbeteshim gojëhapur para tij. Sofokliu i kishte besuar leximin e gazetës, dhe Tomi e kryente këtë detyrë me korrektesë dhe kujdes të rrallë. Skënderi, kishte tani një ndihmës të mirë dhe të zot dhe për këtë e kishin zili të gjithë.

Pranvera e re po na gjente me fitore dhe suksese të reja. Kafshët e ngarkuara dhe të djersitura ndaleshin para shtëpisë sonë. Ishin ditët e ethshme të mbjelljeve të pranverës. Ishim të zënë me punë deri në grykë dhe nuk kishim nge për asgjë.

Fshatarët me bollkat e leshta dhe me ballin gjithë djersë shkarkonin thasët e rëndë të mbushur deri në grykë, pastaj i hiqnin mënjanë kafshët e lehtësuara nga barra.

Traktorët ishin ndezur me kohë dhe slitat e mëdha ishin kapur pas tyre.

Shpikja, që kishte propozuar Veraqi dhe Simoja (të shtuarit e zinxhirëve) na kishte shpëtuar nga hallet, dhe puna na shkonte sahat. Falënderonim me vete të gjithë punëtorët e oficinës që na i kishin pregatitur shumë shpejt copat e zinxhirëve.

Fshatarët ngarkonin farën në slitë dhe hipnin mbi të duke fshirë djersët. Ishin të kënaqur dhe dridhnin cingare

mbi thasët e farës. Disa prej tyre shpalosnin dhe shamitë që kishin lidhur në qafë dhe fshinin djersët, ca të tjerë hapnin torbat dhe ja thonin drekës. Kështu vazhdonte gjithë dita. Megjithëse plot punë, ajo ishte e bukur dhe kalonte shpejt.

Gjithë këtë kënaqësi të ditës së bukur na e prishi Faiku, që u zu duke vjedhur.

Ai kishte marrë traktorin e tij me gjithë slitën e ngarkuar me elb dhe po shkonte drejt parcelës, tek e prisnin fshatarët. Rrugës e kishte ndaluar traktorin dhe, si kishte zbritur prej tij, kishte hedhur vështrimin rreth e rrotull për të parë se mos kishte njeri. Tomi, që ishte ulur në një kanal për nevojat e tij, e kishte parë Faikun se si e kishte hedhur thesin e mbushur me farë elbi, se si e kishte fshehur atë në mes të plisave të parcelës dhe ishte larguar. Më vonë Tomi e kishte marrë thesin dhe e kishte sjellë përpara Simos.

Brigadieri u zverdh nga turpi. Skënderi i gjatë ndizte dhe shuante cingaret, ndërsa Veraqi pështynte i nevrikosur.

Faiku u kthye i qetë dhe, kur e akuzuan për vjedhje, luante lojën e «shejtanit qorr».

— I kujt është ky thes? — e pyeti Simoja.

— Thesi...!? Ku ta di unë!

— Ti e ke vjedhur atë!

— Unë! «Për Ideal» e keni gabim... — ja ktheu ai pa pikë turpi.

— Ti e ke vjedhur atë, Faik. Të kanë parë kur e ke fshehur në mes të parcelës me plisa.

Faiku u zbraps pak. Nuk i shkonte mendja që mund ta kishte parë njeri.

— Për ideal, që do t'më ketë rënë nga slita, — filloi të tundte vithet Faiku.

— Mos e zërë fjalën «për ideal», — i foli gjithë inat Sofokliu.

Tomi, që kishte heshtur, nuk mundi të duronte shpifjet dhe gënjeshtren e Faikut dhe u ngrit me guxim;

— Ndëgjoni shokë. E kam parë vetë me këta dy sy.

Faiku e ndaloi traktorin dhe zbriti prej tij. Vështroi një herë rreth e rrotull dhe, si u bind që nuk kishte njeri, e mori thesin nga slita dhe e fshehu në mes të parcelës, duke e mbuluar me plisa. Kur mbaroi nga e gjithë kjo punë, hipi në traktor dhe ja shkeli për të shkuar në parcelën tek e prisnin fshatarët. Kjo është e gjithë e vërteta.

Ne të gjithë vështruam Faikun. Ai rrinte kokulur dhe nuk fliste. Për ne gjithshka ishte e qartë. Faiku na kishte hedhur një njollë turpi të gjithëve dhe as që e pranonte fajin. E kishte mbushur kupën dhe nuk shkohej më tej.

— Ky është maskarallëk! — foli Skënderi i gjatë.

— Na turpëroi dhe ne! — shtoi Sofokliu.

— Të ikë nga brigada e jonë! — bërtiti Skënderi i shkurtër, që dridhej nga inati.

— Turp për të gjithë brigadën! — psherëtiu duke ngrietur supet Vasili.

— Sikur t'ja falim dhe këtë rradhë, — u hodh Veraqi papandehur.

Të gjithë prisnim se çfarë do të thosh Simoja. Kishte rënë një heshtje e rëndë. Simoja e kishte të vështirë të vendoste. Ai kishte ulur kokën poshtë dhe ishte zhytur në mendime. Me majën e çizmes ai po kruante tokën, si të donte të zbulonte prej andej vendimin që duhej të jepte.

— Dorëzoje traktorin! — foli më në fund, duke marrë frymë thellë.

Faiku u drodh. Pastaj bëri një hap nga ne duke na vështruar të gjithë në sy.

— Jo! Pse ta dorëzosh? Nuk kam bërë gjë. Më tregoni fakte, duhen fakte që të dorëzosh traktorin. Një student i qelbur jua ka bërë mendjen dhallë dhe ju e besoni. Nuk dorëzosh...

— Dorëzoje traktorin, pa fjalë! — foli ftohët Simoja, por i vendosur në atë që tha.

Atëherë Faiku ju drejtua Tomit, që rrinte i qetë dhe e kërcënoi me grusht dhe e mbërtheu për gryke. Tomi u

tregua gjakftohët. Nuk u tremb dhe nuk luajti nga vendi. Ai e vështronte tjetrin duke qeshur, si të donte të tregonte dobësinë që kishte tjetri.

Faiku ngriti dorën ta qëllonte Tomin, por nuk mundi. Ishte dora e fuqishme e Veraqit, që e kapi pëllëmbën e Faikut në fluturim. Veraqi e mbërtheu fort atë dorë dhe nuk e lëshoi. Të gjithë ju lëshuam dhe e mbërthyem Faikun, që shkumëzonte nga inati. Pastaj Faiku ju drejtua Simos:

— Kush je ti, që kërkon të më marrësh traktorin? Një copë brigadier, një loço, një hajvan, ja kush je ti.

Tek dëgjonim të gjithë atë lumë të sharash, që i drejtohej brigadierit, nuk duruam, ishim gati t'i jepnim një mësime të mirë Faikut, po na ndaloi Simoja. Ai ishte zverdhur në fytyrë dhe na doli përpara duke ngritur dorën lart.

— Mos e prekni me dorë! — na urdhëroi.

Faiku u tërhoq nga ne dhe hyri në dhomë i bërë tym. U ula në thesin e vjedhur dhe ndeza një cingare. E thithja tymin dhe e nxirrja me forcë nga mushkëritë.

— Mos e tepruam? — tha Veraqi pas një heshtje të gjatë.

— Le të vejë mend — u përgjegj Simoja i menduar, — pa këtu jemi.

24

Traktorin e Faikut e mori Kosta. Kjo gjë më gëzoi dhe i urova punë të mbarë. Kosta, kur u nda prej meje, mbushi sytë me lot dhe m'u hodh në qafë. U puthëm si dy vëllezër. Më vinte edhe keq edhe mirë që Kosta po ndahej prej meje. Më vinte mirë që ai ishte bërë i pavarur, dhe më vinte keq që po më linte vetëm. Kosta ishte djalë xhevahir dhe mungesën e tij do ta ndjeja shumë.

— Të falemnderit për të gjitha, usta! — më tha Kosta, duke më vështruar në sy.

— Mos më falëndero kot, nuk kam bërë ndonjë punë kushedi se çfarë, detyrën kam bërë, — ja prita unë.

Më kujtohet këmbëngulja dhe heroizmi që kishte treguar Kosta në nxjerrjen e traktorëve. Ishte djalë i gjallë dhe i mirë. Kosta kishte marrë traktorin e Faikut dhe i kishte bërë një pastrim rrënjësor. E kishte fshirë të gjithë dhe i kishte pastruar të gjitha veglat për një.

Kishte filluar vapa. Kallamat dhe bari në kënetë ishin tharë e zhuritur. Ato kërcitnin nën zinxhirët e traktorëve dhe ta mbushnin fytyrën me pluhurin e tyre. Ishte i mërzitshëm pluhuri i kallamave. Ai na zinte frymën. Plugu çante tokën e zezë dhe e kthente në plisa të zinj, që fillonin të avullonin si të kishin dalë nga furra.

Më kishin thënë se së shpejti do të më vinte ndihmësi i ri. Ai ishte një djalë bostanxhiu, për të nuk dija më shumë se kaq. Tomi ishte bërë traktorist i vërtetë, dhe Skënderi i gjatë kishte kohë të çlodhej sa të donte. Të kisha dhe unë fatin e tij e të më vinte një djalë si Tomi, do të shkonim mirë së bashku dhe do ta ndihmoja me sa të kisha mundësi, që ta mësonte zanatin sa më shpejt.

Punonim me Tomin afër njëri-tjetrit dhe e vështroja se sa mirë e mbante anën e parcelës dhe sa bukur e drejtonte traktorin. Nuk e sforconte dhe e mbante pastër. Gjithmonë e kisha vënë re që e grasatonte dhe, qëkurse kishte ardhur Tomi, traktori i tyre rrallë pësonte defekte. Më ishte çarë hunda për një cingare. I fola Skënderit të gjatë dhe i kërkova të më jepte pak Tomin, që të më zëvendësonte sa të pija një duhan. Tomi erdhi, dhe Skënderi e mori vetë traktorin e tij. Nuk e kisha thithur as tri herë cingaren, kur traktorin e Skënderit e mbuluan flakët. Mori zjarr. Flaka cingaren dhe u sula drejt tij. Traktori u ndal dhe Skënderi i gjatë u hodh me të shpejtë prej tij. Kush me plisa dheu, kush me zhaketën e tij, kush me ndonjë batanie u munduam të shuanim zjarrin që kishte mbuluar traktorin e Skënderit. Tomi erdhi sakaq midis nesh, hoqi shpejt xhaketën dhe u hodh me guxim mbi kolektorin, që ishte vatra e zjarrit. Flaka u shua dhe zjarri mori fund. Tomit i qenë përcëlluar vetullat, por

me aq kishte shpëtuar shumë mirë. Torfa e qullur na kishte ndihmuar së tepërmi dhe heqja e kofonos nga Veraqi e kishte lehtësuar shumë shuarjen e zjarrit. Ishte me fat Skënderi. U ndodhëm të gjithë afër dhe mundëm ta shuanim zjarrin. Skënderi i gjatë ishte nxirë në fytyrë dhe, duke u dridhur, na tha:

— Mua më zë plumbi gjithmonë!

Qeshëm me fjalët e tij dhe i ramë në sup, duke i uruar jetë të gjatë.

— Shpëtove mirë, — i tha Skënderi i shkurtër adashit të tij, duke u fryrë duarve që i ishin përcëlluar.

— Do të ishe djegur brenda si miu, — e shpoi atë Vasili.

Veraqi, që vinte para tij, i tha Skënderit të gjatë:

— Mos e dëgjo Vasilin, qoftë e shkuar — dhe, si u drejtua nga Skënderi i shkurtër, i tha: — Ti, Skënder, po të ishe djegur, nuk do të të njihte gruaaja, sepse do të ishe katandisur kaq, sa një foshnjë tre muajshe.

Skënderi rrëmbeu një plis të madh dhe unë u fsheha, se se kisha frikë mos më qëllonte mua. Veraqi u fsheh prapa kofonos të traktorit, që e kishte marrë në duar si mburojë. Ashtu i armatosur, ai kishte dalë para Skënderit të shkurtër, që e ndillte dhe e nxehte duke i nxjerrë gjuhën jashtë. Skënderi i shkurtër, me poplën e dheut në duar, i lutej Veraqit që t'i kërkonte ndjesë:

— Ku të shkon mendja, horr, thuaj qoftë larg! — dhe Skënderi herë e ngrinte poplën e dheut, herë e ulte, derisa e flaku tutje më në fund dhe u përçafua me Veraqin, që kishte pranuar paqen.


Dola nga mbrapa traktorit ku isha fshehur dhe vësh-trova Veraqin, që ishte përçafuar me Skënderin e shkurtër dhe vërtitëshin bashkë nëpër kallamat e thatë rungull-cungull. Skënderit i ishin skuqur lllapat e veshëve duke u fërkuar nëpër kallamat. I ngritëm dhe filluam të gudu-lisim njeri-tjetrin. Ashtu, duke qeshur e duke pickuar njëri-tjetrin, mbërritëm në pusin që ishte afër vendit ku punonim. Pusi ishte rrethuar me lule shpate dhe me

kallama të gjelbër. Një tufë bretkocash pushuan të kua-kurit të trembura nga hapat tona dhe u hodhën me vrull në ujë. Dukej sikur bretkocat merrnin pjesë në kampionatin e notit, sepse u hodhën në ujë të gjitha në një kohë, si të bënin garë. Pimë ujë dhe filluam të lagnim njëri-tjetrin. Uji i pusit ishte i gjelbër dhe i vakët. Megjithatë, tek e pinim, ndjenim kënaqësi dhe çlodhje. Kishte raste që shakaja trashej dhe gjithë pusi gjumëzhinte nga zërat tanë. Por sot, me gjithëqë e kishim lagur shumë njeri-tjetrin, shakaja nuk e kishte kaluar cakun dhe çdo gjë kishte shkuar për bukuri.

Luanim dhe mendjen e kishim te traktorët, që lëronin tutje nesh. Ishte e keqe vapa dhe kallamat e thatë, që thërmoheshin nga zinxhiri, bëheshin pluhur dhe grumbulloheshin të gjithë në kolektorin e skuqur, ku ndize-shin menjëherë, siç i kishte ndodhur Skënderit të gjatë. Duhej të zëvendësonim shokët që na kishin zëvendësuar. Tek kaloja për të marrë traktorin nga Kosta, që po punonte, m'u kujtua fytyra e Skënderit të gjatë që ishte skuqur. Njeri i çuditshëm Skënderi! Skuqej e merrte flakë nga shakatë kaq shpejt, sa kishim filluar ta quanim «lafsha e kuqe e këndezi». Kështu kishte ndodhur edhe kur i kishte marrë flakë traktori. Ishte skuqur dhe bërtiste. Mezi i punonin duart nga zemërimi dhe ishte hutuar. Por traktori shpëtoi dhe ai u qetësua. Vetëm atëherë Skënderi u bind se shoqëria është një mbështetje e madhe, ku çdo njeri e ndjen veten të barabartë, të sigurtë dhe të kënaqur.

Kur i pa shokët, të cilët u kërlëshën me flakët e zjarrit, i erdhi plasje që kishte menduar keq për ata dhe që nuk i kishte dëgjuar më përpara, kur i kishin folur për të mirën e tij. Tani dukej i mallëngjyer, i dashur dhe s'dinte ç'të bënte për të na treguar se edhe ai e meritonte plotësisht tani dashurinë tonë.

Nata ishte e freskët dhe e kthjellët. Në qiell e në tokë nuk pipëtinte asgjë. Qetësinë e natës e prishte vetëm skapamentoja e traktorit që punonte. Këneta natën ishte e bukur dhe madhështore. Më dukej sikur çaja errë-sirën, që shtrihej pa fund para meje.



Më tutje shkëlqenin dritat e traktorëve të tjerë. Shokët më jepnin shënjë me anën e dritareve dhe unë u përgjigjesha: «Çdo gjë në rregull». Nata ishte më e leverdishme për punë. Ngaqë ishte ftohët dhe binte brymë, pluhuri nuk ngrihej dhe puna ishte më pak rrezik. Jo vetëm kaq. Natën s'kishe si merreshe me qyfyre, të cilat sadopak e pengonin punën. Prandaj na pëlqente nata, se punonim më shumë. Ishte koha e fushatave dhe nuk duhej të humbisnim kohë.

Vasili e kishte qullur të gjithë punën dhe na kishte futur të gjithë në sherr me punëtorët e fermës. Ja se ç'kishte ndodhur:

— Vasili e kishte takuar Shkëlqimen atë mbrëmje kur kishte lënë dhe punën. Vajza, sipas marrëveshjes që kishte bërë, e kishte pritur Vasilin afër stallave të lopëve. Ishte errësirë dhe që të dyve nuk ua priste mendja se andej nga ishin ata do të shkonte njeri. Dhe kishin patur të drejtë. Në orët e vona të natës nuk kishte as edhe një arësye që të kalonte njeri andej. Vasilit i rrahu zemra si kurrë ndonjëherë dhe ju mbajt fryma. Nuk e kuptoi se nga i erdhi gjithë ajo dobësi, që e bëri t'i buçitnin veshët. Për një çast mendoi se do të ishte i sëmurë, sepse dhe gjunjët po i dridheshin. Koka i ziente, dhe pështyma i ishte tharë në fyt. E shpejtë si një hije, vajza erdhi te vendi dhe u ndal para tij duke marrë frymë me zor. Vasili nuk i foli dhe shtangu para saj si një copë dru. Të paktën t'i kishte thënë «mirëmbrëma» dhe t'i kishte zgjatur dorën. Por ai heshti, nuk ju hap goja, si ta kishin goditur në kokë. Vajza u tregua më e guximshme, gjë që i kishte bërë përshtypje Vasilit.

— Mirëmbrëma! — tha ajo duke buzëqeshur. Vasili e humbi toruan dhe nuk u përgjegj.

Duke më treguar takimin që kishte patur me vajzën, Vasili ja këputi një të sharë vetëvetes:

— Çfarë lloshi që u tregova, hë? Ajo më foli, kurse unë ndenja si duduk përpara saj.

Në fillim nuk desha të dëgjoja asgjë prej tij. Më dukej se duke vepruar kështu, Vasili do të tregohej më i kujdesshëm në marrëdhënjet me vajzën. Por isha gabuar që kisha menduar ashtu. Vasili më kërcënoi që ta dëgjoja dhe nuk më la të flija gjithë natën, sepse kërkonte këshilla nga unë. Me kërcënimin e tij ai ja arriti qëllimit. Unë e dija se ç'do të thoshte zemër e dashuruar dhe çfarë sakrificash të tmerrshme bën ajo zemër për dashurinë. E dëgjoja deri në fund të nderuarin dhe të dashuruarin Vasil, që na kishte bërë skandal.

Kush e dinte se ç'mund të ndodhte me Vasilin, po të mos e dëgjoje me vëmendje historinë e zemrës së tij.

Ai ndezi cingaren e fundit të paketës dhe psherëtiu me tërë atë duf dashurie:

— Ku e di ti, leshko, se çfarë vajze është ajo!

Vasili kishte të drejtë, kur thoshte se unë nuk e dija se çfarë vajze ishte ajo, por nuk kishte aspak të drejtë që për këtë gjë të më frynte duke më thënë «leshko». S'ishte koha për ta kundërshtuar dhe vendosa të mos ja zë në gojë një gjë të tillë. Le ta mbaronte tregimin deri në fund, qoftë dhe me fyerje, vetëm ta mbaronte të shkretën.

Vasili vazhdoi të tregonte:

— Ajo qeshi, unë u drodha si purteka. Mezi munda të mbaja dhëmbët që të mos më kërcitnin. Më dridhej gjithë trupi dhe mezi i mbaja gjunjët. Ishte hera e parë në jetën time që kisha ftuar një vajzë në takim, dhe nuk dija se si të sillesha. Megjithëqë vendi ishte i mirë dhe natë ishte, përsëri nuk kisha guxim t'i flisja dhe t'i hapja zemrën. Ajo më tha «mirëmbrema», dhë unë ngriva si lloz në vend. Por më vonë më erdhi guximi. Ja zura dorën me dorën time që më dridhej. Ajo e la pak dhe e hoqi me të shpejtë nga dora ime. Ja zura për të dytën herë dhe nuk e lëvizi. Pastaj, e tërhoqa pranë dhe e putha.

— Mirë ja bëre!

— Mirë, po me këtë e qulla gjithë punën. Ajo filloi të qajë! U tremba në fillim. Përse të qante? Mos ishte



zemëruar me mua? Apo i kishte ndodhur ndonjë gjë në shtëpi? «Bobo, unë gomari ç'bëra!» Kështu e shava veten time për të puthurën që i kisha dhënë. Mirëpo puna ishte ndryshe. Ajo qante nga padrejtësia që i kishin bërë duke e fejuar me një tjetër, të cilin nuk e donte. Eh, sa vajzë e mirë që është ajo. As në gishtin e vogël të këmbës nuk i vë ato të qytetit.

— Merru me të, ti, ç'të duhen ato të qytetit që i zë në gojë.

— Kështu, që thua ti, Shkëlqimja më kapi për dore dhe më foli për fatin e saj të zi dhe për babain e saj që e kishte nevrrik. Mua m'u qep goja dhe nuk dija t'i thoja një fjalë. E di sa inat që më vinte me veten time. Atje ku duhej të flisja, rrija si memec; atje ku duhej të hesh-tja, e bëja gojën çorap. Pse ndodh kështu? Mos vallë vjen nga puna kjo gjë, apo jo? Nuk besoj të jetë nga puna, është nga mungesa e bisedave me njëri-tjetrin për punë të tilla. Kjo është e vërtetë. Ne nuk bisedojmë të paktën as sa të stërvitemi, që të mos mbetemi si leshko. Ajo ishte brisk nga goja dhe kishte vendosur të mos shkonte te i fejuari i parë. Më propozoi të arratisemi së bashku.

— Të arratiseni?

— Të arratisemi! Pse, ç'ka këtu për të mos kuptuar?

— Vështro, Vasil, mblidh mendjen!

— Ku të shkon mendja ty, kungull! Se mos do arratisemi jashtë shtetit? Sa leshko që bëhesh! Jo, ore, jo, por nga ferma do të arratisemi ditën që do të sjellin lajmin për dasmën e saj. Kjo do të jetë një arratisje e përkohshme, sa t'u bjerë inati të vëllezërve dhe të jatit. Çdo gjë do të kishte shkuar si jo më mirë, por ç'e do se jam pa fat. Kur isha në takim, sa do ta puthja për të dytën herë Shkëlqimen, u dha nga stalla një hije. Ajo e njohu dhe më shkau si ngjalë nga duart, duke më lënë me gisht në gojë.

— I shkreti ti! — u talla unë.

— I shkretë dhe çfarë i shkretë se! Hija na ishte një i kushëriri saj dhe tërë punën e mori djalli.

Kjo ishte tërë historia që i kishte ndodhur Vasilit

të shkretë. Puna me siguri do të merrte dhenë, sepse vajzën e kishte parë i kushëriri, dhe kushërinjtë në të tilla raste bëjnë më shumë punë se një stacion radioje.

Megjithëqë i kishte ndodhur kjo fatkeqësi, Vasili ishte i qetë dhe kishte vendosur ta merrte për grua Shkëlqimen, sikur dhe malet të takoheshin dhe të shkatërronin të gjithë pyllin.

Më erdhi keq që i kishte ndodhur kështu dhe vendosa ta ngushëlloj:

— Mos e lësho veten, Vasil!

— Pse ta lëshoj? Le të bëhet ç'të bëhet. Unë e kam vendosur. Dhe ti e di kur vendos unë.

Vasili më kishte pyetur kot. Unë e dija shumë mirë që kur vendoste koka e Vasilit, gjithshka kishte marrë fund.

Pastaj, Vasili ishte futur në një bisedë filozofike. E kishte fjalën në paragjykimet e prindërve tanë, që ishte vështirë t'jua çrrënjosje nga mendja.

I vështroja sytë. Ata i shkëlqenin gjithë energji dhe më dukeshin të bukur. Nuk ja kisha vënë re tjetër herë. Vetëm se me punën ishte pak mbrapa dhe kishim biseduar me shokët që ta ndihmonim. Shokët të gjithë ishin dakord dhe ishin treguar të gatshëm, mbasi Vasili ishte shoku i tyre, vëllai i tyre.

Shumë mirë që nuk ishte Faiku midis nesh. Po ta kishte marrë vesh ai këtë histori, do ta kishte mbushur gjithë fermën me fjalë dhe do të na kishte futur të gjithë në bela, jo vetëm Vasilin. Por sido që të ndodhte puna, kisha vendosur të merrja anën e Vasilit dhe ta sqaroja brigadën për qëndrimin e tij në këtë dashuri të pastër që kishte ai për vajzën.

Jashtë filloj të këndonte bulkthi. Nata ishte e freskët, dhe dita do të ishte e bukur, pa re. U mata të shtrihem për të fjetur dhe i urova Vasilit natën e mirë. Net të tilla janë të bukura dhe të shkurtëra për gjumë. Dita do të hapte shpejt, ndaj vendosa të merrja një sy gjumë. Isha i lodhur e i kapitur dhe ndjeja dhembje në gjurin e këmbës së majtë. Kjo vinte ngaqë e kisha goditur atë para ca kohësh me çekan.

U shtriva. Ndenja një copë herë ashtu dhe gjumi nuk po më kapte. Vështrova oxhakun. Mbi të ishin hedhur kopicë gazetë, që kishin filluar të na vinin rregullisht. Mora njëren prej tyre dhe i hodha një sy. Në faqen e katërt shkruhej për luftën që bëhej në Kore. Amerikanët kishin ngrënë një dajak të mirë dhe kjo ma kishte bërë zemrën mal.

As Vasilin nuk e kishte zënë gjumi. Ai më pyeti:

— Ç'po lexon?

— Amerikanët po bëjnë luftë, — i thashë.

— Kokën do të hanë, kodoshët, — m'u përgjegj ai me atë urrejtjen e thellë që kishte për ata.

Nuk munda të lexoj gjatë. Gërmat kishin filluar të hidhnin valle para syve të mi. E mbylla gazetën dhe e hodha mbi kopicën që ishte në oxhak. Sofokliu i mblidhte të gjitha gazetë e vitit dhe i shpinte për të lidhur. Ishte qejfli dhe shpeshherë zihej me ne kur ja fshihnim gazetë me qëllim. Atëherë bëhej si i tërbuar dhe na mallëkonte të gjithë. Sofokliu kishte të drejtë, po ne të gjithë nuk e kuptonim dhe e bënim nevrrik kot së koti. Kur ishte shtruar ai në spital, gazetë i mblodhi për bukuri Tomi dhe ja dorëzoi Sofokliut me të ardhur. Sofokliut i ishte bërë qejfi shumë dhe e kishte puthur Tomin në faqet.

— Do të flesh? — më prishi mendimet Vasili.

— Po. Natën e mirë, Vasil!

— Natën e mirë!.. Mua nuk më zë gjumi.

Ra dita. Tomi hapi kanatat e dritares dhe fladë i freskët hyri në dhomë. Kolla e Sofokliut më kujtoi se duhej të ngrihesha nga shtrati. Të gjithë ishim atje. Vasili nuk kishte shkuar në furrë. Kjo kishte arësytet e saj. U ngrita nga shtrati, shtrigë trupin dhe hapa krahët. U mbusha me ajër të freskët. Vasili vazhdonte të flinte ende, dhe për ne kjo ishte një gjë e re. M'u kujtua historia që më kishte treguar në mbrëmje Vasili dhe i dhashë të drejtë që flinte.

Por asaj pune i doli tymi shumë shpejt. Lajmin na e solli Skënderi i gjatë, që kishte shkuar të merrte bukën në furrë. Atje, atë e kishte takuar kushëriri i vajzës, i cili e kishte dhe mik Skënderin dhe ja kishte treguar të gjithë historinë fije e për pe. Kaq donte Skënderi. U bë erë e u dha në dhomën tonë, si të sillte lajmin e fitores së betejës së «Maratonës». Na ngriti të gjithë nga shtrati, si të kishte rënë tërmet në fermë. E vështrova me habi Skënderin dhe për një çast mendova se ai kishte luajtur mendsh. Skënderi, si t'i kishte kuptuar mendimet e mia, nisi të tregonte:

— Turp... turp i madh, shokë! Nuk është parë e dëgjuar një turp i tillë! — ulërinte ai si të kishte ngrënë dinamit.

Nuk e kuptoja se ç'ishte ky turp për të cilin po fliste ai duke ulëritur. Mua më vinte inat që isha ngritur aq herët për të dëgjuar budallallëqet e Skënderit të gjatë.

Pastaj, Skënderi, mbasi e ngriti Vasilin nga gjumi me zhurmën e tij, filloi të fliste urtë e butë:

— Punë të bukur na paske bërë, Vasil! — ju drejtua ai Vasilit, që ishte ngritur mbi bërryle, i përgjumur.

— Ç'plasje ke, Skënder, që po thërret që në mëngjez, sikur të kanë hyrë bretkosat në bark?

— Mos u hiq si ëngjëll! Të gjitha m'i tregoi kushëriri i Shkëlqimes. Ai ju kishte parë me Shkëlqimen në stallat vetëm.

— Qenke shok me atë maskara! — ja priti Vasili Skënderit duke e gjuajtur me jastëk. Po jastëku u vërtit në ajër rreth dhomës dhe nuk i ra Skënderit, se ky u shtri barkas mbi minder duke na bërë të qeshnim me të madhe.

— E kam mik dhe nuk bën mirë që e shan prapa kraheve. Shko dhe ja thuaj në sy të gjitha ç'ke për t'i thënë! — ishte nxehur duke u ngritur Skënderi.

Vasili u ngrit nga shtrati dhe tha:

— Tjetri ha kumbulla, juve ju mpihen dhëmbët! Çfarë do ai mikun yt? Mos i ha kurrizi për ndonjë hu atij?

Kjo e detyroi Skënderin të ishte më i kujdesshëm. Vasili na kishte paralajmëruar kaq herë: «Kush fut hundët në punët e mia të dashurisë, i ka vënë pikë miqësisë».

Kështu që Skënderi e ndryshoi mënyrën e të folurit dhe nuk e ngriti më zërin. Po ai kishte gabuar qysh në fillim, kur kishte hyrë me rrëmbim në dhomë. Atje e kishte qullur dhe na kishte skandalizuar të gjithë.

Sofokliu, që ishte prej natyre kureshtar, kishte ngritur veshët dhe po nuhaste se diçka e papëlqyeshme po ndodhte, prandaj ai duhej ta zbulonte se ç'ishte ajo gjë. Ndoshta ajo ishte dhe arësyeja që Vasili ja kishte ngulur atë vështrim të egër fytyrës së Skënderit, i cili kishte bërë gjithë atë rrëmujë. Vasili u ngrit dhe veshi pantallonat. U habita kur pashë që kishte rënë pa pantallona! Ai nuk e kishte bërë kurrë këtë gjë, ku djallin e kishte mësuar këtë zakon të ri. Mos vallë ja kishte vënë si kusht Shkëlqimja e tij? Kushedi, mund të ishte dhe kështu.

Skënderi u zbraps, kur vuri re që ai u çua dhe po vishte pantallonat.

— Ai kushëriri i Shkëlqimes na qenka një hajvan i madh, një tutkun, që s'e ka shokun, — tha Vasili duke kopsitur pantallonat.

Skënderi i gjatë nuk kishte vendosur të tërhiqej kaq shpejt nga biseda e porsafilluar. Ai i kishte dhënë karar ta shpinte atë deri në fund, pa le të dilte ku të dilte.

— Nuk bën mirë që ju qepesh vajzave, Vasil. Ta them këtë këshillë si vëllai yt më i madh.

Vasili e vështroi nga koka në këmbë vëllain e tij të ri dhe qeshi me të madhe:

— M'u shtua edhe një vëlla! — tha me tallje.

Kjo sjellje nuk na pëlqeu dhe e pashë të arësyeshme të ndërhyja:

— Vasil, nuk bën mirë që flet kështu. Skënderi ka të drejtë të të këshillojë, se sa do ta dëgjosh, ajo varet vetëm nga ti.

Skënderi mori zemër nga ndërhyrja ime dhe vazhdoi:

— Për të mirën tënde të flasim. Hiq dorë prej saj!

Vasili e vështroi si një tigër, kurse Skënderi e pa të udhës të pështynte një herë në tokë dhe doli jashtë. Kjo sjellje e habiti Tomin, që e kishte ndaluar kategorikisht pështyrjen në tokë dhe e kishte bërë Kostën të psherëtinte.

Në të dalë të derës, Skënderi ishte takuar me Sofokliun. Ai e futi brenda në dhomë dhe e detyroi tjetrin të fliste para nesh.

— Si është puna, Skënder? — e pyeti ai i vendosur, që ta mësonte nga goja e tij gjithë punën.

Skënderi u zu ngushtë dhe nuk dinte si të bënte. Keq e kishte të tregonte, por më keq e kishte të mos tregonte. Nuk dinte si të vepronte dhe më hodhi një vështrim, që më bëri të ul sytë. Nuk dija se çfarë t'i thoja, dhe isha më keq se ai vetë.

— Si është puna, Skënder? — priste me padurim përgjegjen Sofokliu, që po habitej me heshtjen e tjetrit.

Skënderi, me sa dukej, do t'ja tregonte të gjithë të vërtetën Sofokliut. Tani do të fillonte tragjedia e vërtetë. Skënderi lëshoi bukën që kishte marrë para kohe te shtrati ku ishte shtrirë për të shpëtuar nga jastëku i Vasilit dhe filloi të tregonte:

— Shkova të marr bukën në furrë Sofokli, dhe më ndaloi Bidoja i Isufit.

— E njoh. Pse të ndaloi? — u habit Sofokliu.

— Po ja, si të them... Vasili e ka rregulluar me të kushërirën e tij. Jo rregulluar, por i vërtitet çupës së botës dhe nuk e lë rehat. Bidoja më tha që ta bëjmë pak zap djalin. Kjo është e gjitha, Sofokli.

— Më erdhi inat me Skënderin. Ishte nga natyra njeri i çuditshëm dhe nuk i mbante barku asgjë. E villte fjalën pa e kuptuar se ku rreh ajo. Kështu po vepronte dhe tani që ishte bërë, dashur pa dashur, vegël e kushërirë të Shkëlqimes.

Si të ishin pak ato që kishte thënë Skënderi shtoi edhe këto fjalë:

— Më erdhi rëndë. Më dukej sikur e gjithë binaja më kishte rënë në kokë, kur më tha atë fjalë. Turp!

— Pse është turp? — e pyeta unë me inat. Vasili e dashuron atë vajzë dhe do të krijojë familje. Këtu nuk ka asgjë për t'u turpëruar, Skënder!

— Dhe unë jam me Vasilin, — shtoi pa të keq Veraqi, që nuk ishte ndjerë.

— Pika ju të dyve! Unë nuk jam dhe nuk do të jem me të tilla turpe që na bëni dhe pikë, — ulëriti Sofokliu dhe e mbyti kolla.

— Më do, Sofokli, dhe unë e dua. Mbrëmë ishim bashkë.

Sofokliu e vështroi një herë thellë në sy, se mos tjetri e gënjente dhe ja priti:

— Nuk më gënjen, Vasil?

— Për shpirtin e babait, që më është vrarë, në të gënjej.

— Betohu ndryshe, jo për shpirt!

— Për ideal!

Kjo mjaftoi që Sofokliu të besonte. Ai na vështroi të gjithë në fytyrë dhe e ndali vështrimin te Skënderi i gjatë, që kishte heshtur dhe ishte ulur në cepin e minderit.

— Po të jetë puna kështu, edhe unë jam me Vasilin.

27

Por puna nuk kishte mbaruar me kaq. Ishte zgjatur dhe ishte futur në gojën e llafazanëve, që e kishin bërë qimen tra dhe litarin tërkuzë të gjatë me kilometra. Ishte bërë dava e madhe dhe e gjithë ferma gumëzhinte si zgjua bletësh, ku roit «matka».

Prindërit e Shkëlqimes, sidomos i jati dhe të vëllezërit, kur morën vesh se çfarë turpi ju kishte bërë e bija, vendosën që ta martojnë sa më shpejt. Pas tri ditësh në fermë erdhi dhëndrri me gjithë dajallarët e tij. Dhëndrri ishte një zdap i plakur, i veshur me një kostum të gatshëm nga ata që sapo kishin filluar të shteshin në МАРО. Ishte qesharak me atë hundë të shtrembër. E pashë tek po zbriste nga kali dhe, që në vështrimin e parë, i dhashë të paktën dyzet vjet.

Të gjithë ishim përgatitur për të ndjekur nga afër zhvillimin e ngjarjes. Skënderi, meqë ishte miku i shtëpisë së tyre, ishte ngarkuar me detyra të veçanta dhe

të caktuara. Ai u bind me vonesë për planin tonë dhe, më në fund, votoi për atë. Me mendimin dhe planin tonë ishte bashkuar dhe brigadieri, që e kishte marrë në dorë gjithë punën dhe ishte emëruar nga ne «shefi i shtabit». Dasma ishte caktuar të bëhej shpejt dhe kjo ishte dasma më e rrefeshme që kishim parë. Nusja do të merrej të nesërmen.

Të gjitha këto lajme na i kishte sjellë Skënderi. Do të kishim besuar të gjitha gënjeshttrat në botë, do të kishim besuar se edhe gomari fluturon, por nuk do ta besonim që dasma do të bëhej kaq shpejt, dhe se nusja do të dilte të nesërmen! Kjo na habiti dhe na hutoi aq shumë, sa na bëri të trullosemi si ata peshqit që goditen me dinamit.

Vasili nuk e priste një solidaritet të tillë, dhe ishte tronditur shpirtërisht nga ndihma që po i jepnin. Vetëm një ditë na ndante nga dasma që do të bëhej. Në fermë, kjo ngjarje trumbetohej si një nga ngjarjet më të habitshme dhe që s'kishte ndodhur kurrë ndonjëherë.

Vasili u tërbua, kur Skënderi i solli lajmet e sigurta dhe të freskëta. Duhej të vepronim shpejt dhe me mend. E këshilluam Vasilin që të shkruante një copë letër. Vasili nuk deshi dhe kujtoi se ne ishim hedhur kundër tij. Mezi ja mbushëm mendjen dhe ai, më në fund, u kandis.

Letra u shkrua mbi karrige, me atë lapsin kopjativ. Vasili i ndohti e i bëri si drejç buzët me laps, derisa e shkroi atë copë letër. Një ndihmë të veçantë për ta shkruar atë letër i dha Simoja. Letra ishte gati dhe atë e shpuri tek vajza një pionier, që ishte bashkuar me ne konspiratorët. Me fëmijën e vogël kishte shkruar dhe Skënderi i shkurtër. Për të larguar çdo të papritur, prindërit nuk i kishin thënë gjë së bijës për dasmën dhe e kishin lejuar të shkonte dhe në punë.

U nisa prapa tyre. Skënderi ja kishte marrë letrën djaloshit, të cilit ja pat dhënë në fillim. Te dera e dyqanit s'kishte njeri. As dhe në shesh nuk kishte njeri. Ishte për t'u habitur. Asnjë njeri! Megjithatë, dyqani ishte hapur dhe vajza ishte aty. Skënderi ja zgjati pa frikë triskën e bukës, nën të cilën ishte letra e Vasilit.

U afrova edhe unë te rrjeta e teltë, që kishte dritarja ku merrnim bukë. Vështrova vajzën. Ajo më dukej e bukur dhe i dhashë të drejtë Vasilit që çmëndej pas saj. Letra ra nga triska dhe u ngjit në tryezën e mbushur me thërrime buke. Vajza u habit, dhe u zmbraps e frikësuar.

— Është për ty, nga Vasili, — i tha asaj Skënderi shpejt e shpejt.

Vajza ngriti vetullat gjithë habi dhe e vështroi gjatë Skënderin, që ishte në dijeni të të gjitha punëve të dashurisë së saj.

— Merre letrën! Vasili na e dha për ty, — tha prapë duke e nxitur Skënderi i shkurtër.

Vajza u bind dhe e mori letrën. Sytë i qeshën, ndërsa ne u larguam me bukën nën sqetull. Vështrova supet e Skënderit të shkurtër që tundeshin dhe ja dhashë të qeshurit pa zë. Skënderi, si të kishte sy dhe nga mbrapa kokës, e kuptoi që po qeshja dhe ma priti:

— Pse qesh?

— Si të mos qesh, ti dridhesh si purteka!

— Si të mos dridhem, kam të ftohët.

— Thuaj më mirë emocion, Skëndo! — e shpova unë.

— Ç'është kjo fjalë? — më pyeti ai gjithë habi. Pastaj, duke u bindur që ishte një fjalë e rëndë u mat të merrte një plis në tokë, ndërsa unë ja shkela me të katra. Nga mbrapa më ndoqi e shara e tij.

Traktori punonte në mimo dhe prishte qetësinë e natës. Vasili ishte i shqetësuar. I ulur në sedilen ngjitur me mua, ai shuante dhe ndizte cingaret. Qentë, si ta kishin bërë me fjalë atë natë, nuk e hapën gojën fare, dhe na dukej sikur e kishin bërë me qëllim që të ndjehej zhurma e traktorit tonë. Hëna, si të ishte pajtuar me njerëzit e Shkëlqimes, ndriçonte më shumë se netët e tjera. Nata ishte e kthjellët.

- Sa vajti ora?
- Mezi i natës është.
- Mos më bën numra, ora sa është të pyes?
- Mezi i natës, dymbëdhjetë, Vasil.
- Ashtu thuaj!

Ishte bërë shumë nevrík dhe fliste me ton të ashpër. Ishte i shqetësuar dhe duhani ja kishte bërë kokën dautle. Tek mendoja kështu për të, Vasili hoqi cingaren që po i digjte buzët dhe me të ndezi një tjetër. Jo larg nesh ishte çesmja dhe prej saj na vinte zhurma e ujit që binte curril në govatën e gurtë.

- Nuk do të vijë! — më tha ai papandehur.
- Mos i ndill vetes të tilla gjëra! — i dhashë zemër.
- Mos i ndill! — u tall ai.
- Sa i paduruar që je!
- Do të të shohim ty, kur të vish në vendin tim, se si do të jesh, i urtë apo i nxituar, ishalla qofsh i urtë, — më uroi Vasili, si ta kishte kuptuar që dhe unë do të martohesha së shpejti. Më erdhi keq që Vasili e kishte parashikuar të shpejtë dasmën time.
- Nuk do ta rrëmbej nusen si ti, Vasil, — ja kujtova atij dëshirën që më zjente në shpirt.

— Pse? — u habit ai.

— Do ta marr me dashjen e prindërve.

— Jo, more! — bëri sikur u habit Vasili.

— Posi. Jam djalë i vetëm dhe do të bëjmë dasmë të madhe.

— Po Partia i ndalon shpenzimet e tepërta! — tha ai i çuditur, si të kishte përfytyruar mishrat e pjekura të shtruarra në tryezën e gjatë, që tundej nga dasmorët.


— Për mua do të ketë përjashtim.

— Pse, çfarë bën ti, vezë të kuqe? — tha Vasili hazërxevap, duke më vënë në lojë.

— Jam djalë i vetëm, dhe nëna më thotë se do të bëjë dasmë të madhe. Ky është mendimi i saj dhe jo imi.

— Më mirë të kishte dhe pesë çupa të tjera, se sa të ka ty. — U kollita dhe u mundova ta hidhja fjalën gjetskë.

- Ke cingare, Vasil?
- Jo.



— Ptu! — shfryva nga inati.

Heshtëm të dy. Në dritën e hënës nuk dukej gjë dhe kishte filluar të bënte ftohët. Vasili u ngrit dhe një herë më këmbë dhe hodhi vështrimin thellë në fushën, e aila ishte kredhur në errësirë.

— Die shpejt dita tani? — më pyeti ai si me frikë.

— Ë — hë. Pse?

— Kot pyeta, — ma priti ftohët ai.

Nga rruga po shkiste një hije. Në fillim e pashë unë. Ishte Shkëlqimja. Vasili u hodh me të shpejtë poshtë traktorit dhe e ndihmoi të hipë në traktor nusen.

Para se të niseshim, e pyeta Vasilin:

— Vasil!

— Hë!

— Të ve shamitë e bardha?

— Ptu... Shkelja, kungull, dhe mos na bën shakara tani, — ma priti ai i inatosur.

— U habita. Traktori im ishte shndërruar në taksi. M'u kujtuan taksitë. Ato ecnin shpejt, kur merrnin nusen, dhe shamitë e bardha ose të kuqe valëviteshin nga era. Është gjë e bukur të marrësh nuse me taksi, por më e bukur është ta marrësh me traktor. Kur mbërritëm në rrugën e shtruar, ku kalonin maqinat, ora kishte shkuar tre. Mëngjezi po vinte. Në fillim agimi i kuq nuk na kishte bërë përshtypje. Kur ishim në rrugë, ai u bë më i bukur, dhe dielli, që po dilte nga mali, më ngjante si ajo tufa e luleve të kuqe që shpion tek nusja së bashku me kungullin e verës. Ndoshta ishte lulja e dasmës së tyre, që po dilte nga mali...

Një kamion u ndal para tyre dhe ata hipën në të me gjithë plaçkat. Para se t'u mbyllja derën e kabinës, nuk harrova të thërras:

— U trashëgofshi, dhe jetë të lumtur, miku im!

Nuk u ndie asgjë përveç kërcitjes së derës, dhe maqina u nis me nxitim përpara.

E vështrova një copë herë tek po më zhdukej nga sytë dhe, si psherëtiva një herë, hipa në traktor dhe u nisa. Kur u futa në zonën e kënetës, dielli kishte kohë që shkëlqente.

Tomi kishte marrë traktorin e Vasilit. Ai tani ishte tamëm usta me atë trup e gjymtyrët gjithë muskuj. Duke e vështruar Tomin mbi levat e traktorit, më kujtohej dita e parë, kur kishte ardhur në punë, e qeshura e Faikut, të dansuarit e tij duke thyer mezin dhe shakatë tona thumbuese. Qysh atëherë kanë kaluar shumë ditë dhe kanë ndryshuar shumë gjëra. Tomi na përshëndet të gjithë dhe niset me traktorin e tij në punë. Uji i rrugës hapet e hapet gjithë dallgë, sikur t'i nënshtrohet fuqisë së djaloshit të ri, i cili i është futur kënetës gjithë guxim, për ta shndërruar atë në tokë pjellore. Ne vështronim dhe na qeshte fytyra nga gëzimi. . . E uronim në heshtje kolegun tonë të ri: «Punë të mbarë, Tomi ! . . .»

Dhjetor 1968.

F U N D